



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 175

Tiranë – E mërkurë, 6 dhjetor 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 85/2023, datë 2.11.2023	Për disa ndryshime në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 21433
Dekret i Presidentit nr. 341, datë 30.11.2023	Për shpallje ligji..... 21433
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, datë 14.11.2023	Çështja Nika Kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 1049/17</i>)..... 21434
Vendim i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 2, datë 24.10.2023	Me objekt ndryshimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 20, datë 31.1.2022, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër” dhe kthimin e saj në detyrë..... 21460
Vendim i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat nr. 87, datë 16.2.2023	Për shpalljen të vdekur të shtetasit Klodian Londo..... 21474

**LIGJ**
Nr. 85/2023**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9363, DATË 24.3.2005, “PËR DËRGIMIN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË JASHTË VENDIT, SI DHE PËR MËNYRËN E PROCEDURAT E VENDOSJES DHE KALIMIT TË FORCAVE USHTARAKE TË HUAJA NË TERRITORIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 12, pika 3, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 2, në titull dhe në pikën 1 të nenit 9 dhe në shkronjën “ë” të nenit 11 fjalët “misione humanitare ndërkombëtare” zëvendësohen me fjalët “misione dhe operacione humanitare ndërkombëtare dhe emergjencash civile”.

Neni 2

Në titull dhe në pikën 1 të nenit 15 fjalët “misione humanitare” zëvendësohen me fjalët “misione dhe operacione humanitare dhe emergjencash civile”.

Neni 3

Pika 4 e nenit 16 ndryshohet si më poshtë:
“4. Forcat ushtarake të huaja gjatë kalimit transit nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë shoqërohen nga Policia Ushtarake e Forcave të

Armatosura të Republikës së Shqipërisë, nëse kërkohet nga shteti përkatës.”.

Neni 4

Në pikën 1 të nenit 19 fjalët “mjetet ushtarake të huaja (automjete, anije)” zëvendësohen me fjalët “automjetet ushtarake të huaja”.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 2.11.2023.

Shpallur me dekretin nr. 341 datë 30.11.2023, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 341, datë 30.11.2023**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 85/2023, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9363, datë 24.3.2005, ‘Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA NIKI KUNDËR SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 1049/17)

VENDIM

Neni 2 (procedural) • Goditje vdekjeprurëse e të afërmit të kërkueseve nga punonjësit e shtetit gjatë një proteste politike që degjeneroi në dhunë përpara ndërtesës së Kryeministrit. • Dështimi i autoriteteve për të kryer hetimin efektiv që mund të çonte në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës për ngjarjet dhe në përcaktimin e së vërtetës • Mangësi të përgjithshme në fazat e hershme të hetimit. • Mungesa e hetimit të duhur për përgjegjësitë e mundshme për mënyrën se si morën kthesë ngjarjet nga ana e komandantëve në terren. • Mangësi specifike në hetimin e vdekjes së të afërmit të kërkueseve.

Neni 2 (material) • Përdorimi i pajustificuar i forcës vdekjeprurëse. • Mangësi në kuadrin ligjor të kohës së kryerjes së krimit që rregullon përdorimin e armëve potencialisht vdekjeprurëse në lidhje me operacionet e kontrollit të turmave. • Mbrojtja e ndërtesës së Kryeministrit, në këto rrethana, që në vetvete nuk përbën arsye legjitime për përdorimin e forcës vdekjeprurëse. • Neni 2 nuk lejon përdorimin e forcës vdekjeprurëse për mbrojtjen e pronës si të tillë. • Nevoja për të përcaktuar rrethanat e jashtëzakonshme që justifikojnë përdorimin e kësaj force për atë qëllim. • Legjislacioni i brendshëm përkatës i asaj kohe që autorizon përdorimin e armëve të zjarrit për mbrojtjen e pronës që ka mangësi në këtë drejtim. • Probleme të rënda me planifikimin dhe kontrollin e operacioneve policore në lidhje me protestën

Neni 46 • Masat individuale. • Autoritetet e brendshme të vazhdojnë përpjekjet për qartësimin e rrethanave të vdekjes së të afërmit të kërkueseve dhe për ndëshkimin e personave përgjegjës.

STRASBURG

14 nëntor 2023

Ky vendim do të bëhet përfundimtar në rrethanat e përcaktuara në nenin 44, paragrafi 2 i Konventës. Mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Nika kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komiteti i përbërë nga:

Pere Pastor Vilanova, *President,*

Jolien Schukking,

Georgios A. Serghides,

Darian Pavli,

Peeter Roosma,

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarët,*

dhe Milan Blaško, *Kancelar Seksioni,*

Duke pasur parasysh:

kërkesën (nr. 1049/17) kundër Republikës së Shqipërisë të depozituar në Gjykatë, sipas nenit 34, të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut ("Konventa"), nga tre shtetase shqiptare znj. Rajmonda Nika, znj. Amelia Nika dhe znj. Mentila Nika ("kërkuestet"), më 22 dhjetor 2016; vendimin për të njoftuar Qeverinë Shqiptare ("Qeveria") për ankimet sipas neneve 2 dhe 13, të Konventës dhe për të shpallur të papranueshme pjesën tjetër të kërkesës;

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 10 tetor 2023,

merr vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në atë datë:

HYRJE

1. Çështja ka të bëjë me pretendimet për shkeljen e aspektit procedural të nenit 2 të Konventës, në lidhje me vdekjen e të afërmit të kërkueseve, A.N, nga një goditje fatale me armë në kokë nga punonjësit e shtetit gjatë një proteste më 21 janar 2011.

FAKTET

2. Kërkuestet kanë lindur në datat e treguara në tabelën bashkëngjitur. Ato përfaqësohen në Gjykatë nga z. A. Hakani, avokat me licencë në Tiranë.

3. Fillimisht qeveria përfaqësohej nga Agjencia e saj znj. A. Hiçka dhe më pas nga z. A. Metani, znj. E. Muçaj, znj. B. Lilo dhe z. O. Moçka, Avokat i Përgjithshëm i Shtetit.

4. Faktet e çështjes mund të përmbledhen si më poshtë:



I. PROTESTA E 21 JANARIT 2011

5. Kërkueset janë familjare (përkatësisht gruaja dhe vajzat) të A. N. që vdiq si pasojë e plagës së marrë në kohë nga një armë zjarri në 21 janar 2011 gjatë një proteste përpara ndërtesës së Kryeministrit (“Kryeministria”).

6. Disa ditë përpara protestës, Partia Socialiste e Shqipërisë, atëherë partia kryesore opozitare, njoftoi që protesta do të zhvillohej përpara Kryeministrit, e cila ndodhej në bulevardin kryesor të Tiranës.

7. Më 19 janar 2011, *Drejtoria e Policisë Vendore e Tiranës* i shkroi kryetarit të Partisë Socialiste për ta informuar që organizatori i protestës kishte detyrimin që të njoftonte policinë me shkrim, në lidhje me protestën. Në përgjigje të kësaj, Partia Socialiste njoftoi policinë po atë ditë. Të nesërmen, Drejtoria e Policisë Vendore të Tiranës kërkoi më shumë detaje për organizimin e protestës, vendet e grumbullimit të protestuesve dhe itinerarin e tyre. Partia Socialiste dha detajet e kërkuara po atë ditë.

8. Më 19 janar 2011, komandanti i përgjithshëm i Gardës së Republikës (garda e nderit për shtetin e ngarkuar me detyrën e sigurimit të mbrojtjes së personaliteteve të larta të shtetit dhe objekteve të caktuara shtetërore, përfshirë Kryeministrinë) urdhëroi njësitë e ndryshme të Gardës së Republikës që të ishin në gatishmëri, të merrnin masa specifike dhe të përgatitsin plane të detajuara për mbrojtjen e Kryeministrit nga çdo akt dhune gjatë protestës (urdhër nr. 28s/1, lëshuar po atë ditë). Komandantët e njësive të ndryshme të Gardës së Republikës përgatitën planet e tyre përkatëse, të cilat u miratuan më pas nga komandanti i përgjithshëm i Gardës së Republikës. Në veçanti, komandanti i “Njesisë Speciale” përgatiti planin nr. 28s/9, të 21 janarit 2011, i cili parashikonte, aq sa është e rëndësishme, që një:

“grupi i përbërë nga [gjashtë oficerë] do të jetë në gatishmëri, gati për të hapur zjarr në rast të thyerjes së kordonit të Njesisë së Dytë dhe Njesisë Speciale”.

9. Për sa i përket logistikës, planet e Gardës së Republikës parashikonin që përveç pajisjeve mbrojtëse si: jelekë specialë, helmeta, maska kundër gazit, oficerët do të pajiseshin edhe me pushkë sulmi “tipi 56”, përfshirë plumba manovre dhe të vërtetë.

10. Po kështu, Policia e Tiranës përgatiti një “plan masash” me dyzet e katër faqe për garantimin e rendit përpara, gjatë dhe pas protestës së 21 janarit 2011. Ai plan parashikonte detajet e detyrave të ndryshme specifike që i ngarkoheshin çdo drejtorie

dhe departamenti të policisë në lidhje me protestën; veçanërisht i udhëzonte ata të bënin planifikimin përpara protestës.

11. Më 21 janar 2011, protestuesit filluan të mbledhen rreth orës 11:00 paradite në sheshin kryesor të qytetit; në të njëjtën kohë, komandantët e Gardës së Republikës i dhanë oficerëve të tyre udhëzimet përfundimtare, dhe sollën në vëmendje të tyre dispozitat e Ligjit për Armët e Zjarrit (ligji nr. 8290, i 24 shkurtit 1998, për përdorimin e armëve të zjarrit) dhe Ligjit për Gardën e Republikës (ligji nr. 8869, datë 22 maj 2003, për Gardën e Republikës). Oficerët e Gardës së Republikës më pas zunë pozicionet e tyre rreth Kryeministrit. Përfaqësues të shumë mediave u pozicionuan gjithashtu në anë të ndryshme të Kryeministrit – disa prej tyre në platforma të ngritura që ishin vendosur për të mbuluar protestën.

12. Rreth orës 14:00 protestuesit mbërritën te Kryeministria, përpara hyrjes kryesore ku kishte dy kordonë policie. Rreth orës 14:30 disa nga protestuesit nisën të gjuanin me sende të forta kundër kordonit të parë të policëve dhe situata u përshkallëzua. Kordoni i dytë i policisë (i cili përbëhej nga forcat speciale të policisë), hodhi gaz lotsjellës. Rrjedhimisht, protestuesit u shpërndanë përkohësisht dhe policët e kordonit të parë, të cilët nuk ishin të pajisur me maska gazi lotsjellës, u larguan nga pozicionet e tyre. Protestuesit vazhduan të gjuanin me gurë dhe sende të ndryshme të forta nga anët e godinës. Ata gjithashtu u grumbulluan përsëri përballë saj. Autoritetet përdorën topat e ujit për t'i shpërndarë. Protestuesit dogjën disa pemë dhe makina, dhe hodhën koktejl molotov në drejtim të godinës së Kryeministrit. Disa policë dhe oficerë të Gardës së Republikës u plagosën.

13. Në një kohë të pacaktuar (rreth orës 16:00) një numër relativisht i vogël protestuesish sulmuan portën prej hekuri të makinave në veri të ndërtesës dhe depërtuan njëzet ose tridhjetë metra në oborr (d.m.th. në zonën mes gardhit mbrojtës dhe vetë ndërtesës). Një makinë e drejtuar nga një protestues u përpoq të hynte me forcë përmes portës së makinave, por u përplas me një pengesë të ngritur për të parandaluar ndërhyrje të tilla. Një oficer i Gardës së Republikës përdori megafonin për të paralajmëruar protestuesit duke thënë si më poshtë:

“Qytetarë, po shkelni rregullat, po shkelni ligjin, keni hyrë në zonat e sigurisë; ndaj jush do të ndërmerren masa sipas ligjit.”



14. Më pas, një grup oficerësh të Gardës së Republikës, të pajisur me mburoja dhe shkopinj, ndërhyjnë dhe i shtynë protestuesit jashtë oborrit.

15. Në një moment të pacaktuar, disa oficerë të Gardës së Republikës filluan të përdorin armët e tyre të zjarrit, duke qëlluar me plumba manovër, por edhe të vërtetë, me justifikimin për të penguar vazhdimin e sulmit të protestuesve ndaj godinës. Rreth orës 16:10, si pasojë e të shtënave, tre protestues vdiqën në vend. A. N., i cili në ato momente ndodhej pranë trotuarit përballë Kryeministrit dhe nuk ishte i përfshirë në asnjë akt të dhunshëm, u godit nga një plumb në kokë. Po kështu, tre viktimat e tjera ndodheshin jashtë oborrit të Kryeministrit dhe asnjëra prej tyre nuk ishte e përfshirë në akte të dhunshme.

16. Si pasojë e konfrontimeve u plagosën rreth dyzet e pesë qytetarë, tetëdhjetë e një oficerë të Gardës së Republikës dhe njëzet e shtatë policë.

17. Pas përfundimit të dhunës, dy mjekë në Spitalin e Traumës në Tiranë – duke iu përgjigjur pyetjeve të medias – deklaruan se rreth 30 persona kishin kërkuar ndihmë mjekësore në spital. Ata deklaruan se tre protestues kishin vdekur nga plagët që dukej se ishin shkaktuar nga armë të lehta të gjuajtura nga një distancë e afërt.

18. Në një konferencë për shtyp pak orë pas protestës, S. B., kryeministri i asaj kohe, deklaroi se sipas raporteve paraprake mbi incidentin, viktimat ishin qëlluar nga afër me armë të një lloji të ndryshëm nga ato që përdor policia dhe Garda e Republikës. Gjithashtu ai i ftoi prokurorët që të hetonin ngjarjen.

19. Vonë në mbrëmjen e së njëjtës ditë, një kanal televiziv lajmesh transmetoi një video që shfaqte momentin e vrasjes së njërit prej protestuesve (jo të A. N.). Në video shihet se viktimë, para se të qëllohej, qëndronte në bulevard pak metra larg portës së makinave në veri të Kryeministrit dhe shikonte se si një tjetër protestues, i cili ndodhej brenda oborrit, hodhi një objekt drejt godinës. Papritur, viktimë ra në tokë dhe protestuesit e tjerë iu afruan dhe më pas e morën me vete. Në video u shfaq gjithashtu një oficer i Gardës së Republikës që qëllonte me armë nga një dritare e ndërtesës.

20. Sa i përket A. N., ai mori kujdesin mjekësor fillestar në Spitalin e Traumës në Tiranë dhe më pas u transferua për kujdes të specializuar në Stamboll, ku vdiq më 4 shkurt 2011. Ai u varros në Shqipëri më 7 shkurt 2011.

II. HETIMI PARAPRAK

A. Masat e hetimit paraprak

21. Më 21 janar 2011, Prokuroria e Tiranës filloi hetimin për ngjarjet bazuar në dyshimin se ishin kryer këto vepra: vrasje, shkatërrim prone me zjarr, shkatërrim prone, shpërdorim detyre dhe pjesëmarrje në tubim të paligjshëm.

22. Po atë mbrëmje, specialistët e hetimit kontrolluan zonën përreth Kryeministrit dhe mblodhën rreth pesëqind gëzhoja, si edhe dymbëdhjetë plumba. Ata bënë edhe fotografi dhe përshkrime të detajuara të gjendjes së godinës së Kryeministrit dhe pjesës së bulevardit ku ishte zhvilluar protesta. Përveç kësaj, morën në pyetje një numër protestuesish, mjekësh dhe gazetarësh; nga këta të fundit hetuesit morën edhe kopje të videoregjistrimeve që gazetarët dhe kolegët e tyre kishin bërë për ngjarjet gjatë protestës. Marrja në pyetje e personave me interes – rreth nëntëdhjetë e dy persona gjithsej – vazhdoi gjatë ditëve, javëve dhe muajve në vijim.

23. Më 22 janar 2011, prokurorët urdhëruan *Institutin e Mjekësisë Ligjore* që të kryente ekzaminimin e trupave të të gjitha viktimave, përveç A. N.. Në veçanti, prokurorët i udhëzuan ekspertët që: të ekzaminonin plagët; të përcaktonin se si ishin shkaktuar; të analizonin vrimat hyrëse dhe dalëse të çdo plumbi dhe trajektoren e tyre; dhe shkakun e vdekjes së tyre. Ekspertiza të ngjashme u urdhëruan dhe u kryen me disa nga protestuesit e plagosur.

24. Gjithashtu, prokurorët vendosën sekuestrimin e disa armëve që ishin përdorur nga efektivat e Gardës së Republikës gjatë protestës. Në javët në vijim u sekuestruan edhe armë të tjera. Armët e sekuestruara, gëzhojat e gjetura në vendin e protestës dhe veshjet e viktimave ju nënshtruan ekspertizës.

25. Gjithashtu, prokurorët urdhëruan Gardën e Republikës që t'u jepte atyre kopje të të gjitha regjistrimeve audio të komunikimeve me radio mes oficerëve të saj, dhe si përgjigje të këtij urdhri më 6 shkurt 2011, Garda e Republikës deklaroi se komunikimet nuk ishin regjistruar.

26. Më 24 dhe 26 janar 2011, dy raporte ekspertimi kimik, të cilat ishin urdhëruar nga prokurorët për të konstatuar nëse tre viktimat e sipërpërmendura dhe tre nga të plagosurit kishin përdorur armë zjarri gjatë protestave, konstatuan se nuk kishte mbetje armësh zjarri në rrobat e personave në fjalë.



1. Përpjekje për arrestimin e oficerëve të Gardës së Republikës për t'i marrë në pyetje

27. Herët në mëngjesin e datës 22 janar 2022, prokurorët nxorën urdhërndalime për gjashtë oficerët e lartë të Gardës së Republikës. Në orën 6:20 të mëngjesit urdhrat ju dorëzuan policisë për ekzekutim. Ngjarjet e mëvonshme të 22 janarit 2011, u përshkruan nga kryeministri i atëhershëm në një fjalim para Parlamentit, më 23 janar 2011: ministri i Brendshëm, i cili ishte në krye të policisë, përmendi në një telefonatë drejtuar Prokurores së Përgjithshme të asaj kohe se Oficerët e Gardës së Republikës do të vireshin plotësisht në dispozicion për t'u marrë në pyetje. Megjithatë, ministri kërkoi rivlerësimin e urdhërarresteve duke pasur parasysh, *inter alia*, njoftimin e opozitës se më 28 janar 2011 do të zhvillohej një marshim i heshtur dhe nevojën e Gardës së Republikës për të pasur në dispozicion të gjithë oficerët e saj. Prokurorja e Përgjithshme refuzoi kërkesën dhe kërkoi sërish ekzekutimin e urdhrave të arrestit nga policia. Pasdite, drejtori i përgjithshëm i Policisë njoftoi Prokuroren e Përgjithshme se për shkak të gabimeve teknike dhe administrative, urdhërarrestet nuk mund të ekzekutoheshin.

28. Më 24 janar 2011, Kryeministri bëri komentet e mëposhtme për hetimin në vazhdim të ngjarjeve:

“Edhe pse grushti i shtetit po i përmbahet strategjisë së tij, ne do të vazhdojmë detyrat tona si qeveri. Unë them [ata] do të vazhdojmë, sepse Prokurorja e Përgjithshme – e cila brenda 6 orëve, pa asnjë hetim, dje urdhëroi arrestimin e të gjithë zinxhirit [të komandës] së Gardës së Republikës – sot nuk ka urdhëruar masën e arrestit me burg ndaj njërit prej kryeterroristëve dhe krye-banditëve që u filmua dhe u fotografua nga mediat shqiptare dhe të huaja me revolver në brez në derën e Kryeministritë.

...

Dëshiroj t'i them zonjës Prokurore të Përgjithshme se Garda e Republikës, të cilës ju dëshironi t'i prisni kokat për qëllimet tuaja[,] ju mbron juve gjithashtu – ajo ka për detyrë t'ju mbrojtë juve; ju ka mbrojtur dhe do t'ju mbrojtë përsëri, për këtë të jeni e sigurt, për aq kohë sa mbani postin [tuaj].

...

Zonja që liron personin e armatosur me armë që sulmoi oficerët që e mbrojnë atë, duhet ta dijë se ajo ka hyrë në territor shumë të *gabuar* dhe se ky nuk është zbatim i ligjit. Ky nuk është organi ligjzbatues për të cilin kanë votuar qytetarët shqiptarë. Të kërkosht arrestimin e komandantit të përgjithshëm të Gardës dhe të atyre që kanë mbrojtur institucionet [shtetërore] dhe të lirosht banditën që i vuri flakën [atyre] institucioneve, të nxjerr shumë keq para shqiptarëve dhe botës.”.

29. Më 27 janar 2011, gjatë një takimi me familjarët e oficerëve të policisë dhe të Gardës, Kryeministri kritikoi sërish – këtë herë me fjalë

ofenduese – Prokuroren e Përgjithshme personalisht për mënyrën se si po hetoheshin ngjarjet e 21 janarit 2011.

30. Më 2 shkurt 2011, në përgjigje të thirrjes nga një komision parlamentar për hetimin e ngjarjeve të 21 janarit 2011, i krijuar në ditët në vijim, Prokurorja e Përgjithshme doli përpara komisionit. Ajo deklaroi se ngjarjet po hetoheshin dhe se për momentin nuk mund t'u përgjigjej pyetjeve të komisionit. Në ato rrethana ajo u largua nga seanca, pas së cilës anëtarët e komisionit bënë komente kritike – veçanërisht, që Prokurorja e Përgjithshme kishte treguar arrogancë, nuk ishte duke përmbushur detyrën e saj dhe nuk kishte respektuar komisionin.

31. Më 7 shkurt 2011, hetuesit e policisë këqyrën përsëri vendin e protestës dhe vunë re se gardhi metalik i ndërtesës ishte dëmtuar nga forca e atyre që dukej se ishin predha. Ata bënë fotografi të gardhit.

2. Përpjekje për marrjen e videoregjistrimeve të bëra nga kamerat e sigurisë së Kryeministritë

32. Më 23 janar 2011, gjatë mbledhjes së kabinetit, Kryeministri deklaroi se zyra e tij ishte e pajisur me një sistem kamerash sigurie që kishte regjistruar ngjarjet gjatë protestës. Ai shtoi se i kishte kërkuar sekretarit të përgjithshëm të Kryeministritë që regjistrimet t'i vendoste në dispozicion të prokurorëve.

33. Më 26 janar 2011, prokurorët i kërkuan Zyrës së Kryeministrit që të jepte një kopje të pamjeve të regjistruara nga kamerat e sigurisë të vendosura përreth ndërtesës. Në përgjigje të kësaj, Kryeministria dha regjistrimet e bëra nga një kamerë që ndodhej në çatinë e godinës.

34. Më 15 shkurt 2011 prokurorët përsëritën kërkesën e tyre, në përgjigje të së cilës Kryeministria u përgjigj se kamerat e tjera ishin jashtë funksionit që nga viti 2009.

35. Më 4 mars 2011, prokurorët sekuestruan hard diskun (regjistruesin digjital të diskut) e sistemit të kamerave të Kryeministritë. Në të njëjtën datë, Zyra e Kryeministrit njoftoi prokurorët se një kamerë tjetër sigurie kishte regjistruar më 21 janar 2011 dhe u dërgoi atyre një videoregjistrim. Kamera e dytë ishte orientuar drejt portës së hekurt në veri të ndërtesës – një zonë me interes për hetimin. Megjithatë, pamjet e kamerës zgjasnin vetëm pak minuta dhe mbulonin periudhën pas përfundimit të protestës.

**B. Masa hetimore vijuese**

36. Më 7 shkurt 2011, prokurorët morën në pyetje disa oficerë të Gardës së Republikës, përfshirë A. Ll., i cili mbante postin e zëvendëskomandantit të “Njesisë Speciale” të Gardës dhe kishte qenë në detyrë gjatë ngjarjeve të 21 janarit 2011. Prokurorët bënë pyetje specifike, në lidhje me planifikimin e Gardës përpara protestave – veçanërisht drejtuar oficerëve që kishin hartuar dhe miratuar ato plane. Oficerët u pyetën gjithashtu nëse ata ishin informuar para protestës për përdorimin e armëve të zjarrit (përfshirë momentin kur dhe në çfarë rrethanash ata mund t’i përdornin ato). Gjithashtu, prokurorët hetuan për mënyrën se si ishte zhvilluar komunikimi mes oficerëve gjatë protestave, nëse ata oficerë kishin qëlluar me armë dhe detaje të tjera lidhur me sigurinë gjatë protestës.

37. Në përgjithësi, oficerët e Gardës së Republikës deklaruan se përpara ngjarjes ishin informuar nga eprorët e tyre për përdorimin e armëve të zjarrit dhe për aspekte të tjera të detyrave të tyre. Në datën e ngjarjes në fjalë urdhrat ishin dhënë gojariisht, pasi urgjenca e situatës nuk kishte lejuar një mjet alternativ komunikimi. Njësitë e ndryshme i kishin bashkërenduar veprimet e tyre me anë të komunikimit me radio dhe, në disa momente në proces, nëpërmjet telefonave celularë. Urdhrat ishin dhënë nga komandantët e njësive përkatëse, të cilët u kishin thënë oficerëve se ku duhet të vendoseshin dhe cilat veprime duhej të kryenin. Ata më tej deklaruan se nuk kishin marrë ndonjë urdhër specifik për të përdorur armët e tyre në ndonjë moment të caktuar dhe se kishin qëlluar në ajër kur kishin ndjerë se situata kishte dalë jashtë kontrollit – veçanërisht kur protestuesit kishin hyrë në oborrin e ndërtesës. A. Ll., në veçanti, deklaroi se të shtënat paralajmëruese me plumba manovër nuk kishin qenë të efektshme për frenimin e protestuesve, të cilët e kishin kuptuar se oficerët po përdornin plumba manovre. Oficerët deklaruan gjithashtu se nuk mund të shpjegonin shenjat e lëna nga predha në lartësinë e njeriut në gardhin metalik të ndërtesës. Oficerë të tjerë të Gardës u morën në pyetje gjatë ditëve dhe javëve në vijim.

38. Më 8 shkurt 2011, oficerët e lartë të Gardës së Republikës, për të cilët ishin lëshuar urdhraarresti (shihni paragrafin 27 më sipër), u dorëzuan në Prokurorinë e Tiranës. Ata u morën në pyetje nga prokurorët po atë ditë.

39. Në përgjigje të pyetjeve të prokurorëve, N. P., komandant i përgjithshëm i Gardës së Republikës, i cili kishte mbikëqyrur drejtpërdrejt operacionet në terren ditën e protestës, deklaroi se nuk ishte dhënë asnjë urdhër për oficerët e Gardës Kombëtare, të pranishëm në ngjarjet në fjalë, të hapnin zjarr; megjithatë, ai vuri në dukje se të gjithë oficerët e Gardës ishin të lirë të hapnin zjarr me iniciativën e tyre për të garantuar sigurinë e objekteve që ata ruanin. Ai më tej vuri në dukje se shumë oficerë ishin lënduar dhe kishin marrë trajtim në klinikën mjekësore të Gardës së Republikës. Një oficer ishte dërguar në spital. Vetë komandanti i Gardës, pavarësisht mjeteve mbrojtëse që mbante, kishte marrë goditje nga një gur në vetull dhe kishte kërkuar ndihmë mjekësore për të ndaluar gjakderdhjen. Kur ishte kthyer, oficerët e tjerë e kishin “informuar” se ata kishin qëlluar vetëm në ajër. Në përgjigje të pyetjes nëse mund të jepte ndonjë shpjegim për shenjat e lëna nga predha në gardhin metalik të ndërtesës (të cilat ishin në lartësinë e njeriut), N. P. u përgjigj se nuk mund t’i shpjegonte shenjat.

40. Më 9 shkurt 2011, Prokuroria e Tiranës shqyrtoi *regjistrin e marrjes në dorëzim të shërbimit* të qendrës operacionale të Gardës, ku regjistrohen të dhënat kryesore ditore, urdhrat, detyrat dhe veprimtaritë e Gardës së Republikës. Në veçanti, autoritetet morën një kopje të faqeve të regjistrit, në lidhje me aktivitetet e 21 janarit 2011. Regjistri nuk përmbante asnjë shënim për ndonjë urdhër për përdorimin e armëve të zjarrit. U vu në dukje se N. P. kishte urdhëruar oficerët të përdornin shkopinj shumë herë dhe se në një moment ai i kishte paralajmëruar ata që “të mos hapnin ...zjarr [në asnjë mënyrë] në kundërshtim me ligjin”. Në orën 16:10 ai i kishte urdhëruar që të shtynin me shkopinj gome protestuesit që kishin hyrë në oborrin verior. Në orën 16:13 një oficer kishte kërkuar municion me urgjencë. Prokuroria e Tiranës shqyrtoi gjithashtu një sërë të dhënash të tjera të brendshme të Gardës, në lidhje me armët që u ishin shpërndarë oficerëve të saj më 21 janar 2011 dhe organizimin, dhe planifikimin e përgjithshëm të oficerëve të Gardës përpara se të zhvillohej demonstrata.

41. Pas vdekjes së A. N. (shihni paragrafin 20 më lart), më 5 shkurt 2011 autoritetet turke nxorën një plumb nga koka e tij. Më 17 shkurt 2011, autoritetet shqiptare i dërguan një letërporosi autoriteteve turke. Në përgjigje të saj, plumbi iu përcoll



autoriteteve shqiptare, të cilat e morën në fillim të majit 2011.

42. Më 24 maj 2011, Drejtoria e Policisë Shkencore e Policisë së Shtetit nxori raportin e ekspertimit për plumbin që ishte gjetur në kokën e A. N. Sipas tij, plumbi kishte humbur formën e tij origjinale dhe karakteristikat identifikuese për shkak të dëmtimit; prandaj nuk ishte e mundur të përcaktohej arma nga e cila kishte dalë.

43. Më 6 qershor dhe 21 korrik 2011, autoritetet shqiptare i dërguan letërporosi Departamentit të Drejtësisë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Aq sa ishte e nevojshme, autoriteteve amerikane ju kërkuar të përmirësonin cilësinë e videove dhe fotografive të protestës së 21 janarit 2011 dhe të kryenin ekzaminimin e objekteve të ndryshme që ishin me interes për hetimin – përfshirë hard diskun e kamerave të sigurisë të vendosura në ndërtesën e Kryeministrit (shihni paragrafin 35 më lart), dhe plumbat dhe predhat që ishin pjesë e përmbajtjes së dosjes penale.

44. Më 13 gusht 2011, autoritetet amerikane dhanë një raport ekspertimi ku thuhej se hard disku i Kryeministrit ishte riformatuar manualisht (domethënë të dhënat e indeksit kryesor ishin fshirë manualisht) më 22 janar 2011, në orën 00:51 dhe më 28 janar 2011, në orën 12:10. Në raport, gjithashtu, thuhej se të dhënat në hard disk ishin kopjuar në një disk të jashtëm në mbrëmjen e 21 janarit 2011 dhe më 28 janar 2011. Në fund, raporti zbuloi se përmbajtja e hard drive përfshinte të dhëna që tregonin se njëmbëdhjetë kamera sigurie ishin konfiguruar në mënyrë që ato të mund të regjistronin.

45. Më 5 janar 2012, autoritetet amerikane dorëzuan një tjetër raport ekspertimi, ku thuhej, për aq sa ishte e rëndësishme, se “për shkak të mungesës së shenjave të mjaftueshme mikroskopike përkatëse me vlerë” nuk ishte e mundur të përputhej plumbi i gjetur në trupin e anëtarit të familjes së kërkueseve me ndonjë nga armët e paraqitura për ekzaminim.

46. Dy raporte të tjera ekspertimi dolën në përfundimin se plumbat që u gjetën te dy viktimat e tjera ishin qëlluar nga një pistoletë *Beretta* dhe një armë automatik MP-5, përkatësisht. Më 21 janar 2011, këto armë ishin përdorur përkatësisht nga N. P., komandant i përgjithshëm i Gardës dhe A. Ll., zëvendëskomandant i “Njësisë Speciale të Gardës”. Në raporte thuhet gjithashtu se pas ngjarjeve të 21

janarit 2011 tyta e pistoletës së N. P. ishte zëvendësuar me tytën e armës së një oficeri tjetër.

47. Më 18 prill 2012, prokurorët akuzuan dy oficerë të Gardës A. Ll. dhe N. P. për vdekjen e tre protestuesve (pa përfshirë A. N.). Një oficer i tretë i Gardës, M. K., u akuzua për pengim të drejtësisë (shihni paragrafët 56 e vijues më poshtë). Në të njëjtën datë, prokurorët e veçuan çështjen e A. N. nga pjesa tjetër e hetimit, me arsyetimin se nevojiteshin veprime të mëtejshme hetimore në lidhje me rastin e tij (shihni paragrafët 66 e vijues më poshtë).

III. GJYQI I NËPUNËSIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT TË KRYEMINISTRISË

48. Bazuar në gjetjen e aktekspertimit të lartpërmendur se hard disku i sistemit të kamerave të sigurisë ishte kopjuar dhe se përmbajtja e tij më pas ishte fshirë (shihni paragrafin 44 më lart), prokurorët akuzuan nëpunësin e teknologjisë së informacionit (IT) të Kryeministrit për pengim të drejtësisë.

49. Sipas aktakuzës, menjëherë pas protestës së 21 janarit 2011, prokurorët kishin nxjerrë një urdhër me gojë drejtuar stafit administrativ të Kryeministrit që të ruanin të paprekura videoregjistrimet e kamerave të sigurisë së ndërtesës. Pavarësisht atij urdhri, përmbajtja e hard drive të kamerave ishte kopjuar; më pas, hard disku ishte riformatuar (shihni paragrafin 44 më lart).

50. Gjithashtu, në përgjigje të kërkesës së prokurorit, stafi administrativ i Kryeministrit kishte dhënë fillimisht regjistrimet e bëra vetëm nga njëra kamerë, e cila ishte vendosur në çatinë e godinës, duke deklaruar se kamerat e tjera nuk punonin ditën e ngjarjeve në fjalë (shihni paragrafët 33–34 më lart). Megjithatë, kur prokurorët sekuestruan hard diskun e kamerave të tjera, stafi administrativ u përcolli atyre regjistrimet e bëra nga një kamerë tjetër (shihni paragrafin 35 më lart).

51. Prokurorët shtuan se, sipas raportit të ekspertimit të autoriteteve amerikane, në datën e ngjarjes në fjalë kanë qenë në punë më shumë se dy kamera; në fakt, njëmbëdhjetë kamera ishin konfiguruar për regjistrim (shihni paragrafin 44 më lart).

52. Në mbrojtje të tij, nëpunësi i IT-së i Kryeministrit deklaroi se kishte parë dy videoregjistrime në hard disk dhe më pas i kishte kopjuar në dy DVD, me kërkesë të një oficeri të



Gardës. Ai ia kishte dorëzuar një nga DVD-të një oficeri të Gardës; DVD-në tjetër e kishte ruajtur në zyrën e tij. Ai kishte harruar për DVD-në e dytë dhe ishte kujtuar vetëm më vonë. Ai mohoi se kishte riformatuar hard diskun dhe deklaroi se pas orës 22:00 kishte qenë në shtëpi; prandaj, nuk kishte se si të riformatonte *hard drive*-in natën e 21–22 janarit.

53. Oficerët e Gardës dëshmuar se i kishin kërkuar nëpunësit të IT-së që t'u jepte atyre një kopje të regjistrimeve të bëra nga kamerat e Kryeministrit. Ata dëshmuar gjithashtu se “dhoma e serverit” kishte qenë nën mbikëqyrjen e tyre natën e 21–22 janarit dhe se askush nuk e kishte përdorur pajisjen.

54. Më 26 korrik 2012, Gjykata e Rrethit Tiranë e shpalli të pafajshëm të pandehurin, duke vënë në dukje se nuk ishte provuar, përtej dyshimit të arsyeshëm, se ishte i pandehuri ai që kishte kryer veprimet e dyshuara nga prokurorët. Më 20 shkurt 2013, ky vendim u la në fuqi në apel; më 19 mars 2015, Gjykata e Lartë rrëzoi rekursin për çështje të ligjit të paraqitur nga prokuroria.

55. Gjykatat e brendshme arritën në përfundimin se hard disku ishte riformatuar (shihni paragrafin 44 më lart) por vunë re se nuk kishte asnjë provë që këtë veprim e kishte kryer i pandehuri. Madje, ato vunë në dukje se deklaratat e oficerëve të Gardës, të cilët kishin dëshmuar se kishin mbikëqyrur dhomën e serverit gjatë të gjithë natës në fjalë, binin në kundërshtim me versionin e ngjarjeve të paraqitur nga prokuroria. Gjykatat gjithashtu pranuan se mosdhënia nga ana e të pandehurit e videoregjistrimit të dytë në kohën e duhur tregonte sjellje të pakujdesshme dhe jo qëllim kriminal.

IV. GJYQI I OFICERËVE TË GARDËS SË REPUBLIKËS

56. Sipas aktakuzës, më 21 janar 2011, mes orës 16:00 dhe 16:10, N. P. dhe A. Ll. kishte qëlluar njëkohësisht me plumba të vërtetë drejt protestuesve. Ndryshe nga deklarata e tij fillestare, ku ai nuk kishte përmendur gjuajtjen me armë në ditën e protestës (shihni paragrafin 39 më lart), N. P. dyshohet se ka qëlluar njëmbëdhjetë plumba në drejtim të një grupi protestuesish, duke vrarë njërin prej tyre. A. N. dyshohet se ka qëndruar pranë atij protestuesi. Pas përfundimit të protestës, dyshohet se N. P. ka ndërruar tytën e pistoletës së tij me atë të M. K. (shihni paragrafin 46 më lart) – koleg i Gardës dhe i bashkëakuzuar në proces – për të fshehur faktin që N. P. kishte qëlluar me armën e tij.

Mbështetur në ekzaminimin e rrobave të viktimave, nga të cilat nuk u zbuluan mbetje baruti, prokurorët konfirmuan se viktimat nuk kishin përdorur armë zjarri.

57. Për sa i përket A. Ll., ai dyshohet se ka qëlluar me breshëri katër ose pesë të shtëna në ajër përpara se të ulte objektivin dhe të qëllonte drejtpërdrejt një grup protestuesish, njëri prej të cilëve vdiq dhe të tjerët u plagosën.

58. Më 7 shkurt 2013, Gjykata e Rrethit Tiranë shpalli të pafajshëm N. P. dhe A. Ll. (shihni paragrafin 47 më lart). Në lidhje me N. P., gjykata pranoi se plumbi i dalë nga pistoletat e tij kishte vrarë një nga protestuesit, i cili kishte vdekur në vend; megjithatë, prokurorët nuk kishin arritur të vërtetonin rrethanat e sakta të këtij veprimi – në veçanti, nëse viktimat kishte qenë brenda fushëpamjes së N. P. dhe nëse i akuzuari kishte vepruar me qëllimin e destinuar për të vrarë viktimën. Rrjedhimisht, N. P. nuk kishte kryer veprën penale të “*vrasjes me dashje e kryer në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave*”, sipas nenit 79 § (ë) të Kodit Penal. Po kështu, gjykata konstatoi se provat para saj vërtetonin se protestuesi i dytë kishte vdekur si pasojë e një plumbi rikoshet që ishte qëlluar nga A. Ll.; megjithatë, nuk ishte vërtetuar se i akuzuari kishte vepruar me qëllim të destinuar për të vrarë viktimën. Për sa i përket viktimës së tretë dhe personave që ishin plagosur, gjykata konstatoi se nuk kishte prova që implikonin A. Ll. Rrjedhimisht, ajo arriti në përfundimin se A. Ll. nuk ishte fajtor për veprën penale të “*vrasjes me dashje të dy ose më shumë personave*”, sipas nenit 79 § (dh) të Kodit Penal. Në fund, gjykata vuri në dukje se prokurorët kishin tërhequr akuzën për pengimin e drejtësisë ndaj M. K., i cili fillimisht ishte akuzuar se ishte përfshirë në ndërrimin e tytës së armës së N. P. pas ngjarjes së 21 janarit 2011 për qëllim të fshehjes së fakteve në lidhje me ngjarjen (shihni paragrafin 46 më lart). Gjykata e shpalli M. K. të pafajshëm për atë veprë.

59. Më 18 shtator 2013, Gjykata e Apelit Tiranë, me dy vota pro dhe një kundër, shpalli N. P. dhe A. Ll. fajtor për *vrasje nga pakujdesia*, sipas nenit 85 të Kodit Penal dhe i dënoi përkatësisht me një dhe tre vjet burg. Gjykata la në fuqi pjesën e mbetur të vendimit të shkallës së parë.

60. Gjykata e apelit, në përgjithësi, ra dakord me gjetjet faktike të bëra nga gjykata e shkallës së parë. Ajo vuri në dukje, në mënyrë të veçantë, se në fillim



protesta kishte qenë paqësore, por që më pas ishte bërë e dhunshme dhe protestuesit kishin hedhur sende dhe kishin fyer oficerët e Gardës. Gjithashtu, u shpreh se oficerët e Gardës, pasi kishin paralajmëruar protestuesit, kishin përdorur plumba të vërtetë rreth orës 16:00, kur “rreth 100 protestues kishin hapur me forcë njëren nga portat” e Kryeministrit. Për më tepër, gjykata u shpreh se oficerët e Gardës, përfshirë N. P. dhe A. Ll., kishin përdorur armët e tyre të zjarrit pothuajse në të njëjtën kohë për të qëlluar në ajër, duke përdorur plumba të vërtetë, për të penguar turmën e dhunshme. Megjithatë, nuk u vërtetua se ata kishin qëlluar drejtpërdrejt në drejtim të dy viktimave, në trupat e të cilëve ekspertët kishin gjetur plumba të qëlluar nga armët e N. P. dhe A. Ll.

61. Sipas shumicës së anëtarëve të trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Tiranë, nuk ishte provuar se i akuzuari kishte për qëllim të vriste këta persona në fjalë; ky fakt përjashtoi akuzën e vrasjes. Sipas mendimit të Gjykatës së Apelit, edhe nëse do të ishte e vërtetë që pas protestave N. P. kishte ndërruar tytën e armës së tij me atë të një arme tjetër, ky fakt nuk mund të ndryshonte në mënyrë retroaktive cilësimin juridik të veprimeve të tij më 21 janar 2011.

62. Megjithatë, gjykata arriti në përfundimin se forca vdekjeprurëse e përdorur nga dy të pandehurit kishte qenë joproporcionale, pasi dy viktimat nuk kishin kryer asnjë akt dhune në momentin në fjalë. Gjykata vazhdoi të konstatonte se të pandehurit duhet të kishin parashikuar pasojat e mundshme të vendimit të tyre për të qëlluar në ajër duke përdorur plumba të vërtetë. Prandaj, të pandehurit u shpallën fajtorë për vrasje nga pakujdesia sipas nenit 85 të Kodit Penal.

63. Një gjyqtare pati mendim pakice. Ajo u shpreh se, sipas saj kishte prova të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se N. P. dhe A. Ll. kishin pasur objektiv të drejtpërdrejtë turmën e protestuesve dhe jo të qëllonin në ajër. Ajo shtoi se, sipas saj të pandehurit nuk kishin një objektiv të veçantë, por megjithatë kishin qenë në gjendje të parashikonin pasojat e mundshme të veprimeve të tyre dhe për këtë arsye kishin vepruar me qëllim indirekt (*dolus eventualis*) dhe jo me pakujdesi. Ajo konkludoi se ata duhej të shpallehin fajtorë për vrasje.

64. Më 25 prill 2016, Gjykata e Lartë rrëzoi ankimet për çështje të ligjit të paraqitura nga prokurorët, N. P. dhe A. Ll. Gjykata u shpreh se

ankimet për çështjet e ligjit nuk duhet të jenë thjesht një përsëritje e shkaqeve për ankimim në gjykatën e shkallës së dytë dhe në vend të kësaj ato duhet të shprehin qartë argumentet ligjore që janë paraqitur për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Më tej, ajo konstatoi se nuk dallonte asnjë mospërputhje në atë pjesë të arsyetimit të Gjykatës së Apelit që trajtonte argumentet e palëve. Duke vënë në dukje se pyetjet e ngritura në ankim për çështjet e ligjit kanë të bëjnë me vlerësimin e provave dhe jo me argumentet ligjore, i ka refuzuar ato si të papranueshme.

65. Familjet e tre prej viktimave paraqitën kërkesa në Gjykatë, të cilat u zgjidhën me marrëveshje miqësore (shihni *Veizji dhe Ded kundër Shqipërisë*, (çregjistrim) [Komiteti] nr. 16191/13, 28 mars 2017 dhe *Myrtaj kundër Shqipërisë* (çregjistrim) [Komiteti] nr. 62907/16, 5 mars 2019).

V. MASA TË MËTEJSHME HETIMORE NË LIDHJE ME VDEKJEN E A. N.

66. Më 29 janar 2014, prokurorët intervistuan sërish dy persona, I. P. dhe I. Q., të cilët kishin qëndruar pranë A. N. dhe gjithashtu ishin plagosur me armë zjarri gjatë protestës së 21 janarit 2011. Në të njëjtën datë, bazuar në deklaratimet e tyre, Prokuroria e Tiranës bëri një rindërtim të pjesshëm të rrethanave që kishin sjellë plagosjen e tyre.

67. Më 5 shkurt 2014, prokurorët intervistuan përsëri kërkuesen e parë dhe disa anëtarë të familjes së A. N.

68. Më 2 prill 2014, prokurorët ekzaminuan përsëri regjistrin e veprimeve të qendrës së operacioneve të Gardës së Republikës.

69. Nga shkurti deri në prill 2015, autoritetet morën përsëri në pyetje disa anëtarë të Gardës së Republikës, të cilët kishin marrë pjesë në përpjekjen e lartpërmendur më 21 janar 2011, për të shtyrë protestuesit duke përdorur shkopinj gome. Oficerët deklaruan se në datën në fjalë kishin marrë urdhra *via* radios dhe celularëve të tyre personalë dhe personalisht. Ata nuk kujtonin të kishin marrë urdhër për të qëlluar në ajër me plumba të vërtetë.

70. Më 5 maj 2014, Instituti i Mjekësisë Ligjore përpiloi një raport ekspertimi për plagët e A. N. Në raport thuhej se ekzaminimi ishte urdhëruar nga prokurorët në datën 21 janar 2011. Ekspertët cituan kartelat mjekësore të përgatitura kur ai ishte shtruar në Spitalin e Traumës së Tiranës. Ata cituan gjithashtu një raport ekspertize të datës 3 mars 2011, të prodhuar nga autoritetet turke sipas të cilit në kokën e A. N. ishte gjetur një plumb. Referuar këtyre



të dhënave, raporti i vitit 2014 konkludoi se A. N. ishte plagosur në anën e majtë të ballit. Plaga ishte shkaktuar nga një e shtënë e vetme me armë zjarri; gjuajtja kishte thyer kockën dhe nuk kishte vrimë daljeje. Drejtimi i plumbit ishte nga përpara mbrapa dhe nga e majta në të djathtë.

71. Në datën 3 shkurt 2015, Prokuroria e Tiranës vendosi të urdhëronte një tjetër ekspertim balistik për plumbin që ishte gjetur në trupin e A. N. dhe ia kaloi plumbin Drejtorisë së Policisë Shkencore. Më 20 mars 2015, kjo e fundit e ka kthyer paketën në Prokurorinë e Tiranës, duke nënvizuar që Prokuroria kishte dërguar plumbin e gabuar.

72. Pas një kërkesë tjetër për një raport ekspertimi balistik, më 11 shtator 2015, dy ekspertë riekzaminuan plumbin. Ata vunë në dukje se ai kishte gjashtë vjaska; megjithatë, dolën në përfundimin se për shkak se plumbi ishte dëmtuar, ishte e pamundur të përputhej me armën nga e cila ishte shkrepur.

73. Më 22 qershor 2016, një familjar i A. N. i kërkoj Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Tiranës që ta informonte për ecurinë e hetimeve dhe t'i përcillte një kopje të dosjes hetimore. Më 25 korrik 2016, kërkesja e parë i kërkoj gjithashtu Prokurorisë së Përgjithshme një kopje të dosjes hetimore.

74. Më 28 shkurt 2020, prokurorët arritën në përfundimin se ishin kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore për të zbardhur vrasjen e A. N. më 21 janar 2011 dhe plagosjen e gjashtë personave të tjerë. Duke vënë në dukje se autorët e veprës në fjalë nuk mund të identifikoheshin, ata pezulluan hetimin dhe e dërguan rastin në polici për veprime të mëtejshme.

75. Më 20 janar 2021, Drejtoria e Policisë së Tiranës dërgoi një raport në Prokurorinë e Tiranës ku sugjeronte rihapjen e hetimeve. Raporti sugjeronte që të përgatiteshin raporte të tjera ekspertimi për viktimat që humbën jetën dhe për ata që ishin plagosur, si edhe për plumbin e gjetur në trupin e A. N. Në veçanti, ajo sugjeroi që të bëheshin hetime nëse kishte pasur ndonjë progres në teknologjinë kriminalistike, që mund të ishte në gjendje të identifikonte armën nga e cila kishte dalë plumbi i gjetur në trupin e A. N. Ajo sugjeroi gjithashtu që të gjitha videoregjistrimet e protestës të ekzaminoheshin përsëri dhe të gjithë personat e përfshirë të merreshin sërish në pyetje.

76. Më 2 prill 2021 prokurorët rihapën hetimet.

77. Më 28 maj 2021, prokurori komunikoi me Drejtorinë e Policisë Shkencore për ta pyetur nëse, që nga 11 shtatori 2015, kishte pasur ndonjë progres teknologjik – qoftë brenda vendit, qoftë në Bashkimin Evropian apo në Shtetet e Bashkuara të Amerikës – që do të mundësonte identifikimin e armës nga e cila kishte dalë plumbi i gjetur në trupin e A. N. Në mungesë të përgjigjes, kërkesa u përsërit më 22 shtator 2021.

78. Më 8 korrik 2021, kërkesja e parë i konfirmoi Prokurorisë së Tiranës se ajo ishte informuar për veprimet që prokurorët kishin ndërmarrë deri më 28 shkurt 2020 dhe kërkoj çdo përditësim në lidhje me veprimet e tyre që nga ajo datë. Më 15 korrik 2021, prokurorët u përgjigjën se kërkesja e parë do të informohej për çdo gjetje në fund të hetimit.

79. Më 4 tetor 2021, Drejtoria e Policisë Shkencore iu përgjigj prokurorëve (shihni paragrafin 77 më lart), duke i informuar se nuk kishte pasur progres teknologjik që mund të mundësonte dhënien e një rezultati të ndryshëm nga ai i marrë deri në atë datë, në lidhje me plumbin që vrau A. N. Ajo gjithashtu deklaroi se nuk kishte informacion të detajuar nëse ndonjë progres i tillë teknologjik kishte ndodhur diku tjetër dhe sugjeroi që prokurorët të bënin një kërkesë pranë Shërbimit Kombëtar të Inteligjencës Balistike të Mbretërisë së Bashkuar dhe laboratorit të Byrosë Federale të Hetimit të SHBA-së.

80. Më 21 janar 2022, me anë të një letërporosie, autoritetet shqiptare i kërkuan autoriteteve italiane të kryenin ekspertimin e plumbit që ishte gjetur në trupin e A. N. Asnjë informacion tjetër nuk është dhënë në lidhje me këtë.

81. Më 23 janar 2023, siç raportohet në mediat lokale, ministri i Drejtësisë ka depozituar kallëzimin në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (“Prokuroria e Posaçme”), në lidhje me ngjarjet e 21 janarit 2011 kundër N. P., Kryeministrit dhe ministrit të Brendshëm, të cilët kishin qenë në detyrë në kohën e ngjarjeve në fjalë. Kërkesa thuhet se bazohej në raportet e medias që sipas një regjistrimi audio të komunikimeve radiofonike N. P., komandanti i përgjithshëm i atëhershëm i Gardës së Republikës, kishte urdhëruar oficerët e Gardës të hapnin zjarr. Mësohet se Prokuroria e Posaçme ka përcjellë kallëzimin e ministrit të Drejtësisë në Prokurorinë e Tiranës për shkaqe juridiksioni.



82. Më 16 shkurt 2023, sipas raportimeve të medias vendase, disa anëtarë të familjeve të viktimave të 21 janarit 2011 (përfshirë edhe A. N.) kanë depozituar një kallëzim të ri penal në Prokurorinë e Posaçme. Në kallëzimin e tyre ata kanë deklaruar se kishin një provë të re – domethënë regjistrimin audio të përmendur më lart (shihni paragrafin 81 më lart) – dhe se do t'ia dorëzonin atë vetëm Prokurorisë së Posaçme sepse nuk kishin besim te Prokuroria e Tiranës, e cila e kishte zvarritur çështjen për dymbëdhjetë vjet.

VI. PROCEDURAT E DËMSPËRBLIMIT TË FILLUARA NGA KËRKUESËT

83. Më 19 shtator 2016, disa anëtarë të familjes së A. N., përfshirë kërkueset, depozituan një padi civile për dëmshpërblim kundër Gardës dhe Ministrisë së Brendshme në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Padia bazohej në disa dispozita procedurale, përfshirë nenet 2, 3 dhe 8 të Konventës, nenet e Kodit Civil që rregullojnë përgjegjësinë për dëmin në rast të vdekjes së një personi dhe ligjin për përgjegjësinë jashtëkontraktore të shtetit (ligji nr. 8510, datë 15 korrik 1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të autoriteteve administrative shtetërore”, i ndryshuar). Paditësit parashtruan se më 21 janar 2011 të paditurit kishin vepruar në mënyrë të paligjshme dhe kishin shkaktuar vdekjen e A. N., duke u shkaktuar atyre dëm pasuror dhe jopasuror.

84. Në parashtrimet e saj, Garda i kërkoi gjykatës “të zgjidhte çështjen në përputhje me ligjin”.

85. Më 30 janar 2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë la në fuqi padinë dhe caktoi dëmshpërblimin prej 12,834,097 lekë për çdo kërkues (afërsisht 103,524 euro).

86. Gjykata iu referua vendimeve të përshkruara në paragrafët 58–64 më lart dhe vuri në dukje se më 31 korrik 2014, Kryeministria kishte krijuar një grup pune për të “vlerësuar dëmin e pësuar nga viktimat e ngjarjeve të 21 janarit 2011”. Gjykata vlerësoi se kjo e fundit reflektoi faktin që autoritetet kishin pranuar se vdekja e protestuesve më 21 janar 2011 kishte ndodhur si rezultat i veprimeve ose mosveprimeve të paligjshme nga ana e punonjësve të shtetit.

87. Gjykata, më tej, konstatoi se më 21 janar 2011 oficerët e Gardës kishin përdorur armët e tyre në kundërshtim me Ligjin për Armët e Zjarrit (shihni paragrafin 89 më poshtë). Ajo iu referua jurisprudencës së Gjykatës, në lidhje me detyrimet

negative dhe pozitive të shteteve, sipas nenit 2 të Konventës dhe arriti në përfundimin si më poshtë:

“Në këtë çështje, gjykata, përveç [legjislacionit shqiptar], i referohet Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

...

Bazuar në këtë interpretim të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, gjykata doli në përfundim se Republika e Shqipërisë, e përfaqësuar nga të paditurit në këtë gjykim, është përgjegjëse për humbjen e jetës së të ndjerit A.[.] N.[.], më 21 janar 2011 – jo vetëm bazuar në legjislacionin shqiptar, por edhe në zbatim të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sepse nuk ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të shmangur humbjen e jetës së të ndjerit.

Në çështjen në gjykim, u takonte autoriteteve shtetërore (të paditurve) që të [provonin] se ata kishin ndërmarrë të gjitha masat e mundshme [kundër rrezikut për jetën], pavarësisht nëse ata kishin apo jo dijeni për [këtë rrezik] për parandalimin e dëmit.”.

88. Në mungesë të ankimit, vendimi i lartpërmendur mori formë të prerë dhe, sipas parashtrimeve të Qeverisë para Gjykatës, dëmshpërblimet janë paguar plotësisht.

KUADRI PËRKATËS LIGJOR DHE MATERIAL

I. LEGJISLACIONI I BRENDSHËM

A. Ligji për armët e zjarrit i vitit 1998 (ligji nr. 8290, datë 24 shkurt 1998, “Për përdorimin e armëve të zjarrit”, i ndryshuar me ligjin nr. 10291, datë 24 qershor 2010)

89. Nenet përkatëse të ligjit lexojnë:

“Neni 2

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, policisë e tjera të armatosura të krijuara me ligj, të cilat nuk janë në përbërje të Forcave të Armatosura, si dhe rojat civilë të armatosur, kanë të drejtë të përdorin armët e zjarrit për të mbrojtur jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tyre ose të një tjetri nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit (në kushtet e mbrojtjes së nevojshme), si dhe kur u kërkohet për të përballuar një rrezik real dhe të çastit, që kërcënon atë ose një person tjetër apo pasurinë e tyre nga një dëmtim i rëndë, me kusht që të mos jetë i provokuar prej tij dhe dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi i zmbarsur (në kushtet e nevojës ekstreme).

...

Neni 5

Armët e zjarrit nuk lejohen të përdoren:

a) kundër personave që në dukje tregojnë se janë të mitur (fëmijë), gra dhe pleq;

b) në vende publike, ku ka mbledhje e grumbullime njerëzish dhe vihet në rrezik jeta e të tjerëve.

Armët e zjarrit në këto raste mund të përdoren vetëm kundër personave të veçantë që kryejnë vepra të dukshme dhune kundër personit ose pasurisë, që në vetvete përbëjnë



shkelje të rënda të ligjit dhe kur përdorimi i masave të tjera shtrënguese nuk ka dhënë rezultatet e dëshiruara.”

90. Ligji për armët e zjarrit 1998 u shfuqizua dhe u zëvendësua me ligjin për armët e zjarrit 2014 (ligji nr. 72/2014, i 10 korrikut 2014, “Për përdorimin e armëve të zjarrit”). Nenet përkatëse të ligjit për armët e zjarrit 2014 lexojnë:

“Neni 4

Kushtet e përdorimit të armës

1. Punonjësit e Policisë së Shtetit dhe *subjektet e tjera* mund ta përdorin armën e zjarrit të shërbimit, në ushtrim të detyrave të tyre dhe në përputhje me dispozitat e këtij ligji, vetëm atëherë kur është absolutisht e domosdoshme dhe vetëm si mjet i fundit për të parandaluar ose neutralizuar veprimet e dhunshme të rrezikshme të personit me rrezikshmëri të lartë për jetën dhe shëndetin e tij dhe personave të tretë, kur mjetet e tjera të përdorimit të forcës nuk kanë dhënë rezultat ose nuk arrijnë objektivat e ligjshëm të detyrave funksionale.

2. Shmangia e një rreziku nëpërmjet përdorimit të armëve të zjarrit nga subjektet që u njihet kjo e drejtë, bëhet për të mbrojtur jetën, shëndetin, të drejtat dhe interesat e tyre ose të një tjetri nga një sulm i padrejtë, i vërtetë dhe i çastit, me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me rrezikshmërinë e sulmit, si dhe kur u kërkohet për të përballuar një rrezik real dhe të çastit, që kërcënon atë ose një person tjetër apo pasurinë e tyre nga një dëmtim i rëndë, me kusht që të mos jetë i provokuar prej tij dhe dëmi i shkaktuar të mos jetë më i madh se dëmi i zmbratur.

...

Neni 7

Shmangia e rrezikut publik

1. Përdorimi i armëve të zjarrit për të shmangur një rrezik publik, që paraqet një tubim i dhunshëm personash, duhet të bëhet në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Përdorimi i armëve të zjarrit është i lejuar vetëm kundër personave të veçantë të armatosur, të cilët kryejnë vepra të dukshme dhune kundër jetës së personit ose shërbimeve të policisë dhe shërbimeve që kryejnë subjektet e tjera që mbajnë dhe përdorin armë, kur përdorimi i masave të tjera shtrënguese nuk ka dhënë rezultatet e dëshiruara.

3. Ndalohet të qëlluarit në ajër me armë zjarri mbi grumbullime njerëzish, si një mënyrë për shpërndarjen e tyre.”

B. Ligji për Gardën e Republikës i vitit 2003 (ligji nr. 8869, datë 22 maj 2003, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9366, datë 31 mars 2005)

91. Neni 25 i ligjit lexon:

Punonjësi i Gardës përdor armën në rastet e përcaktuara në ligjin nr. 8290, datë 24.2.1998, “Për përdorimin e armëve të zjarrit”, si dhe në rastet kur sulmohen:

personalitetet e larta shtetërore të vendit dhe të huaja;
rojet dhe objektet në ruajtje.”

92. Ligji për Gardën e Republikës 2003 u shfuqizua dhe u zëvendësua me ligjin “Për Gardën e Republikës”, 2021 (ligji nr. 33/2021, i 16 marsit 2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”).

Faqe| 21444

Nenet përkatëse të ligjit për Gardën e Republikës 2021 lexojnë:

“1. Garda e Republikës ka përgjegjësi dhe kryen këto detyra kryesore:

...

n) përdor armët e zjarrit në organikë të Gardës, sipas legjislacionit në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.”

II. KOMISIONERI I KËSHILLIT TË EVROPËS PËR TË DREJTAT E NJERIUT

93. Pas një vizite speciale në Shqipëri, mes 13 dhe 15 shkurt 2011, për të vlerësuar aspektet e të drejtave të njeriut të ngjarjeve të 21 janarit, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut (“Komisioneri”) publikoi raportin e tij më 22 shkurt 2011 (CommDH (2011)9). Raporti përshkruante ngjarjet e 21 janarit, si më poshtë:

“6. Më 21 janar 2011, menjëherë pasi demonstruesit u mbledhën para Kryeministrit, ndodhën përplasje të dhunshme mes një grupi prej disa qindra personash dhe policisë që ndodhej përpara ndërtesës.

7. Ka perceptime të ndryshme dhe kontradiktore për atë që ndodhi në të vërtetë dhe se si situata evoluoi dhe doli jashtë kontrollit. Grupimet politike japin rrëfime kontradiktore mbi pyetjen se kush e provokoi shpërthimin e dhunës – demonstruesit apo policia. Sipas autoriteteve shtetërore, protesta u organizua nga opozita për të rrëzuar pushtetin me dhunë, ndërsa opozita shprehet se ishte policia ajo që provokoi protestuesit pothuajse menjëherë pas fillimit të demonstratës.

8. Duket qartë se një grup demonstruesish kanë kryer akte të dhunshme ndaj policisë dhe Gardës së Republikës, duke hedhur gurë dhe duke përdorur shkopinj të pankartave për t'i goditur ata. Disa protestues dogjën gjithashtu makina të parkuara pranë vendit të protestës. Si kundërpërgjigje, policia përdori një sërë mjeteve, si: shkopinj gome, topa uji, gaz lotsjellës dhe plumba gome. Si pasojë e përplasjes së dhunshme mes demonstruesve dhe policisë, dhjetëra u plagosën nga të dyja palët.

9. Në një fazë të mëvonshme gjatë demonstratës, pjesëtarë të Gardës së Republikës përdorën armë zjarri. Katër protestues vdiqën dhe disa persona të tjerë u plagosën nga të shtënat me armë zjarri, gjë që ngre pikëpyetje për ligjshmërinë dhe proporcionalitetin e përdorimit të forcës.

10. Kryeministri dhe ministri i Brendshëm informuan Komisionerin se Garda e Republikës kishte të drejtë të përdorte forcën vdekjeprurëse në rrethana të veçanta, pasi ishte shkelur perimetri i sigurisë së objekteve qeveritare. Ndërkohë që Komisioneri e kuptoi që të katër vrasjet në fakt ndodhën jashtë perimetrit të sigurisë së godinës së Kryeministrit, ministrat pohuan se protestuesit ishin përpjekur të hynin në oborr.”

94. Në lidhje me urdhërarrestet e lëshuara për oficerët e lart përmendur të Gardës, Komisioneri theksoi:

“21. Prokuroria e Përgjithshme filloi hetimin për ngjarjet e 21 janarit 2011. Kuptohet që në fillim fokusi ishte mbi vdekjen e katër personave që ishin goditur me plumba. Që në mëngjesin e 22 janarit, Prokuroria e Përgjithshme nxori urdhrat e ndalimit ndaj gjashtë drejtuesve të Gardës së Republikës, me qëllim



marrjen e deklarimeve të tyre në lidhje me ngjarjet e 21 janarit. Urdhrat nuk u ekzekutuan nga autoritetet policore deri më 8 shkurt 2011, kur gjashtë oficerët dhanë deklarinimin para prokurorëve.

22. Komisioneri mësoi se vetë Prokurorja e Përgjithshme ishte kritikuar nga politikanët kryesues dhe se pozita e saj ishte kthyer në çështje në diskursin e polarizuar politik. Megjithatë, përfaqësues të të dy grupimeve politike i deklaruan Komisionerit se nuk kishte alternativë tjetër për Prokuroren e Përgjithshme në lidhje me këto hetime. Megjithatë, Komisioneri e kuptoi se puna e Zyrës së saj do të ndiqej në mënyrë kritike”.

95. Komisioneri shtoi:

“28. Shumatorja e gjithë kësaj është se Prokuroria e Përgjithshme po përballet me një detyrë jashtëzakonisht të vështirë. Fokusi duhet të jetë në përgatitjen e ndjekjes penale kundër atyre që dyshohet se kanë kryer krime. Duhet pranuar se disa nga aktet e kryera këtë ditë duhet të konsiderohen si krime pavarësisht nga klima politike dhe kush e filloi spiralen negative të dhunës. I tillë është rasti i goditjeve vdekjeprurëse; sulmeve nga disa demonstrues kundër policisë; dhe dhunës së paprovokuar policore gjatë arrestimeve dhe transportimit të personave të kapur.”

96. Në përfundim, Komisioneri u shpreh:

“V. Konkluzione

29. Nevojiten hetime të plota, të paanshme dhe të besueshme për shkeljet e të drejtave të njeriut që ndodhën më 21 janar 2011. Përgjegjësit për aktet e dhunshme dhe shkeljet e tjera të të drejtave të njeriut duhet të mbajnë përgjegjësi. Kjo është e nevojshme për të vendosur drejtësinë, por edhe për të parandaluar zhvillime të tilla të rënda në të ardhmen.

30. Komisioneri përshëndeti faktin që përfaqësues të të dy grupimeve politike deklaruan se Prokuroria e Përgjithshme duhet të kryejë hetimin; nuk ka alternativë tjetër. Megjithatë, Prokuroria dhe jo më pak vetë Prokurorja e Përgjithshme janë vënë në shënjestër të deklaratave politike të papërshtatshme dhe tejet kritike. Kjo duhet të shmanget tani e tutje.

31. Natyrisht, polarizimi i thellë politik e bën veçanërisht delikate dhe të vështirë detyrën e Prokurorisë së Përgjithshme. Është e rëndësishme që të gjithë të shmangin ndërhyrjen në hetimet në vazhdim dhe që autoritetet përkatëse, përfshirë policinë, të bashkëpunojnë plotësisht dhe menjëherë me prokurorinë”.

LEGJISLACIONI

I. SHKELJA E DYSHUAR E NENIT 2 TË KONVENTËS

97. Kërkuesit, mbështetur në nenet 2 dhe 13 të Konventës, u ankuan se përdorimi i forcës nga ana e autoriteteve kundër A. N., gjatë protestës së 21 janarit 2011, përbënte shkelje të aspektit material të nenit 2 të Konventës. Ata u ankuan edhe për mungesën e efektivitetit të hetimeve për vdekjen e familjarit të tyre. Gjykata, duke qenë kompetente për cilësimin e fakteve të një çështjeje me ligj, konsideron se problemet e ngritura në këtë çështje duhet të shqyrtohen vetëm nga këndvështrimi i nenit 2 të Konventës (krahasoni *Jelić kundër Kroacisë*

nr. 57856/11, § § 107–09, 12 qershor 2014, dhe *M. dhe të tjerët kundër Kroacisë* nr. 50175/12, § 52, 2 maj 2017) që lexon si më poshtë:

“1. E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. Askujt nuk mund t’i merret jeta qëllimisht, me përjashtim të rastit kur zbatohet një vendim gjyqësor me vdekje, pas dënimit për një krim për të cilin ky dënim është parashikuar me ligj.

2. Marrja e jetës nuk konsiderohet të jetë shkaktuar në kundërshtim me këtë nen në rastet kur ajo vjen si pasojë e përdorimit të forcës, që është jo më shumë se absolutisht e nevojshme:

a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme;

b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen e një personi të cilit i është hequr liria ligjrisht;

c) për të kundërshtuar, në përputhje me ligjin, një trazirë ose kryengritje.”.

A. Aspekti procedural

1. Pranueshmëria

98. Qeveria parashtroi se hetimi ishte në vijim e sipër dhe se për këtë arsye mjetet juridike të brendshme nuk ishin shteruar ende.

99. Kërkuesit nuk komentuan.

100. Gjykata vëren se kërkesa e Qeverisë për papranueshmëri, bazuar në pretendimin se ankimi ishte i parakohshëm, lidhet ngushtë me themelin e ankimit të kërkueseve për mungesën e pretenduar të efektivitetit të hetimit. Prandaj, kundërshtimi i Qeverisë duhet të bashkohet me themelin e ankimit të kërkueses nën aspektin procedural të nenit 2.

101. Gjykata vëren se ky ankim nuk është as haptazi i pabazuar dhe as i papranueshëm për ndonjë nga shkaqet e tjera të renditura në nenin 35 të Konventës. Prandaj, ai duhet të shpallet i pranueshëm.

2. Themeli

a) Parashtimet e palëve

102. Kërkueset parashtuan se kishte pasur shkelje të aspektit procedural të nenit 2 të Konventës për shkak të mungesës së efektivitetit të hetimit. Ato argumentuan se hetimi nuk kishte vijuar me shqyrtim të arsyeshëm dhe as nuk ishte i pavarur. Sipas tyre, autoritetet vendore e kishin penguar hetimin duke mos ekzekutuar urdhrat e ndalimit të prokurorit (shihni paragrafin 27 më lart) dhe duke fshehur videoregjistrimet përkatëse (shihni paragrafin 44 më lart).

103. Kërkueset kundërshtuan vendimin e prokurorëve për të veçuar çështjen e A. N. nga ato të tre viktimave të tjera të protestës (shihni paragrafin 47 më lart). Sipas tyre (përveç pyetjes se kush e kishte qëlluar plumbin që vrau A. N.), sipas



legjislacionit penal shqiptar komandanti i përgjithshëm i Gardës dhe oficerët e tjerë që kishin përdorur plumba të vërtetë mund të akuzoheshin për vrasje – në bashkëpunim. Në lidhje me këtë, ato u ankuan gjithashtu se nuk u ishte dhënë statusi i viktimës në procesin penal kundër oficerëve të Gardës dhe as nuk ishin informuar rregullisht nga prokurorët për ecurinë e hetimit.

104. Gjithashtu, kërkueset kritikuan autoritetet vendase sepse nuk i kërkuan autoriteteve turke (ose sepse ato vetë nuk e kryen në kohë) ekspertizën e plagës së A. N., për të sqaruar trajektoren e plumbit, çdo material shtesë të transportuar nga plumbi, arsyen pse plumbi kishte humbur formën e tij origjinale dhe pyetje të tjera të mundshme të rëndësishme për hetimin. Ato deklaruan se ekzaminime të ngjashme ishin kryer për tre viktimat e tjera (shihni paragrafin 23 më lart), por jo për A. N. Kërkueset shtruan gjithashtu, më gjerësisht, pyetjen nëse autoritetet shqiptare kishin kërkuar dhe kishin marrë ndonjëherë ndonjë raport nga ekspertët turq të mjekësisë ligjore, të cilët i kishin hequr plumbin nga koka A. N.

105. Qeveria u shpreh se prokurorët kishin ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme të arsyeshme hetimore për të sqaruar çdo aspekt të çështjes. Ata theksuan se kishin urdhëruar ekspertizë të shumta në lidhje me armët e efektivëve të Gardës, plumbin e gjetur në trupin e A. N., vendin e krimit etj. Ata kishin kërkuar gjithashtu ndihmë të specializuar nga ekspertët amerikanë dhe kishin marrë në pyetje shumë dëshmitarë.

106. Qeveria, gjithashtu, vuri në dukje se një kopje e dosjes së çështjes i ishte dhënë kërkueseve dhe se ato gjithashtu ishin vënë në dijeni të zhvillimeve në lidhje me çështjen përmes medias, e cila i kishte kushtuar vëmendje të konsiderueshme çdo zhvillimi të ri në lidhje me hetimin.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i. Parime të përgjithshme

107. Parimet përkatëse të zbatueshme për detyrimin për të kryer një hetim efektiv janë përmbledhur nga Gjykata, për shembull, në çështjen *Armani Da Silva kundër Mbretërisë së Bashkuar* ([GC] nr. 5878/08, 30 mars 2016), si më poshtë:

“229. Duke pasur parasysh natyrën e tij themelore, neni 2 i Konventës përmban një detyrim procedural – siç përshkruhet më poshtë – për të kryer hetim efektiv për shkeljet e dyshuara të aspektit të tij material (shihni *Ergi kundër Turqisë*, 28 korrik 1998, § 82, *Raportet* 1998 IV; *Mastromatteo kundër Italisë* [GC] nr. 37703/97, § 89, GJEDNJ 2002-VIII; *Giuliani dhe Gaggio kundër* Faqe | 21446

Italisë [GC] nr. 23458/02, § 298 [GJEDNJ 2011 (ekstrakte)] dhe *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë* [GC] nr. 24014/05, § 69, 14 prill 2015).

230. Ndalimi i përgjithshëm me ligj i vrasjes arbitrare nga punonjësit e shtetit do të ishte i paefektshëm, në praktikë, nëse nuk do të ekzistonte një procedurë për shqyrtimin e ligjshmërisë së përdorimit të forcës vdekjeprurëse nga autoritetet shtetërore. Detyrimi për të mbrojtur të drejtën e jetës sipas kësaj dispozite, i parë në lidhje me detyrën e përgjithshme të shtetit, sipas nenit 1 të Konventës për t'i "siguruar çdokujt brenda juridiksionit [të tij] të drejtat dhe liritë e përcaktuara në [Konventë]", kërkon në mënyrë të nënkuptuar që duhet të ekzistojë një formë e hetimit efektiv zyrtar në rastet kur ka njerëz të vrarë si rezultat i përdorimit të forcës, *inter alia*, nga punonjësit e shtetit (shihni *McCann dhe të tjerët*, cituar më lart, § 161). Prandaj, shteti duhet të sigurojë, me të gjitha mjetet që ka në dispozicion, një përgjigje të duhur – gjyqësore ose tjetër – në mënyrë që kuadri ligjor dhe administrativ i krijuar për të mbrojtur të drejtën për jetën të zbatohet siç duhet dhe çdo shkelje e kësaj të drejte të goditet dhe të ndëshkohet (shihni *Zavoloka kundër Letonisë* nr. 58447/00, § 34, 7 korrik 2009, dhe *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lart, § 298).

231. Detyrimi i Shtetit për të kryer një hetim efektiv është konsideruar në praktikën gjyqësore të Gjykatës si një detyrim i natyrshëm në nenin 2, i cili kërkon, *inter alia* që e drejta për jetën të “mbrohet me ligj”. Megjithatë mospërmbushja e këtij detyrimi mund të ketë pasoja për të drejtën e mbrojtur sipas nenit 13, detyrimi procedural i nenit 2 shihet si një detyrim i veçantë (shihni *Ilhan kundër Turqisë* [GC] nr. 22277/93, §§ 91–92, GJEDNJ 2000-VII; *Önerlydiz kundër Turqisë* [GC] nr. 48939/99, § 148, GJEDNJ 2004-XII dhe *Šilih kundër Sllovenisë* [GC] nr. 71463/01, §§ 153–54, 9 prill 2009). Kjo mund të çojë në konstatimin e një “ndërrhyrjeje” të veçantë dhe të pavarur. Ky përfundim rrjedh nga fakti që Gjykata e ka shqyrtuar vazhdimisht pyetjen e detyrimeve procedurale të veçuara nga pyetja e përputhshmërisë me detyrimin material (dhe, sipas rastit, ka gjetur shkelje të veçantë të nenit 2 për këtë arsye) dhe nga fakti që në disa raste është pretenduar shkelje e detyrimit procedural sipas nenit 2 pa ndonjë ankim në lidhje me aspektin material të tij (shihni *Šilih*, cituar më lart, §§ 158–59).

232. Që hetimi për vrasjet e dyshuara të paligjshme nga punonjësit e shtetit të jetë efektiv, përgjithësisht mund të konsiderohet e nevojshme që personat përgjegjës dhe që kryejnë hetimin të jenë të pavarur nga personat e implikuar në ngjarje (shihni, për shembull, *Oğur kundër Turqisë* [GC] nr. 21594/93, §§ 91–92, GJEDNJ 1999-III, *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lart, § 300 dhe *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç*, cituar më lart, § 177). Kjo do të thotë që jo vetëm të mos ketë lidhje hierarkike ose institucionale, por edhe të ketë pavarësi praktike (shihni, për shembull, *Güleç kundër Turqisë*, 27 korrik 1998, §§ 81–82, *Raportet* 1998-IV; *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lart, § 300 dhe *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç*, cituar më lart, § 177). Ajo që rrezikohet këtu nuk është asgjë më pak se besimi i publikut në monopolin e shtetit mbi përdorimin e forcës (shihni *Hugh Jordan kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 24746/94, § 106, 4 maj 2001; *Ramsabai dhe të tjerët kundër Holandës* [GC] nr. 52391/99, § 325, GJEDNJ 2007-II dhe *Giuliani dhe Gaggio*, loc. cit.)

233. Për të qenë “efektiv” siç duhet kuptuar kjo shprehje në kontekstin e nenit 2 të Konventës, një hetim duhet së pari të jetë adekuat (shihni *Ramsabai dhe të tjerët*, cituar më lart, § 324,



dhe *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç*, cituar më sipër, § 172). Kjo do të thotë se duhet të jetë në gjendje të çojë në vërtetimin e fakteve, përcaktimin nëse forca e përdorur ishte apo jo e justifikuar në rrethana dhe të identifikojë dhe - nëse është me vend - të ndëshkojë përgjegjësit (shihni *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më sipër, § 301, dhe *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç*, cituar më lart, § 172). Ky nuk është një detyrim për rezultat, por për mjete (shihni *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* [GC] nr. 43577/98 dhe 43579/98, § 160, GJEDNJ 2005-VII; *Jaloud kundër Holandës* [GC] nr. 47708/08, § 186, GJEDNJ 2014 dhe *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç*, cituar më lart, § 173). Autoritetet duhet të ndërmarrin çfarëdo hapi të arsyeshëm që mundën për të siguruar provat në lidhje me ngjarjen, sidomos, *inter alia*, dëshminë e dëshmitarëve okularë, provat shkencore dhe, kur ka vend, një autopsi e cila jep të dhëna të plota dhe të sakta të plagosjes dhe një analizë objektive të konstatimeve klinike, duke përfshirë shkakun e vdekjes (për autopsitë, shihni, për shembull, *Salman kundër Turqisë* [GC] nr. 21986/93, § 106, GJEDNJ 2000-VII; për temën e dëshmitarëve, shihni, për shembull, *Tanrikulu kundër Turqisë* [GC] nr. 23763/94, § 109, GJEDNJ 1999-IV; dhe, për ekzaminimet shkencore, shihni për shembull, *Gül v. Turkey* nr. 22676/93, § 89, 14 dhjetor 2000). Gjithashtu, aty ku ka pasur përdorim të forcës nga punonjës të Shtetit, hetimi duhet të jetë gjithashtu efektiv në kuptimin që të mund të çojë në vendimin nëse forca e përdorur ishte apo jo e justifikuar në ato rrethana (shihni, për shembull, *Kaya kundër Turqisë*, 19 shkurt 1998, § 87, Raportet 1998-I). Çdo e metë në hetim që minon aftësinë e tij për të përcaktuar shkakun e vdekjes ose personin përgjegjës do të rrezikojë të bjerë në kundërshtim me këtë standard (shihni *Ayşar kundër Turqisë* nr. 25657/94, §§ 393–95, GJEDNJ 2001-VII); *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lart, § 301; dhe *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç*, cituar më lart, § 174).

234. Në veçanti, përfundimet e hetimit duhet të bazohen në një analizë të plotë, objektive dhe të paanshme të të gjithë elementëve përkatës. Mosndjekja e një linje të qartë hetimi minon në një masë vendimtare aftësinë e hetimit për të përcaktuar rrethanat e çështjes dhe identitetin e atyre që janë përgjegjës (shihni *Kolevi kundër Bullgarisë* nr. 1108/02, § 201, 5 nëntor 2009, dhe *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç*, cituar më lart, § 175). Megjithatë, natyra dhe shkalla e hetimit të detajuar që arrin kufirin minimal të efektivitetit të hetimit varet nga rrethanat e çështjes të veçantë. Natyra dhe shkalla e hetimit të detajuar duhet të vlerësohet në bazë të të gjitha fakteve përkatëse dhe në lidhje me realitetet praktike të punës hetimore (shihni *Velcea dhe Mazëre kundër Rumanisë* nr. 64301/01, § 105, 1 dhjetor 2009, dhe *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç*, cituar më lart, § 175). Kur në duart e një punonjësi të shtetit shkaktohet vdekje e dyshimtë, autoritetet vendase përkatëse duhet të hetojnë në mënyrë veçanërisht të rreptë (shihni *Enukidze dhe Girgylani*, cituar më lart, § 277).

235. Përveç kësaj, familja e viktimës, aq sa është e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime, duhet të informohet për hetimin. Duhet të ketë gjithashtu një element të mjaftueshëm të kontrollit të hetimit nga publiku, shkalla e të cilit mund të ndryshojë rasti pas rasti (shihni *Hugh Jordan*, cituar më lart, § 109; *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lart, § 303; dhe *Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç*, cituar më lart, § 179; shihni gjithashtu *Güleç*, cituar më lart, § 82, ku babai i viktimës nuk ishte informuar për vendimin për mosfillim të ndjekjes penale,

dhe *Oğur*, cituar më lart, § 92, ku familja e viktimës nuk kishte akses në dokumentacionin hetimor ose gjyqësor).

236. Megjithatë, nxjerrja ose publikimi i raporteve policore dhe materialit hetimor mund të përfshijë çështje sensitive me efekte të mundshme paragjyquese ndaj personave privatë ose hetime të tjera dhe për këtë arsye nuk mund të konsiderohet si një kërkesë automatike sipas nenit 2. Prandaj, aksesit i nevojshëm i publikut ose i të afërmeve të viktimës mund të parashikohet në faza të tjera të procedurës (shihni, mes autoriteteve të tjera, *McKerr kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 28883/95, § 129, GJEDNJ 2001-III, dhe *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lart, § 304). Gjithashtu, neni 2 nuk detyron autoritetet hetimore që të përmbushin çdo kërkesë për një masë të veçantë hetimore të bërë nga një i afërm gjatë hetimit (shihni *Velcea dhe Mazëre*, cituar më lart, § 113, dhe *Ramsabai dhe të tjerët*, cituar më sipër, § 348).

237. Kërkesa për të vepruar shpejt dhe me kujdes të arsyeshëm është e nënkuptuar në këtë kontekst (shihni *Yaşa kundër Turqisë*, 2 shtator 1998, §§ 102–04, Raportet 1998-VI, dhe *Kaya*, cituar më lart, §§ 106–07). Duhet pranuar se mund të ketë pengesa ose vështirësi që pengojnë ecurinë e hetimit në një situatë të caktuar. Megjithatë, një përgjigje e menjëhershme nga autoritetet për hetimin e përdorimit të forcës vdekjeprurëse mund të konsiderohet përgjithësisht si thelbësore për ruajtjen e besimit të publikut te respektimi i shtetit të së drejtës nga ana e tyre dhe në parandalimin e çdo shfaqjeje të bashkëpunimit ose tolerimit të akteve të paligjshme (shihni *McKerr*, cituar më lart, §§ 111 dhe 114, dhe *Opuş kundër Turqisë* nr. 33401/02, § 150, GJEDNJ 2009).

238. Nga sa më sipër nuk mund të nxirret përfundimi se neni 2 mund të përfshijë të drejtën që palët e tre të ndiqen penalisht ose të dënohen për një vepër penale (shihni *Mastromatteo*, cituar më lart, § 90; *Şilih*, cituar më lart, § 194; dhe *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lart, § 306) ose një detyrim absolut që të gjitha ndjekjet penale të rezultojnë në dënim, ose në fakt në një vendim dënimi të veçantë (shihni *Zavoloka*, cituar më lart, § 34 (c)). Në fakt, Gjykata do t'u japë rëndësinë e duhur gjykatave kombëtare për zgjedhjen e sanksioneve të përshtatshme për vrasje nga agjentët e shtetit. (...) (...)”.

ii. Kërkesa në çështjen në fjalë

α) Mangësitë e përgjithshme në fazat e para të hetimit penal

108. Në çështjen në fjalë, Gjykata vëren se reagimi i Prokurorisë së Tiranës ndaj ngjarjes ishte i menjëhershëm: pikërisht ditën e ngjarjes, Prokuroria e Tiranës hapi hetimet dhe filloi mbledhjen e provave në zonën ku kishte ndodhur protesta (shihni paragrafin 21 më sipër).

109. Megjithatë, deklaratat publike të nxituara më pas, të bëra nga nëpunës të lartë, se viktimat ishin qëlluar nga një distancë e afërt dhe me armë që ishin të ndryshme nga ato që përdorreshin nga Garda ose policia (shihni paragrafët 17–18 më lart) ngrenë dyshimet nëse autoritetet ekzekutive ishin të përkushtuara që në fillim për të zbardhur plotësisht ato ngjarje të rënda dhe për të mos devijuar apo



ndërhyrë në mënyrë të papërshtatshme në hetimin penal (krahasoni *Dimitrov dhe të tjerët kundër Bullgarisë* nr. 77938/11, § 148, 1 korrik 2014).

110. Këto dyshime nuk u shuan nga kritikrat e ashpra të kryeministrit të atëhershëm ndaj hetimit të prokurorit dhe sulmet personale të lartpërmendura kundër Prokurores së Përgjithshme (shihni paragrafin 28–29 më lart), të cilat u vërejtën edhe nga Komisioneri (shihni paragrafët 94–96 më lart). Për më tepër, është e rëndësishme që menjëherë, paralelisht me hetimin penal, u krijua një komision hetimor parlamentar – jo për qëllim të sqarimit të fakteve dhe përgjegjësisë së mundshme të shtetit për ngjarjet e 21 janarit 2011 (krahasoni *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë* [GC] nr. 23458/02, § 310, GJEDNJ 2011 (ekstrakte)), por për të hetuar mbi abuzimet e dyshuara nga prokurorët që po hetonin ngjarjet; Prokurorja e Përgjithshme u thirr dhe iu nënshtrua kritikave të ashpra publike nga anëtarët e atij komisioni (shihni paragrafin 30 më lart). Gjykata konsideron se këto veprime, të para në kontekstin e tyre të përgjithshëm, nuk mund të kishin pasur një ndikim negativ në efektivitetin e hetimit – jo më pak për shkak të mundësisë së tyre për të mos inkurajuar dëshmitarët e mundshëm që të bashkëpunonin me hetimin në proces.

111. Brenda pak orëve nga ngjarja, prokurorët nxorën urdhërndalime për gjashtë të dyshuarit që ishin oficerë të Gardës (shihni paragrafin 27 më lart). Megjithatë, këto urdhërndalime nuk u ekzekutuan, me pretendimin se ishin me probleme administrative (shihni paragrafin 27 dhe 94 më lart) dhe të dyshuarit u arrestuan nga autoritetet vetëm kur ata vetë vendosën të dorëzoheshin tetëmbëdhjetë ditë më vonë (shihni paragrafin 38 më lart). As materiali i dosjes së çështjes dhe as parashtrimet e Qeverisë nuk japin ndonjë shpjegim se përse autoritetet e ndryshme të përfshira nuk bashkëpunuan për të adresuar dhe zgjidhur konstatimin e policisë se urdhrat kishin disa të meta administrative dhe për t'i ekzekutuar më pas menjëherë. Mosmarrëveshjet e kësaj natyre brenda agjencive të zbatimit të ligjit nuk duhet t'i pengojnë ato të përmbushin detyrimin e tyre për të treguar kujdes dhe shpejtësi në trajtimin e një çështjeje kaq serioze (shihni *Askhabova kundër Rusisë* nr. 54765/09, § 153, 18 prill 2013).

112. Mosekzekutimi i urdhrave të ndalimit çoi në humbjen e tetëmbëdhjetë ditëve, ndërmjet datës kur u lëshuan urdhërndalimet (shihni paragrafin 27 më

lart) dhe datës kur prokurorët mundën të merrnin në pyetje të dyshuarit kryesorë (shihni paragrafin 38 më lart). Akoma më i rëndësishëm është fakti që përveç humbjes së kohës së çmuar, autoritetet humbën në mënyrë të pakthyeshme mundësinë për të marrë në pyetje të dyshuarit menjëherë pas ngjarjes, duke minimizuar kështu çdo mundësi për marrëveshje të fshehtë ose shtrembërim të së vërtetës (krahasoni *Jaloud kundër Holandës* [GC] nr. 47708/08, § 207, GJEDNJ 2014).

113. Në fund, Gjykata nuk mund të anashkalojë mungesën e shpejtësisë dhe kujdesit të autoriteteve për t'i dhënë prokurorëve videoregjistrimet në posedim të Kryeministrit në lidhje me ngjarjen (shihni paragrafin 35 më lart) ose dështimin e prokurorit për t'i sekuestruar ato regjistrime menjëherë pas ngjarjes së 21 janarit 2011.

114. Akoma më shumë, fakti që një pjesë e madhe e videoregjistrimeve janë fshirë (shihni paragrafin 55 më lart) menjëherë pas ngjarjes, siç përcaktohet nga gjykatat kombëtare, ngre shqetësime serioze nëse fshirja e tyre mund të jetë bërë me dashje dhe me qëllim për të fshehur të vërtetën. Këto dyshime nuk u hodhën poshtë nga proceset e brendshme, të cilat nuk ishin në gjendje të përcaktonin rrethanat e sakta dhe identitetin e personit(ave) që kishin urdhëruar dhe kryer fshirjen e regjistrimeve ndërsa ato supozohej se ishin në ruajtje të personelit të Gardës. Përveç pyetjes nëse fshirja e regjistrimeve mund t'i atribuohet Qeverisë së paditur, Gjykata vëren se regjistrimet u ruajtën në një drive të jashtëm që ndodhej në dhomën e serverëve të Kryeministrit; meqë ato ishin nën ruajtjen e autoriteteve vendase, ato autoritete kishin detyrimin t'i mbanin të paprekura dhe të sigurta nga çdo ndërhyrje e palëve të treta (shihni *Lorpyginy kundër Ukrainës* nr. 22323/08, § 106, 23 qershor 2016, ku fakti që hetuesi humbi videoregjistrimin u pa si një nga faktorët që kontribuoi në mungesën e efektivitetit të hetimit në fjalë).

β) Moshetimi i duhur i përgjegjësisë së mundshme për mënyrën se si ngjarjet morën kthesë nga ana e komandantëve në terren

115. Gjykata, në bazë të materialit që disponon, vëren se hetimi penal duket se ishte përqendruar ekskluzivisht në identifikimin e personit drejtpërdrejt përgjegjës për vdekjen e A. N. dhe se nuk u hetua nëse veprimet apo mosveprimet nga ana e oficerëve komandues të Gardës, më 21 janar 2011, mund të kishin kontribuar në vdekjen e A. N.



116. Kërkueset parashtuan se të shtënat e njëpasnjëshme vdekjeprurëse të katër protestuesve dhe plagët jovdekjeprurëse të shkaktuara shumë të tjerëve, nuk mund të pajtohen me versionin e ngjarjeve sipas të cilit oficerët e Gardës kishin qëlluar me armë individualisht; kërkueset argumentuan më tej se në fakt, parë së bashku me prova të tjera, sugjerohej fuqishëm se ishte dhënë një urdhër i përgjithshëm për të qëlluar drejtpërdrejt në drejtim të turmës (shihni paragrafin 140 më poshtë). Këto pretendime ngrenë një sërë pyetjesh përkatëse në lidhje me cilësinë e hetimit.

117. Së pari, hetimi nuk duket se ka përcaktuar kronologjinë e saktë të: i. momentit(eve) kur u qëlluan katër viktimat kryesore (disa prej të cilave u regjistruan nga media dhe kalimtarë të tjerë) ose ii. të plagëve jovdekjeprurëse me armë zjarri të pësura nga disa persona të tjerë. Ky mund të ishte një element i rëndësishëm në vlerësimin e rrjedhës dhe natyrës së saktë të plagëve të marra nga viktimat e ndryshme dhe se si mund të ishin shkaktuar ato. Gjykata e Apelit konstatoi në lidhje me këtë se disa oficerë të Gardës, pothuajse në të njëjtën kohë, kishin ngritur armët e tyre të zjarrit dhe kishin qëlluar në ajër me plumba të vërtetë për të frenuar turmën e dhunshme (shihni paragrafin 60 më lart).

118. Një grup i dytë pyetjesh lidhet me rrjedhën dhe natyrën e çdo urdhri të dhënë nga komandantët e Gardës në terren, të cilët duket se kanë qenë në një farë mase në komunikim me radio me njëri-tjetrin (shihni paragrafin 37 më lart) në momentet kritike të konfrontimit të dhunshëm. Punonjësit e Gardës dhe oficerët e lartë të pyetur nga hetuesit dhe gjykatat kombëtare u shprehën se nuk ishte dhënë asnjë urdhër, në asnjë moment, për të qëlluar në ajër ose ndryshe, dhe që secili oficer e kishte marrë vetë atë vendim. Gjykata ka dyshime nëse ky version i ngjarjeve mund të konsiderohet i besueshëm për të treguar një mënyrë veprimi për një forcë të armatosur të centralizuar dhe të specializuar që e gjen veten përballë një turme armiqësore; kjo duket se është gjithashtu në kundërshtim me udhëzimet dhe rregullat e angazhimit që komanda e Gardës ju kishte dhënë njësitë të saj në përgatitje të protestës (shihni paragrafin 8 më lart, shihni gjithashtu paragrafin 167 më poshtë).

119. Së treti, dhe pavarësisht nga natyra e çdo urdhri që mund të jetë dhënë ose jo, kërkueset kanë argumentuar, si në nivel të brendshëm ashtu edhe përpara Gjykatës, se nuk është hetuar siç duhet nëse

ndonjë nga punonjësit e Gardës ka qëlluar në drejtim të turmës. Kërkueset pohuan se vrasjet ishin transmetuar në televizion; Gjykata vëren në këtë drejtim se oficerët e pyetur nga autoritetet kombëtare e mohuan me forcë një mundësi të tillë, duke pohuar se ata kishin qëlluar në ajër vetëm për qëllime frenimi të turmës. Gjykata e Apelit Tiranë arriti në përfundimin se dy personat për vdekjen e të cilëve dy oficerët e Gardës ishin shpallur përgjegjës penalisht, me gjasë kishin qenë viktimat rastësore të të shtënave në ajër nga oficerët në fjalë, dhe se ato të shtëna kishin bërë rikoshet në objekte të forta përpara se të goditeshin viktimat.

120. Nuk i takon Gjykatës të zgjidhë këto mosmarrëveshje faktike ose të vërë në dyshim gjetjet faktike të gjykatave kombëtare, përveçse kur ekzistojnë arsye të forta për ta bërë këtë. Sido që të jetë, duket qartë se një sërë rrethanash dhe treguesish që mund të kishin hedhur më shumë dritë mbi këto aspekte nuk u hetuan me detaje nga autoritetet kombëtare. Këto përfshijnë: siç u përmend tashmë, mos rindërtimi i kronologjisë së saktë të plagëve me armë zjarri të marra nga demonstruesit dhe vendndodhjet përkatëse ku qëndronin viktimat kur u qëlluan; mosanalizimi sistematik i karakteristikave mjeko-ligjore të plagëve me armë zjarri të marra nga demonstrues të shumtë që pësuan lëndime jovdekjeprurëse (sidomos në lidhje me këndin dhe trajektoren e predhave), gjë që do të kishte plotësuar gjetjet në lidhje me katër personat që kishin humbur jetën; dhe mosmarrja parasysh e numrit të madh të gjurmëve të lëna nga predha të gjetura, në nivelin e lartësisë së njeriut, në gardhin metalik në të dyja anët e portës hyrëse, ku kishte ndodhur pjesa më e madhe e konfrontimit të dhunshëm (shihni paragrafin 31 më lart).

121. Të marra së bashku, këto mangësi janë të mjaftueshme që Gjykata të arrijë në përfundimin se autoritetet kombëtare nuk arritën të ndiqnin seriozisht dhe në mënyrën adekuate disa linja kyçe të hetimit në lidhje me natyrën e çdo urdhri të dhënë nga personat në zinxhirin komandues gjatë ngjarjeve – duke përfshirë por jo vetëm në lidhje me përdorimin vdekjeprurës të armëve të zjarrit dhe mundësinë që demonstruesit të kishin qenë drejtpërdrejt në shënjestër të personelit të armatosur.

122. As nga autoritetet vendase nuk u ndërmor hetim i çfarëdo lloji për të përcaktuar nëse më 21 janar 2011 kishte pasur ndonjë dështim në lidhje me



planifikimin, koordinimin dhe zbatimin e detyrave të punonjësve të shtetit. Po kështu, nuk ka asnjë provë përpara Gjykatës që të tregojë se grupi shtetëror i punës (mbi të cilin Gjykata Administrative e Tiranës u mbështet në vendimin e saj – shihni paragrafin 86 më lart) ose ndonjë autoritet tjetër publik ka kryer një hetim të tillë. Një hetim i detajuar i kësaj natyre mund të kishte hedhur dritë nëse ndonjë faktor tjetër shtesë – si mungesa e koordinimit midis Gardës dhe policisë, dhe dështimi nga ana e oficerëve të Gardës dhe policisë për të pasur një panoramë dhe komandim efektiv – kishte luajtur ndonjë rol në ngjarjet që çuan në humbjen e jetës atë ditë, duke përfshirë të shtënat fatale ndaj A. N. (krahasoni *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lart, §§ 107–120, ku u krye një hetim i hollësishëm parlamentar). Ky hetim i detajuar mund të kishte nxjerrë përfundime që do të ndihmonin në parandalimin e ngjarjeve të ngjashme në të ardhmen.

γ) Mangësitë specifike në lidhje me hetimin për vdekjen e A. N.

123. Në lidhje me fazën e hetimit, e cila u përqendrua ekskluzivisht në vdekjen e A. N., Gjykata vëren se nuk u përcaktua një afat kohor i saktë për ngjarjet në fjalë, sidomos në lidhje me të shtënat me armë zjarri ndaj viktimave të tjera.

124. Për sa i përket ekzaminimit mjeko-ligjor të trupit të A. N., qeveria nuk iu përgjigj pretendimit të kërkuësve se ky ekzaminim ishte kryer në lidhje me viktimat e tjera, por jo në lidhje me A. N. (shihni paragrafin 104 më lart). Ndonëse Qeverisë iu kërkuar të jepte një kopje të dosjes së hetimit, ajo nuk dha një kopje të letërporosisë dërguar autoriteteve turke në vitin 2011, në mënyrë që të sqarohej se çfarë ekzaminimesh kishin kërkuar që të kryheshin në trupin e A. N. qeveria nuk dha as ndonjë nga raportet e prodhuara nga autoritetet turke në këtë drejtim.

125. Raporti i ekspertimit i datës 5 maj 2014 (shihni paragrafin 70 më lart) – i cili u mbështet në raportet e mëparshme (domethënë, të dhënat mjekësore që datojnë kur A. N. ishte shtruar fillimisht në Spitalin e Traumës së Tiranës dhe një raport të hartuar nga autoritetet turke kur ata kishin nxjerrë plumbin nga trupi i A. N.) dhe është përgatitur disa vite pas vdekjes së viktimës – nuk i largon dyshimet e ngritura nga kërkuëset në këtë drejtim. Në lidhje me këtë është e paqartë pse ekspertiza nuk është kryer në kohën e duhur dhe në

trupin e vetë viktimës dhe jo bazuar të raporte të mëparshme.

126. Në këtë pikë, Gjykata pajtohet me konstatimin e Komisionerit të Këshillit të Evropës se autoritetet vendase ishin përballur me një detyrë të vështirë dhe delikate për hetimin e ngjarjeve të 21 janarit 2011 (shihni paragrafët 94–96 më lart). Gjykata pranon se autoritetet vendase bënë përpjekje të konsiderueshme për të identifikuar armën nga e cila doli plumbi që vrau A. N. Në fakt, për plumbin u kryen ekzaminime të shumta balistike; megjithatë, duket se nuk ka qenë e mundur të identifikohet arma nga e cila ka dalë, për shkak të dëmtimit që i është shkaktuar predhës.

127. Për sa i përket përfshirjes së kërkuësve në hetim, ato u shprehën se në mënyrë të përsëritur nuk ishin informuar nga autoritetet në lidhje me zhvillimet kryesore të hetimit dhe treguan dy letrat që i kishin dërguar prokurorëve për të kërkuar një kopje të dosjes së çështjes (shihni paragrafin 73 më lart). Qeveria nuk paraqiti asnjë provë në mbështetje të parashtrimit të saj se kërkuëset në fakt ishin përfshirë dhe ishin mbajtur të informuara për zhvillimet me hetimin. Shkresa e kërkuësve e vitit 2021 (shihni paragrafin 78 më lart), ku ato pranonin se ishin informuar për zhvillimet hetimore që kishin ndodhur para vitit 2020, nuk mjafton për të justifikuar përfundimin se ato ishin përfshirë në proces aq sa ishte e nevojshme për të mbrojtur interesat e tyre legjitime (shihni *Tsintsabadze kundër Gjeorgjisë* nr. 35403/06, § 76, 15 shkurt 2011, dhe *Aliyeva dhe Aliyev kundër Azerbajxhanit* nr. 35587/08, § 70, 31 korrik 2014). Kjo është kaq e vërtetë saqë, siç u theksua më lart, një sërë pyetjesh të kërkuësve në lidhje me hetimin kanë mbetur pa përgjigje deri më sot.

δ) Konkluzion

128. Nisur nga konsideratat e lartpërmendura, hetimi që është kryer në këtë çështje nuk mund të konsiderohet si një hetim efektiv që mund të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e atyre që janë përgjegjës për ngjarjet e pretenduara dhe në përcaktimin e të vërtetës (shihni, *mutatis mutandis*, *El Masri kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë* [GC] nr. 39630/09, §§ 191–193, GJEDN 2012 dhe *Shoqata “21 dhjetori 1989” dhe të tjerët kundër Rumanisë* nr. 33810/07 dhe 18817/08, § 144, 24 maj 2011).

129. Prandaj, Gjykata del në përfundimin se kundërshtimi paraprak i Qeverisë duhet të rrëzohet



dhe se është shkelur neni 2 i Konventës për aspektin procedural të tij.

B. Aspekti material

1. Pranueshmëria

a) Parashtrimet e palëve

i. Qeveria

130. Qeveria vuri në dukje se shkelja e aspektit material të nenit 2 të Konventës ishte pranuar nga gjykatat vendase, të cilat u kishin dhënë dëmshpërblime kërkuueseve (shihni paragrafin 85 më lart). Në përgjigje të parashtrimeve të palës së tretë (shihni më poshtë), qeveria përsëriti edhe një herë se gjykatat kombëtare e kishin pranuar faktin që forca e përdorur nga punonjësit e shtetit më 21 janar 2011 kishte qenë joproporcionale dhe parashtroi se prandaj ankimi ishte i papranueshëm për mungesën e statusit të viktimës.

ii. Kërkuueset

131. Kërkuueset nuk paraqitën komente në këtë drejtim.

iii. Pala e tretë

132. Res Publica, një organizatë joqeveritare që promovon mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, argumentoi, në veçanti, se mjetet juridike të brendshme që duheshin shteruar në kontekstin e shkeljeve të pretenduara të nenit 2 të Konventës ishin me natyrë penale, me përjashtim të atyre mjeteve juridike që kishin të bënin me argumentin se humbja e jetës kishte ardhur për shkak të një gabimi në gjykim ose pakujdesisë.

b) Vlerësimi i Gjykatës

133. Qeveria parashtroi se kërkuueset kishin humbur statusin e viktimës për shkak se Gjykata Administrative kishte pranuar se autoritetet shtetërore kishin qenë përgjegjëse për vdekjen e të afërmit të tyre të ngushtë, A. N., dhe në lidhje me këtë i kishin dhënë secilit kërkuar dëmshpërblim në shumën 12,834,097 lekë (përafërsisht 103,524 euro) për dëmin jopasuror.

134. Megjithatë, për sa i përket pagesës së dëmshpërblimit dhe aspektit material të nenit 2, Gjykata është shprehur se, në lidhje me përdorimin e paligjshëm të forcës nga punonjësit e shtetit – dhe jo thjesht faj, mosveprim ose pakujdesi – procedurat civile ose administrative që synojnë vetëm dhënien e dëmshpërblimit (në vend që të sigurohet identifikimi dhe ndëshkimi i atyre që janë përgjegjës) nuk përbëjnë mjete juridike adekuate dhe efektive që mund të sigurojnë korrigjim për ankimin bazuar në aspektin material të neneve 2 dhe 3 të Konventës

(shihni *inter alia*, *Mocanu dhe të tjerë kundër Rumanisë* [GC] nr. 10865/09 dhe 2 të tjerë, § 227, GJEDNJ 2014 (ekstrakte)). Kjo ndodh sepse, nëse autoritetet do të ishin në gjendje të kufizonin reagimin e tyre ndaj incidenteve të përdorimit të paligjshëm të forcës nga punonjësit e shtetit thjesht me dhënien e dëmshpërblimit (duke mos bërë mjaftueshëm në lidhje me ndjekjen penale dhe ndëshkimin e personave përgjegjës), do të ishte e mundur në disa raste që punonjësit e shtetit të abuzonin me të drejtat e atyre që janë nën kontrollin e tyre me pandëshkueshmëri virtuale, dhe ndalimet e përgjithshme ligjore për vrasjen, torturën dhe trajtimin çnjerëzor e poshtërues, pavarësisht rëndësisë së tyre themelore, do të ishin praktikisht joefektive (shihni *Nikolova dhe Velichkova kundër Bullgarisë* nr. 7888/03, § 55, 20 dhjetor 2007, dhe rastet e cituara aty). Mundësia për të kërkuar dhe marrë dëmshpërblim përbën vetëm një nga masat e nevojshme për të marrë dëmshpërblim për vdekjen e shkaktuar nga përdorimi i paligjshëm i forcës nga punonjësit e shtetit. Rruga tjetër e korrigjimit të nevojshëm përbëhet nga detyrimi i shtetit për të kryer një hetim efektiv që mund të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës (po aty, § 234; shihni gjithashtu *Kelly dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 30054/96, § 105 dhe *Nikolova dhe Velichkova*, cituar më lart, §§ 56 dhe 57).

135. Gjykata gjithashtu vë në dukje se ndërsa qeveria pranon se “u ushtrua dhunë joproporcionale ... nga Garda e Republikës”, ajo nuk pranon se vdekja e A. N. ishte rezultat i aktit të vrasjes me dashje. Gjykata u shpreh se aty ku nuk është vërtetuar qartë që në fillim se vdekja ka ardhur si pasojë e një aksidenti ose një akti tjetër të kryer pa dashje, dhe kur hipoteza e vrasjes së paligjshme është të paktën e diskutueshme mbi faktet, Konventa kërkon që të kryhet një hetim që plotëson pragun minimal të efektivitetit për të zbardhur rrethanat e vdekjes. Fakti që një hetim pranon përfundimisht hipotezën e një aksidenti nuk ka asnjë ndikim në këtë çështje, pasi detyrimi për të hetuar synon posaçërisht të hedhë poshtë ose të konfirmojë njëren ose tjetrën hipotezë (shihni *Mustafa Tunç dhe Fevire Tunç*, cituar më sipër, § 133).

136. Në rastin konkret, rrethanat e vdekjes së A. N. nuk u përcaktuan që në fillim në një mënyrë mjaft të qartë. Shpjegime të ndryshme ishin të mundshme dhe asnjëra prej tyre nuk ishte qartazi e pamundur



në fazat fillestare. Kështu, shteti kishte detyrimin të kryente një hetim të plotë. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren gjithashtu se, edhe pse Gjykata Administrative i gjeti autoritetet shtetërore përgjegjëse për vdekjen e A. N., ajo nuk sqaroi rrethanat e vdekjes së A. N. në një mënyrë të kuptueshme, me qëllim që të përcaktohej qartë nëse përdorimi i forcës vdekjeprurëse ishte i justifikuar. Përkundrazi, ajo vetëm konkludoi menjëherë, pa asnjë vlerësim të fakteve të çështjes, se shteti kishte qenë përgjegjës për humbjen e jetës së A. N. “jo vetëm bazuar në legjislacionin shqiptar, por edhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sepse [ai kishte] dështuar në marrjen e të gjitha masave të nevojshme për të parandaluar humbjen e jetës së të ndjerit”, pa specifikuar se cilat duhet të ishin ato masa parandaluese. Një qasje e tillë në asnjë drejtim nuk mund të kompensojë mungesën e hetimit efektiv (në këtë aspekt, shihni konkluzionin e Gjykatës në paragrafin 128 më lart).

137. Nga kjo rrjedh se dhënia e dëmshpërblimit, nisur nga rrethanat e çështjes në fjalë, nuk mund ta zhveshë shtetin nga detyrimet e tij sipas nenit 2 të Konventës për të kryer një hetim efektiv që mund të çojë në identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës. Gjykata konsideron se këto detyrime do të bëheshin imagjinare nëse statusi i viktimës së kërkuesit do të rregullohej thjesht me dhënien e dëmshpërblimit (shihni *Nikolova dhe Velichkova*, cituar më lart, § 55, dhe rastet e cituara aty; shihni gjithashtu paragrafin 134 më lart).

138. Në këtë drejtim, vlerësimi i Gjykatës për pranueshmërinë e ankimit material, sipas nenit 2, është i lidhur me vlerësimin e Gjykatës për mbrojtjen procedurale në dispozicion (shihni, për shembull, *Kopylov kundër Rusisë* nr. 3933/04, § 121, 29 korrik 2010 *Nikolova dhe Velichkova*, cituar më lart, §§ 55–56; *Gäffgen kundër Gjermanisë* [GC] nr. 22978/05, § 119, GJEDNJ 2010; dhe *Darra kundër Francës* nr. 53, 4 nëntor 2010).

139. Për sa i përket çështjes në fjalë, Gjykata konstaton se hetimi për rrethanat e vdekjes së A. N. ka qenë i mangët në disa aspekte dhe se autoritetet shtetërore nuk kanë përmbushur detyrimet e tyre procedurale, sipas nenit 2 të Konventës. Prandaj, Gjykata rrëzon kundërshtimet e Qeverisë për pranueshmërinë e këtij ankimi. Gjykata vëren se ankimi nuk është haptazi i pabazuar sipas kuptimit të nenit 35 § 3 të Konventës. Më tej, ajo vëren se nuk

është i papranueshëm për asnjë arsye tjetër. Prandaj, ai duhet të shpallet i pranueshëm.

2. Themeli

a) Parashtrimet e palëve

i. Kërkueset

140. Kërkueset parashtruan se më 21 janar 2011, komandanti i përgjithshëm i Gardës kishte urdhëruar që njerëzit e tij të hapnin zjarr ndaj protestuesve (përfshirë A.N) dhe se oficerët kishin qëlluar të gjithë në të njëjtën kohë, duke shkaktuar kështu vdekjen e katër protestuesve. Të shtënat ishin regjistruar nga kamerat dhe ishin transmetuar nga stacionet televizive lokale për t'i parë të gjithë.

141. Sipas kërkuesve, shenjat e dukshme të plumbave në gardhin e hekurt që rrethon Kryeministrinë dhe në tabelat rrugore dhe pemët aty pranë (mes treguesve të tjerë) treguan se të shtënat e Gardës ishin bërë në drejtim të turmës së protestuesve dhe (siç konstatohet nga gjykatat e brendshme) jo në ajër.

ii. Qeveria

142. Qeveria pranoi se gjatë demonstratës së 21 janarit 2011 oficerët e Gardës kishin ushtruar dhunë joproporcionale, gjë që ishte vërtetuar nga konstatimet në procesin penal dhe administrativ në nivel vendor. Më tej ajo pranoi se A. N. nuk kishte qenë pjesë e grupit të protestuesve që kishin sulmuar Kryeministrinë.

143. Megjithatë, ata parashtruan se para përdorimit të armëve të zjarrit ishin zbatuar disa masa parandaluese, përkatësisht: sigurimi i perimetrit të sigurisë të rrethimit të jashtëm me praninë e policisë; përdorimi i një barriere betoni për bllokimin e automjeteve; thirrje me megafon drejtuar protestuesve të dhunshëm që të ndalonin aktet e tyre të dhunshme; dhe një paralajmërim me gojë për mundësinë e përdorimit të armëve të zjarrit.

144. Ata pretenduan gjithashtu se policia dhe oficerët e Gardës kishin marrë udhëzime të veçanta në lidhje me përdorimin e forcës vdekjeprurëse gjatë demonstratave dhe ishin informuar për detyrat specifike që duhej të kryenin në lidhje me demonstratën e 21 janarit 2011.

iii. Pala e tretë

145. Pala e tretë u shpreh se kuadri ligjor i brendshëm, që ishte në fuqi në kohën e ngjarjeve në fjalë, nuk kishte qenë në përputhje me kërkesat e nenit 2 të Konventës, sepse ligjet në fuqi autorizonin përdorimin e forcës vdekjeprurëse edhe në raste të një sulmi të thjeshtë ose të shkatërrimit të “pronës”



dhe “objekteve”. Për më tepër, leja për të qëlluar me armë zjarri në një hapësirë publike nuk ishte objekt i parakushtit të rrezikut të qartë dhe të çastit ndaj jetës së njerëzve.

b) Vlerësimi i Gjykatës

i. Nëse shteti i paditur mori masat e nevojshme legislative, administrative dhe rregullatore për të pakësuar sa më shumë që të ishte e mundur pasojat negative të përdorimit të forcës

α) Parime të përgjithshme

146. Parimet e përgjithshme përkatëse janë shprehur në *Giuliani dhe Gaggio* (cituar më lart) si më poshtë:

“208. Neni 2 § 1 urdhëron Shtetin që jo vetëm të mos marrë jetën me dashje dhe në mënyrë të paligjshme, por edhe të marrë masat e duhura për të mbrojtur jetën e atyre që janë brenda juridiksionit të tij (shihni *LCB kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 9 qershor 1998, § 36, *Raportet* 1998 III, dhe *Osmani kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 28 tetor 1998, § 115, *Raportet* 1998 VIII).

209. Detyra kryesore e Shtetit për të siguruar të drejtën për jetën përfshin, në veçanti, krijimin e një kuadri të përshtatshëm ligjor dhe administrativ që përcakton rrethanat e kufizuara sipas të cilave punonjësit e zbatimit të ligjit mund të përdorin forcën dhe armët e zjarrit, sipas standardeve përkatëse ndërkombëtareve (shihni *Makaratzis kundër Greqisë* [GC] nr. 50385/99, §§ 57–59, GJEDNJ 2004 XI, dhe *Bakan*, cituar më lart, § 49; shihni gjithashtu paragrafët përkatës të Parimeve të OKB-së, paragrafi 154 më lart). Në përputhje me parimin e proporcionalitetit të rreptë të rrënjësuar në nenin 2 (shihni paragrafin 176 më lart), kuadri ligjor kombëtar duhet të konsiderojë armët e zjarrit në varësi të një vlerësimi të kujdesshëm të situatës (shihni, *mutatis mutandis*, *Nachova dhe të tjerët*, cituar më sipër, § 96). Për më tepër, ligji kombëtar që rregullon operacionet policore duhet të sigurojë një sistem të garancive të duhura dhe efektive kundër arbitraritetit dhe abuzimit të forcës, madje edhe kundër aksidenteve të shmangshme (shihni *Makaratzis*, cituar më lart, § 58).

β) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

147. Parimet Bazë mbi përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit nga punonjësit e zbatimit të ligjit, të miratuara nga Kongresi i Tetë i Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Krimit dhe Trajtimin e Autorëve (Havana, Kubë, 27 gusht deri më 7 shtator 1990), parashikojnë, *inter alia*, se “agjencitë e zbatimit të ligjit do të miratojnë dhe zbatojnë rregulla dhe rregullore mbi përdorimin e forcës dhe armëve të zjarrit kundër njerëzve nga punonjësit e zbatimit të ligjit” (shihni *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lart, § 154).

148. Gjykata përsërit se në çështje të mëparshme të ngjashme ajo ka shqyrtuar kuadrin ligjor ose rregullator ekzistues, në lidhje me përdorimin e forcës vdekjeprurëse (shihni *McCann dhe të tjerët*, cituar më lart, § 150, dhe *Makaratzis kundër Greqisë*

[GC] nr. 50385/ 99, §§ 56–59, GJEDNJ 2004 XI). E njëjta qasje pasqyrohet në Parimet Bazë të OKB-së, të cilat tregojnë se ligjet dhe rregulloret që rregullojnë përdorimin e forcës duhet të jenë mjaft të detajuara dhe duhet të përshkruajnë, *inter alia*, llojet e armëve dhe municioneve të lejuara. Kështu, Gjykata do të analizojë kuadrin ligjor të përdorimit të forcës vdekjeprurëse, të cilin kërkuesit e konsideruan si të pamjaftueshëm (krahasoni *Tagayeva dhe të tjerët kundër Rusisë* nr. 26562/07 dhe 6 të tjerët 6, § 592, 13 prill 2017).

149. Vlen të theksohet se kuadri rregullator për përdorimin e forcës vdekjeprurëse nga punonjësit e shtetit u ndryshua në vitin 2014, me ligjin 72/2014, “Për armët e zjarrit” dhe në vitin 2021, nga ligji 33/2021, “Për Gardën e Republikës”. Megjithatë, Gjykata nuk e ka për detyrë të krahasojë cilësinë e kuadrit ligjor përkatës para dhe pas ngjarjeve në fjalë *in abstracto* (krahasoni *Svitlana Atamanyuk dhe të tjerët kundër Ukrainës* nr. 36314/06 dhe 3 të tjerë, § 132, 1 shtator 2016).

150. Në kohën e ngjarjeve në fjalë, dispozitat përkatëse mbi përdorimin e armëve të zjarrit u parashikuan në ligjin për armët e zjarrit 1998, të ndryshuar në 2010, dhe ligjin për Gardën e Republikës 2003, të ndryshuar në 2005 (shihni paragrafët 89 dhe 90 më lart). I pari zbatohet për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, polici të tjera të armatosura të krijuara me ligj (të cilët nuk ishin pjesëtarë të Forcave të Armatosura) dhe roje të armatosura civile; i dyti kishte të bënte vetëm me Gardën e Republikës. Ata ishin plotësues të njëri-tjetrit. Gjykata vëren se neni 2 i ligjit për Armët e Zjarrit përcaktonte rrethanat në të cilat lejohej përdorimi i armëve të zjarrit dhe parashikonte masat mbrojtëse në këtë drejtim – për shembull, përdorimi i armëve të zjarrit duhej të përbënte një përgjigje ndaj një sulmi të padrejtë, real dhe të pashmangshëm që duhej të ishte në proporcion me rrezikun me të cilin përballej. Megjithatë, si ligji për Armët e Zjarrit ashtu edhe ligji për Gardën e Republikës, në fuqi në kohën përkatëse, lejonin përdorimin e armëve të zjarrit (dhe për rrjedhojë të forcës potencialisht vdekjeprurëse) për mbrojtjen e pronës. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se ligji për Armët e Zjarrit përcaktonte se: “dëmi i shkaktuar [nuk duhet të jetë] më i madh se dëmi i zmbrapsur”. Duke pasur parasysh formulimin e ligjit të brendshëm në këtë pikë, mund të thuhet se vetëm dëmtimi ndaj pronës nuk mund të konsiderohet përgjithësisht “më i



madh” se rreziku për jetën e një personi. Sido që të jetë, Gjykata e konsideron problematik faktin që në kohën në fjalë, ligji përkatës autorizonte përdorimin e armëve të zjarrit për mbrojtjen e pronës pa dhënë detaje të mëtejshme për llojin e rrethanave të jashtëzakonshme në të cilat mund të justifikohet përdorimi i armëve të zjarrit. Ajo që është më e rëndësishme për çështjen në fjalë është fakti që ligji për Gardën e Republikës lejonte gjithashtu përdorimin e “armëve” “në rastin e një sulmi ndaj objekteve [që janë] në ruajtje”.

151. Gjithashtu, ligji për Armët e Zjarrit, edhe pse në përgjithësi ndalonte përdorimin e armëve të zjarrit “në vende publike ku ka grumbullime njerëzish dhe jeta e të tjerëve vihet në rrezik”, lejonte disa përjashtime në këtë drejtim – veçanërisht për mbrojtjen e pronës. Edhe pse përdorimi i armëve të zjarrit për mbrojtjen e pronës në vende publike ku ka grumbullime njerëzish ishte i kufizuar nga disa masa mbrojtëse (si p.sh. përcaktimi që armët e zjarrit mund të përdoren vetëm kundër personave që kryenin akte të dukshme dhune që përbëjnë shkelje të rënda të ligjit, dhe vetëm kur masat e tjera kufizuese nuk kishin dhënë rezultatet e dëshiruara), Gjykata vëren se neni 2 i Konventës nuk lejon përdorimin e forcës vdekjeprurëse për mbrojtjen e pronës si të tillë. Nëse nuk mund të përjashtohet plotësisht që përdorimi i forcës vdekjeprurëse për mbrojtjen e pronës mund të justifikohet në disa rrethana të jashtëzakonshme, këto rrethana duhet të përcaktohen qartë. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se kuadri i ri ligjor ende i referohet “zmbropsjes së sulmit ndaj një objekti në ruajtje”, por përmban një kusht të ri – nëse është qartësisht e dukshme që jeta e personit, i cili e siguron atë, ose personave të tjerë është në rrezik.

152. Në fakt, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes në fjalë, mbrojtja e pronës – përkatësisht Kryeministrisë – ishte një nga justifikimet e paraqitura nga autoritetet për përdorimin e armëve të zjarrit. Për më tepër, Gjykata gjithashtu vë në dukje se ligjet e cituara nuk parashikojnë që përpara se të qëllonin në drejtim të njerëzve duhej të bëhej një paralajmërim me gojë dhe një e shtënë paralajmëruese në ajër.

ii. Nëse përdorimi i forcës vdekjeprurëse ishte i justifikuar

α) Parime të përgjithshme

153. Parimet e përgjithshme përkatëse janë shprehur në *Giuliani dhe Gaggio*, të cituar më lart) si më poshtë:

“174. Gjykata rithekson se neni 2 renditet si një nga dispozitat më themelore të Konventës, i tillë që, në kohë paqeje, nuk pranon asnjë shmangie sipas nenit 15. Së bashku me nenin 3, ai shpreh një nga vlerat themelore të shoqërive demokratike që përbëjnë Këshillin e Evropës (shihni, mes shumë autoriteteve të tjera, *Andronicou dhe Constantinou kundër Qipros*, 9 tetor 1997, § 171, *Raportet e vendimeve* 1997 VI, dhe *Solomou dhe të tjerët kundër Turqisë* nr. 36832/ 97, § 63, 24 qershor 2008).

175. Përjashtimet e përcaktuara në paragrafin 2, tregojnë se neni 2 përfshin por nuk ka të bëjë ekskluzivisht me vrasjen me dashje. Teksti i nenit 2, i lexuar në tërësi, tregon se paragrafi 2 nuk përcakton kryesisht rastet kur lejohet vrasja me dashje e një personi, por përshkruan situatat kur lejohet “përdorimi i forcës” që mund të rezultojë në marrjen e jetës, si një rezultat i paqëllimshëm. Megjithatë, përdorimi i forcës duhet të jetë jo më shumë se aq sa është “absolutisht i nevojshëm” për arrijtjen e një prej qëllimeve të përcaktuara në nënparagrafët “a”, “b” ose “c” (shihni *McCann dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 27 shtator 1995, § 148, Seria A, nr. 324, dhe *Solomou dhe të tjerët*, cituar më sipër, § 64).

176. Përdorimi i termit “absolutisht e nevojshme” tregon se duhet të përdoret një test më i rreptë dhe më bindës i domosdoshmërisë sesa ai që zakonisht zbatohet kur përcaktohet nëse veprimi i Shtetit është “i nevojshëm në një shoqëri demokratike” sipas paragrafëve 2, të neneve 8 deri në 11, të Konventës. Në veçanti, forca e përdorur duhet të jetë rreptësisht proporcionale me arrijtjen e qëllimeve të përcaktuara në nënparagrafët 2 “a”, “b” dhe “c”, të nenit 2. Gjithashtu, në përputhje me rëndësinë e kësaj dispozite në një shoqëri demokratike, Gjykata, gjatë vlerësimit të saj, duhet të shqyrtojë marrjen e jetës në mënyrën më të kujdesshme, veçanërisht kur përdoret forca vdekjeprurëse me dashje, duke marrë parasysh jo vetëm veprimet e punonjësve të shtetit që administrojnë forcën, por edhe të gjitha rrethanat e tjera, duke përfshirë çështje të tilla si planifikimi dhe kontrolli i veprimeve që merren në shqyrtim (shihni *McCann dhe të tjerët*, cituar më lart, §§ 147–150, dhe *Andronicou dhe Constantinou*, cituar më lart, § 171; shihni gjithashtu *Anşar kundër Turqisë* nr. 25657/94, § 391, GJEDNJ 2001 VII, dhe *Musayev dhe të tjerët kundër Rusisë* nr. 57941/00, 58699/00 dhe 60403/00, § 142, 26 korrik 2007).

177. Rrethanat në të cilat mund të justifikohet marrja e jetës duhet të interpretohen në mënyrë tepër të rreptë. Objekti dhe qëllimi i Konventës, si instrument për mbrojtjen e qenieve njerëzore individuale, kërkon gjithashtu që neni 2 të interpretohet dhe të zbatohet në mënyrë që t’i bëjë garancitë e tij praktike dhe efektive (shihni *Solomou dhe të tjerët*, cituar më sipër, § 63). Në veçanti, Gjykata shprehet se hapja e zjarrit, kurdoherë që është e mundur, duhet të paraprihet nga të shtëna paralajmëruese (shihni *Kallis dhe Androulla Panayi kundër Turqisë* nr. 45388/99, § 62, 27 tetor 2009; shihni gjithashtu, në veçanti, paragrafin 10 të Parimeve të OKB-së, paragrafi 154 më lart).

178. Përdorimi i forcës nga punonjësit e shtetit për zbatimin e një prej qëllimeve të përcaktuara në paragrafin 2, të nenit 2, të Konventës, mund të justifikohet sipas kësaj dispozite kur bazohet në bindje të vërtetë që perceptohet, për arsye të mira, se është e vlefshme në atë kohë, por që më pas rezulton e gabuar. Qëndrimi i kundërt do të ishte imponimi i një barre joreale mbi Shtetin dhe punonjësit e tij të zbatimit të ligjit, për ekzekutimin e detyrës së tyre, ndoshta në dëm të jetës së tyre



dhe të të tjerëve (shihni *McCann dhe të tjerët*, cituar më lart, § 200, dhe *Andronicou dhe Constantinou*, cituar më lart, § 192).

179. E shkëputur nga ngjarjet në fjalë, Gjykata, kur i kërkohet të shqyrtojë nëse përdorimi i forcës vdekjeprurëse ishte legjitim, nuk mund të zëvendësojë vlerësimin e situatës prej saj me atë të një oficeri të cilit i është kërkuar të reagojë në momentin e nxehtë për të shmangur një rrezik të perceptuar në të vërtetë ndaj jetës së tij (shihni *Bubbins kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 50196/99, § 139, GJEDNJ 2005 II).

180. Gjykata duhet të jetë gjithashtu e kujdesshme në marrjen e rolit të gjykatës së faktit të shkallës së parë, kur kjo nuk është e pashmangshme nga rrethanat e një çështjeje të veçantë (shihni, për shembull, *McKerr kundër Mbretërisë së Bashkuar* (dec.) nr. 28883/95, 4 prill 2000). Si rregull i përgjithshëm, kur janë zhvilluar procese të brendshme, nuk është detyrë e Gjykatës që të zëvendësojë vlerësimin e fakteve prej saj me atë të gjykatave vendase dhe u takon këtyre të fundit të përcaktojnë faktet në bazë të provave përpara tyre (shihni, mes shumë autoriteteve të tjera, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 16 dhjetor 1992, § 34, Seria A nr. 247 B, dhe *Klaas kundër Gjermanisë*, 22 shtator 1993, § 29, Seria A, nr. 269). Megjithatë Gjykata nuk është e detyruar nga gjetjet e gjykatave vendase dhe mbetet e lirë të bëjë vlerësimin e saj në dritën e të gjithë materialit para saj, në rrethana normale ajo kërkon elemente bindëse që ta shtyjë atë të largohet nga gjetjet e faktit të nxjerra nga gjykatat e brendshme (shihni *Anvar*, cituar më sipër, § 283, dhe *Barbu Anghelescu kundër Rumanisë* nr. 46430/99, § 52, 5 tetor 2004).

181. Për të vlerësuar provat faktike, Gjykata miraton standardin e të provuarit “përtej dyshimit të arsyeshëm”, por shton se të provuarit e tillë mund të rrjedhë nga bashkëekzistenca e konkluzioneve mjaftueshëm të forta, të qarta dhe të përputhshme ose e supozimeve të ngjashme të pakundërshtuara të faktit. Në këtë kontekst, mund të merret parasysh edhe sjellja e palëve gjatë marrjes së provave (shihni *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 18 janar 1978, § 161, Seria A nr. 25, dhe *Orban kundër Turqisë* nr. 25656/94, § 264, 18 qershor 2002). Për më tepër, niveli i bindjes së nevojshme për të arritur në një përfundim të caktuar dhe, në lidhje me këtë, shpërndarja e barrës së provës janë të lidhura thellësisht me specifikën e fakteve, natyrën e pretendimeve të ngritura dhe të drejtën në fjalë të Konventës. Gjykata është gjithashtu e vëmendshme ndaj seriozitetit që i kushton një vendimi që një Shtet Kontraktues ka shkelur të drejtat themelore (shihni *Ribitsch kundër Austrisë*, 4 dhjetor 1995, § 32, Seria A, nr. 336; *Ilaşcu dhe të tjerët kundër Moldavisë dhe Rusisë* [GC] nr. 48787/99, § 26, GJEDNJ 2004 VII; *Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë* [GC] nr. 43577/98 dhe 43579/98, § 147, GJEDNJ 2005 VII; dhe *Solomon dhe të tjerët*, cituar më lart, § 66).

182. Gjykata duhet të jetë veçanërisht vigjilente në rastet kur pretendohen shkelje të neneve 2 dhe 3 të Konventës (shihni, *mutatis mutandis*, *Ribitsch*, cituar më lart, § 32). Duhet pasur parasysh se në procese penale në gjykatat e brendshme në lidhje me këto pretendime, përgjegjësia penale ligjore është e ndryshme nga përgjegjësia e shtetit sipas Konventës. Kompetenca e Gjykatës kufizohet të kjo e fundit. Sipas Konventës përgjegjësia bazohet në dispozitat e saj të cilat duhet të interpretohen në dritën e objektit dhe qëllimit të Konventës, duke marrë parasysh çdo rregull apo parim përkatës të së drejtës ndërkombëtare. Përgjegjësia e një shteti sipas Konventës, që

lind për veprimet e organeve, agjentëve dhe nëpunësve të tij, nuk duhet të ngatërrohet me çështjet e brendshme ligjore të përgjegjësisë penale individuale që shqyrtohen në gjykatat penale kombëtare. Gjykata nuk përpiqet që të dalë me gjetje për fajësinë ose pafajësinë në këtë kuptim (shihni *Tanli kundër Turqisë* nr. 26129/95, § 111, GJEDNJ 2001 III, dhe *Anvar*, cituar më lart, § 284).

β) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

154. Gjykata rithekson se, kur i kërkohet të shqyrtojë nëse përdorimi i forcës vdekjeprurëse ishte legjitim në një çështje me persona të plagosur ose të vrarë nga punonjësit e shtetit, ajo ka aftësi të kufizuar për vërtetimin e fakteve. Për rrjedhojë, dhe në përputhje me parimin e subsidiaritetit, Gjykata preferon të mbështetet, aty ku është e mundur, në gjetjet e autoriteteve të brendshme sipas juridiksionit përkatës, siç janë gjykatat ose një organ parlamentar i krijuar për qëllime të gjetjes së fakteve (shihni, për shembull, *Perişan dhe të tjerët kundër Turqisë* nr. 12336/03, § 75, 20 maj 2010, dhe *Ceyhan Demir dhe të tjerët kundër Turqisë* nr. 34491/97, § 95, 13 janar 2005), pa hequr dorë plotësisht nga kompetenca e saj mbikëqyrëse, me mirëkuptimin që ajo mund të konsiderojë një vlerësim të ri të provave (shihni *Kavaklıoğlu dhe të tjerët kundër Turqisë* nr. 15397/02, § 168, 6 tetor 2015, dhe *Kukbalashvili dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë* nr. 8938/07 dhe 41891/07, § 147, 2 prill 2020). Mbështetja e Gjykatës në provat e marra si rezultat i një hetimi të brendshëm dhe në faktet e vërtetuara brenda proceseve të brendshme në fjalë do të varet gjerësisht nga cilësia e procesit hetimor vendas, si dhe tërësia dhe vijueshmëria e tij (shihni *Finogenov dhe të tjerët*, cituar më lart, § 238, me referenca të mëtejshme).

155. Gjykata vëren se Gjykata Administrative vendosi që shteti ishte përgjegjës për vdekjen e A. N. dhe që qeveria pranoi se gjatë demonstratës më 21 janar 2011 oficerët e Gardës kishin përdorur forcë vdekjeprurëse disproporcionale. Gjykata nuk shih asnjë arsye për të mos pranuar konkluzionet e Gjykatës Administrative ose pranimin nga qeveria të përgjegjësisë së shtetit për vdekjen e A. N. Megjithatë, as Gjykata Administrative dhe as qeveria nuk dhanë ndonjë detaj në lidhje me rrethanat që çuan në vdekjen e A. N. dhe veprimet ose mosveprimet nga ana e punonjësve të shtetit që kishin shkaktuar përgjegjësinë e Shtetit sipas nenit 2. Në veçanti, nuk është vërtetuar pozitivisht në nivel kombëtar që A. N. vdiq si rezultat i përdorimit të armës së zjarrit nga një punonjës i caktuar i Gardës, as nuk është vërtetuar identiteti i atij punonjësi apo



ndonjë personi tjetër të implikuar. Gjykata Administrative u shpreh se më 21 janar 2011 oficerët e Gardës kishin përdorur armët e tyre në një mënyrë që ishte në kundërshtim me ligjin për Armët e Zjarrit. Ajo doli në përfundimin se autoritetet shtetërore ishin përgjegjëse për humbjen e jetës së A. N. pasi ato “kishin dështuar të merrnin të gjitha masat e nevojshme për të shmangur humbjen e jetës së të ndjerit” (shihni paragrafin 87 më lart). Prandaj, Gjykata do të vijojë mbi bazën, e pakontestueshme nga palët, se A. N. u vra si rezultat i përdorimit të armëve të zjarrit nga oficerët e Gardës së Republikës më 21 janar 2011.

156. Në kuadër të procesit penal ndaj oficerëve të Gardës, nga i cili u veçua çështja e A. N., Gjykata e Apelit Tiranë arriti në përfundimin se të shtënat në ajër nga oficerët e Gardës më 21 janar 2011 (madje edhe faktin që ishin përdorur plumbat e vërtetë) përbënin një mjet përgjithësisht të ligjshëm për të zbrapsur sulmet e dhunshme të vazhdueshme dhe përpjekjet e një grupi protestuesish për të hyrë në ndërtesën e Kryeministrit. Megjithatë, vlerësimi i fakteve në ato procese penale ishte i kufizuar dhe nuk dha një pasqyrë të plotë të rrethanave që i kishin paraprirë përdorimit të forcës vdekjeprurëse nga Garda e Republikës. Prandaj, siç e ka përcaktuar tashmë Gjykata në vlerësimin e saj sipas aspektit procedural të nenit 2, autoritetet e ndjekjes penale nuk arritën të paraqisnin, gjatë hetimit ose procesit për aktakuzën, një kronologji të saktë të momentit(eve) kur katër viktimat kryesore u qëlluan (shihni paragrafin 117 më lart).

157. Gjykata vëren se demonstrata nuk mund të shihet si paqësore, siç u dëshmuar nga dëmtimi i pronës dhe lëndimet e pësuar nga oficerë të shumtë të Gardës (shihni paragrafët 12–14 më lart). Kur rreth orës 16:00, një grup protestuesish sulmuan portën e hekurt të makinave në anën veriore të ndërtesës dhe hynë përtej oborrit, oficerët u përballën me akte dhune dhe me një shkelje të mundshme të kordonit të sigurisë. Ky përshkallëzim u prit fillimisht me një paralajmërim të dhënë me megafon dhe më pas me një përpjekje në dukje të suksesshme nga një grup oficerësh, të pajisur me mburoja dhe shkopinj gome, për të shtyrë protestuesit nga oborri. Megjithatë, shumë shpejt më pas, disa oficerë filluan të përdornin armët e tyre të zjarrit, duke qëlluar me plumba manovër dhe të vërtetë, gjë që rezultoi në vdekjen e tre protestuesve në vend dhe në plagosjen e A. N. që rezultoi fatale.

158. Gjykata vëren në këtë moment se nuk ka pasur asnjë diskutim në nivel vendor nëse mund të ishin përdorur më shumë mjete jovdekjeprurëse të shpërndarjes së turmave. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se topat e ujit dhe gazi lotsjellës janë përdorur vetëm një herë, dhe qeveria nuk ka dhënë asnjë shpjegim nëse forcat e sigurisë kishin në dispozicion mjete të mjaftueshme jovdekjeprurëse për kontrollin e turmës.

159. Për sa i përket çështjes nëse përdorimi i forcës vdekjeprurëse ishte legjitim, qeveria e pranoi se nuk ishte legjitim. Gjykata rithekson se përdorimi i forcës vdekjeprurëse mund të justifikohet vetëm për një nga arsyet e renditura në nenin 2 § 2 të Konventës, përkatësisht: a) në mbrojtje të çdo personi nga dhuna e paligjshme; b) për të kryer një arrestim të ligjshëm ose për të parandaluar arratisjen; c) për të kundërshtuar një trazirë ose kryengritje. Thënë kjo, pyetja e parë që duhet të adresohet është nëse përdorimi i armëve të zjarrit kundër demonstruesve, më 21 janar 2011, u bë sipas ndonjë nga tre qëllimeve legjitime të lartpërmendura. Është e qartë se arsyet nën pikën “b” nuk ishin të vlefshme në rastin konkret. Për sa u përket arsyeve nën pikën “a” dhe “c”, Gjykata vëren se rreth orës 14:30 disa nga protestuesit filluan të hedhin sende të forta, përfshirë gurë, kundrejt kordonit të parë të policëve të zakonshëm dhe se disa nga oficerët pësuan lëndime (shihni paragrafët 12 dhe 16 më lart). Megjithatë, përdorimi i armëve të zjarrit nga Garda filloi pak pas orës 16:00, kur një grup më i vogël protestuesish të mbetur hynë në oborrin e Kryeministrit. Mbetet e paqartë se çfarë saktësisht çoi në reagimin e oficerëve që të qëllonin me armët e tyre të zjarrit, sepse protestuesit që depërtuan perimetrin e sigurisë tashmë ishin shtyrë nga një grup oficerësh të pajisur me mburoja dhe shkopinj gome (shihni paragrafët 13 dhe 14 më lart). Duke marrë parasysh afatin kohor të këtyre ngjarjeve dhe provat e tjera në dispozicion në dosjen e çështjes, nuk është provuar se në momentin kur u përdorën plumbat e vërtetë, grupi relativisht i vogël i protestuesve të dhunshëm përbënte një rrezik serioz dhe të çastit ndaj ndonjë personi – duke përfshirë vetë oficerët e Gardës ose ndonjë nëpunësi të shtetit që mund të ketë qenë brenda ndërtesës. Në fakt, duket se arsyeja kryesore e paraqitur gjatë procesit gjyqësor kombëtar ishte se armët e zjarrit ishin përdorur në mbrojtje të sigurisë së objektit. Megjithatë, kjo në vetvete nuk mund të



konsiderohet se në rrethanat në fjalë përbën shkak legjitim për përdorimin e forcës vdekjeprurëse. Gjithashtu, nuk kishte asnjë tregues se ekzistonte një rrezik real dhe i çastit ndaj personave në ndërtesë apo ndaj ndonjë personi tjetër.

160. Gjykata e Apelit Tiranë arriti në përfundimin se dy personat, për vdekjen e të cilëve dy oficerët e Gardës ishin shpallur përgjegjës penalisht, kishin qenë viktimat rastësore të të shtënave në ajër nga oficerët në fjalë; të shtënat kishin bërë rikoshet në objekte të forta përpara se të goditeshin viktimat në fjalë. Ajo gjithashtu u shpreh se mënyra në të cilën dy të pandehurit kishin qëlluar në ajër përbënte sjellje të pakujdesshme në drejtim të dy viktimave; për më tepër, ajo u shpreh se mund të pritej që oficerët të parashikonin pasojat e mundshme të vendimit të tyre për të qëlluar me plumba të vërtetë në ajër (shihni paragrafin 62 më lart).

161. Gjykata vëren më tej se asnjëherë nuk është pretenduar se A. N. ka paraqitur kërcënim serioz ndaj punonjësve të Gardës ose ndaj objekteve në ruajtje (krahasoni *Giuliani dhe Gaggio*, cituar më lart, §§ 254 dhe 259; krahasoni gjithashtu *Kakoulli kundër Turqisë* nr. 38595 /97, § 120, 22 nëntor 2005). Në fakt, është provuar se A. N. ishte duke qëndruar në trotuarin përtej bulevardit (përballë godinës së Kryeministrit) dhe nuk ka asnjë të dhënë se ai ishte përfshirë në ndonjë mënyrë në ndonjë akt të dhunshëm (shihni paragrafin 15 më lart).

162. Edhe nëse Gjykata pranon që oficerët nuk kanë bërë asgjë më shumë se kanë qëlluar në ajër për paralajmërim, nuk është treguar se kjo është kryer në përputhje me kërkesat e nenit 2. Në lidhje me këtë, Gjykata rithekson se, sipas përkufizimit, të shtënat paralajmëruese duhet të bëhen në ajër, me armën mbajtur pothuajse në drejtim vertikal, në mënyrë që të sigurohet që objektivi të mos qëllohet (shihni *Oğur kundër Turqisë* [GC] nr. 21594/93, § 83, GJEDNJ 1999-III, dhe *Kakoulli*, cituar më sipër, § 118). Kjo ishte edhe më thelbësore në rastin konkret, pasi kishte të bënte me një demonstratë ku morën pjesë një numër i madh personash, dhe çdo veprim i pakujdesshëm nga ana e oficerëve të gardës për përdorimin e armëve të zjarrit mund të kishte pasur një rezultat fatal. Rrjedhimisht, është e vështirë të imagjinohet që të shtënat në ajër në një kënd të kujdesshëm mund të kenë goditur në kokë viktimën që qëndronte në nivelin e rrugës, madje edhe si

rezultat i një rikosheti (krahasoni *Oğur*, cituar më lart, § 83).

163. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se, edhe nëse supozohet që A. N. është vrarë nga një plumb i gjuajtur në ajër, kjo gjuajtje është ekzekutuar keq; nuk u bë kujdes për të minimizuar në masën më të madhe të mundshme çdo rrezik ndaj jetës së kalimtarëve jo të dhunshëm, deri në atë masë sa përbënte pakujdesi të rëndë (po aty, § 83). Në fakt, sipas ligjeve aktualisht në fuqi në Shqipëri, gjuajtja në ajër është krejtësisht e ndaluar si metodë për shpërndarjen e turmës (shihni paragrafin 90 më lart).

iii. Nëse organizimi dhe planifikimi i operacioneve policore ishte në përputhje me detyrimin për të mbrojtur jetën, i cili lind nga neni 2 i Konventës

α) Parime të përgjithshme

164. Parimet e përgjithshme përkatëse janë shprehur në *Giuliani dhe Gaggio* (cituar më lart) si më poshtë:

“248. Për më tepër, që të përfshihet përgjegjësia e Shtetit sipas Konventës, duhet të vërtetohet që vdekja ka ardhur si pasojë e moskryerjes nga ana e autoriteteve kombëtare të asaj që mund të pritej në mënyrë të arsyeshme prej tyre për të shmangur një rrezik real dhe të çastit ndaj jetës për të cilin ata kishin ose duhej të kishin dijeni (shihni *Osman*, cituar më lart, § 116; *Mastromatteo*, cituar më lart, § 74; dhe *Maïorano dhe të tjerët*, cituar më lart, § 109).

249. Sipas jurisprudencës së saj, Gjykata duhet të analizojë planifikimin dhe kontrollin e një operacioni policor që rezulton në vdekjen e një ose më shumë personave, në mënyrë që të vlerësojë nëse, në rrethanat e veçanta të çështjes, autoritetet kanë treguar kujdesin e duhur për të siguruar minimizimin e çdo rreziku ndaj jetës dhe për të mos qenë të pakujdesshëm në zgjedhjen e veprimit të tyre (shihni *McCann dhe të tjerët*, cituar më lart, §§ 194 dhe 201, dhe *Andronicou dhe Constantinou*, cituar më lart, § 181). Përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga oficerët e policisë mund të justifikohet në rrethana të caktuara. Megjithatë, neni 2 nuk jep një *carte blanche*. Veprimet e parregulluara dhe arbitrare nga punonjësit e shtetit janë të papajtueshme me respektimin efektiv të të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se operacionet policore duhet të rregullohen mjaftueshëm me ligjin kombëtar, brenda kuadrit të një sistemi të masave mbrojtëse adekuate dhe efektive kundër arbitraritetit dhe abuzimit të forcës. Prandaj, Gjykata duhet të marrë parasysh jo vetëm veprimet e punonjësve të shtetit që administruan forcën, por edhe të gjitha rrethanat përreth, duke përfshirë çështje të tilla si planifikimi dhe kontrolli i veprimeve nën shqyrtim. Oficerët e policisë nuk duhet të lihen në vakum gjatë kryerjes së detyrave të tyre: një kuadër ligjor dhe administrativ duhet të përcaktojë rrethanat e kufizuara ku punonjësit e zbatimit të ligjit mund të përdorin forcën dhe armët e zjarrit, në dritën e standardeve ndërkombëtare që janë zhvilluar në këtë drejtim (shihni *Makaratzis*, cituar më lart, §§ 58–59).

250. Në veçanti, punonjësit e zbatimit të ligjit duhet të trajnohen për të vlerësuar nëse ekziston apo jo



domosdoshmëria absolute për të përdorur armë zjarri, jo vetëm bazuar në rregulloret përkatëse, por edhe duke marrë parasysh epërsinë e respektimit të jetës së njeriut si një vlerë themelore (shihni *Nachova dhe të tjerët*, cituar më lart, § 97; shihni gjithashtu kritikën e Gjykatës ndaj udhëzimeve “qëlloni për të vrarë” dhënë ushtarëve në *McCann dhe të tjerët*, cituar më lart, §§ 211–214).”.

β) Zbatimi i këtyre parimeve në çështjen në fjalë

165. Për sa i përket trajnimit paraprak të oficerëve të përfshirë, qeveria pretendoi se punonjësit e Gardës kishin marrë udhëzime të posaçme për përdorimin e forcës vdekjeprurëse gjatë demonstratave dhe ishin informuar se cilat detyra specifike duhej të kryenin. Gjykata vëren se kjo nuk kontestohet nga kërkueset.

166. Për sa i përket fazës së planifikimit dhe kontrollit të operacionit nga pikëpamja e nenit 2 të Konventës, Gjykata duhet t’i kushtojë vëmendje të veçantë kontekstit në të cilin u zhvillua operacioni, si edhe mënyrës se si u zhvillua. Në lidhje me këtë, ajo vëren se protesta para Kryeministrit ishte planifikuar dhe paralajmëruar disa ditë më parë, dhe njoftimi me shkrim për organizimin e protestës, pikat e grumbullimit të protestuesve dhe itinerarin e tyre i është dorëzuar policisë (shihni paragrafët 6 dhe 7 më lart). Kështu, është e qartë se autoritetet, Garda dhe policia nuk kishin të bënë me një operacion të paplanifikuar dhe spontan (krahasoni *Michalīkashvili dhe të tjerët kundër Gjeorgjisë* nr. 32245/19, § 101, 19 janar 2023; gjithashtu krahasoni *Makaratzis*, cituar më sipër, § 69), dhe kishin kohë të mjaftueshme për t’u përgatitur për protestën.

167. Policia dhe Garda duket se kanë formuluar plane për të mbrojtur Kryeministrin nga çdo akt i mundshëm dhune gjatë protestës. Megjithatë, në ditën në fjalë duket se janë dhënë vetëm udhëzime shumë të pakta në lidhje me mundësinë e përdorimit të forcës vdekjeprurëse – domethënë, që një grup i përbërë nga gjashtë oficerë do të ishte në gatishmëri gati për të hapur zjarr në rast të thyerjes së kordonëve përkatës të krijuar nga Njësia e Dytë dhe Njësia Speciale (shihni paragrafin 8 më lart). Nuk ka asnjë tregues se janë dhënë udhëzime të sakta dhe të qarta për masat specifike të kontrollit të turmës ose se ka pasur një koordinim adekuat paraprak në lidhje me këta dy faktorë midis Gardës dhe policisë.

168. Për sa i përket disponueshmërisë së masave jovdekjeprurëse të kontrollit të turmës për t’u përdorur kundër protestuesve të dhunshëm, oficerët kishin në dispozicion vetëm një sasi të caktuar gazi lotsjellës dhe një top uji. Kjo ishte qartësisht e

pamjaftueshme për të siguruar që një turmë të shpërndahej pa përdorur masa potencialisht vdekjeprurëse, pasi turma nuk u shpërnda dhe vazhdoi të kryente një sulm të karakterizuar nga një shkallë e caktuar dhune. Përdorimi i gazit lotsjellës me sa duket ka bërë të pafuqishëm kordonin e rregullt të policisë në perimetrin e sigurisë së Kryeministrit, për shkak se policia nuk ka pasur pajisje të mjaftueshme mbrojtëse kimike (në formën e maskave të gazit lotsjellës), dhe disa prej tyre janë lënduar edhe gjatë përballjes me protestuesit. Si rezultat, disa nga njësitë e policisë u tërhoqën në pjesën e pasme të ndërtesës dhe nuk u kthyen në pozicionet e tyre kryesore të kontrollit të turmës. Kështu njësitë e armatosura të Gardës mbetën vetëm për të trajtuar të gjitha masat e kontrollit të turmës – në afërsi të një grupi të dhunshëm.

169. Gjithashtu, duket se nuk është dhënë asnjë udhëzim i qartë dhe i saktë se kush do të jepte urdhër për përdorimin e forcës vdekjeprurëse (pra plumba të vërtetë) dhe kush do të bënte vlerësimin nëse përdorimi i armëve të zjarrit ishte absolutisht i nevojshëm. Në lidhje me këtë, Gjykata vëren se oficerët pretenduan se ata kishin vepruar me nismën e tyre, pa marrë asnjë urdhër për të qëlluar; nëse është e vërtetë, kjo në vetvete tregon mënyrën kaotike të përdorimit të armëve të zjarrit nga oficerët e Gardës. Mungesa e një zinxhiri të qartë komandimi do të kishte qenë një faktor që nga vetë natyra e tij do të kishte rritur rrezikun e disa oficerëve që të qëllonin në mënyrë të çrregullt (krahasoni *Makaratzis*, cituar më lart, § 68). Mundësia që komandantët në terren të mos kenë dhënë urdhrat e duhur në një situatë kaq të paqëndrueshme, siç pohohet nga oficerët gjatë proceseve kombëtare, ngre gjithashtu pyetje në lidhje me mjaftueshmërinë e planifikimit dhe trajtimin e drejtpërdrejtë të operacioneve të 21 janarit – duke përfshirë edhe përdorimin e forcës potencialisht vdekjeprurëse.

170. Gjykata vëren gjithashtu se paralajmërimi me gojë i bërë përpara përdorimit të armëve të zjarrit nuk përmendte në mënyrë të shprehur që oficerët do të qëllonin, por vetëm se “masa” do të ndërmerreshin “në përputhje me ligjin” (shihni paragrafin 15 më lart). Ky paralajmërim ishte i paqartë dhe i pasaktë, dhe nuk mund të konsiderohej se përbënte një paralajmërim të duhur përpara përdorimit të armëve potencialisht vdekjeprurëse.



iv. Konkluzion

171. Duke pasur parasysh vlerësimin e paraqitur më sipër, Gjykata del në përfundimin se përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga oficerët e Gardës, që rezultoi në vdekjen e të afërmit A. N. të kërkuarëve, nuk ishte në përputhje me kërkesat e rrepta të nenit 2 të Konventës. Gjykata ka gjetur mangësi në kuadrin ligjor që rregullon përdorimin e armëve potencialisht vdekjeprurëse në lidhje me operacionet e kontrollit të turmës në përgjithësi, probleme të rënda në planifikimin dhe kontrollin e ngjarjes në shqyrtim dhe dështimin për të treguar se përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga oficerët e Gardës që rezultoi në vdekjen e anëtarit të familjes së kërkuarës ishte absolutisht i nevojshëm, duke pasur parasysh rrethanat. Në fakt, qeveria e paditur ka pranuar se përdorimi i forcës ishte joproporcional. Në këto rrethana është shkelur aspekti material i nenit 2 të Konventës.

II. NENI 41 I KONVENTËS

172. Neni 41 i Konventës lexon:

“Kur Gjykata konstaton se ka pasur një shkelje të Konventës ose të protokolleve të saj dhe, nëse e drejta e brendshme e Palës së Lartë Kontraktuese lejon të bëhet vetëm një ndreqje e pjesshme, Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërbtim të drejtë palës së dëmtuar”.

173. Kërkeset nuk parashtruan pretendim për shpërbtim të drejtë. Prandaj, Gjykata konsideron se nuk kërkohet që atyre t'u jepet ndonjë shumë për këtë qëllim.

III. ZBATIMI I NENIT 46 TË KONVENTËS

174. Neni 46 i Konventës lexon si më poshtë, për atë që është e rëndësishme:

“1. Palët e Larta Kontraktuese marrin përsipër të respektojnë vendimin e formës së prerë të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë.

2. Vendimi i formës së prerë i Gjykatës i përcillet Komitetit të Ministrave, i cili mbikëqyr ekzekutimin e tij.”.

175. Sipas nenit 46 të Konventës, Palët e Larta Kontraktuese morën përsipër të respektojnë vendimet përfundimtare të Gjykatës në çdo çështje ku ato janë palë, ekzekutimi i të cilave mbikëqyret nga Komiteti i Ministrave. Nga kjo rrjedh, *inter alia*, që një vendim ku Gjykata konstaton shkelje të Konventës ose të Protokolleve të saj, vendos ndaj Shtetit të paditur detyrimin ligjor jo vetëm që t'i paguajë të interesuarve shumën e dhëna me anë të shpërblimit të drejtë, por edhe që të zgjedhë, objekt i mbikëqyrjes nga Komiteti i Ministrave, masat e përgjithshme dhe/ose, nëse është e përshtatshme, individuale që do të merren sipas rregullimit të tij

ligjor të brendshëm për t'i dhënë fund shkeljes së gjetur nga Gjykata dhe për të korrigjuar pasojat sa më shumë që të jetë e mundur (shihni *Guðmundur Andri Ástráðsson kundër Islandës* [GC] nr. 26374/18, § 311, 1 dhjetor 2020, dhe referencat aty).

176. Gjykata rithekson se vendimet e saj janë thellësisht me natyrë deklarative dhe se, në përgjithësi, i takon kryesisht Shtetit në fjalë që të zgjedhë, objekt i mbikëqyrjes nga Komiteti i Ministrave, mjetet që do të përdoren sipas rregullimit të tij ligjor të brendshëm për të përmbushur detyrimin e tij sipas nenit 46 të Konventës, me kusht që këto mjete të jenë në përputhje me përfundimet e nxjerra në vendimin e Gjykatës (shihni *Magnitskiy dhe të tjerët kundër Rusisë* nr. 32631/09 dhe 53799/12, § 295, 27 gusht 2019). Vetëm në raste përjashtimore, me synimin për të ndihmuar shtetin e paditur që të përmbushë detyrimet e tij sipas nenit 46, Gjykata do të përpikët të tregojë llojin e masës që mund të merret për t'i dhënë fund një shkeljeje që ka konstatuar (po aty, § 296).

177. Për sa i përket masave të përgjithshme, Gjykata vëren se ligjet që rregullojnë përdorimin e armëve të zjarrit kanë ndryshuar ndërkohë dhe se armët e zjarrit mund të përdoren nga punonjësit e shtetit vetëm atëherë kur është absolutisht e nevojshme për të mbrojtur jetën e personave. Të shtënat në ajër si mjet për shpërndarjen e turmës janë të ndaluara (shihni paragrafin 90 më lart). Këto rregulla zbatohen për pjesëtarët e Gardës së Republikës (shihni paragrafin 92 më lart). Meqenëse përdorimi i forcës vdekjeprurëse nga punonjësit e shtetit dhe hetimet përkatëse ngrenë çështje komplekse ligjore dhe praktike që mund të kërkojnë një sërë masash, Gjykata do të abstenojë në këtë fazë për formulimin e masave të përgjithshme. Ajo konsideron se gjetjet më sipër do të ndihmojnë për të siguruar ekzekutimin e duhur të këtij vendimi nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave (shihni *Savridin Dzburayev kundër Rusisë* nr. 71386/10, § 264, GJEDNJ 2013 (ekstrakte)). I takon Komitetit të Ministrave të vlerësojë efektivitetin e masave të propozuara nga qeveria shqiptare dhe të ndjekë zbatimin e tyre të mëvonshëm në përputhje me kërkesat e Konventës (shihni *Lindheim dhe të tjerët kundër Norvegjisë* nr. 13221/08 dhe 2139/10, § 137, 12 qershor 2012).

178. Për sa u përket masave individuale, Gjykata vëren se hetimi penal është ende i hapur. Duke pasur



parasysh këtë, ajo konsideron se autoritetet duhet të vazhdojnë (për aq sa kjo është e mundur) përpjekjet e tyre që synojnë zbardhjen e rrethanave të vdekjes së A. N. dhe identifikimin dhe ndëshkimin e personave përgjegjës, aty ku është e përshtatshme.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, ME UNANIMITET,

1. *Bashkon* me themelin kundërshtimin e qeverisë për mosshkrimin e mjeteve të brendshme, dhe *e rrëzon* atë;

2. *Shpall* kërkesën të pranueshme;

3. *Vendos* se është shkelur neni 6 § 2 i Konventës;

4. *Vendos* se është shkelur neni 6 § 2 i Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 14 nëntor 2023, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Milan Blaško
KANCELAR

Pere Pastor Vilanova
PRESIDENT

SHTOJCË

Lista e kërkuësve:

Kërkesa nr. 1049/17

Nr.	Emri i kërkuës	Viti i lindjes	Shtetësia	Vendbanimi
1	Rajmonda NIKA	1984	Shqiptare	Lezhë
2	Amelia NIKA	2009	Shqiptare	Lezhë
3	Mentila NIKA	2010	Shqiptare	Lezhë

VENDIM

Nr. 2, datë 24.10.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji i Posaçëm i Apelimit i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Çomo kryetar;
Natasha Mulaj anëtare;
Ina Rama anëtare;
Rezarta Schuetz anëtare;
Mimoza Tasi anëtare;
Albana Shtylla anëtare,

mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, në datën 24.10.2023, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit Disiplinor (JD) nr. 2/2022, datë 20.6.2022, që i përket:

ANKUESE: Belina Zeneli (Kryemadhi), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Këshilli i Lartë i Prokurorisë, përfaqësuar nga znj. Danja Hobdari dhe znj. Lorana Kasapi me autorizimin nr. 2028/1, datë 4.9.2023.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani.

OBJEKTI: Ndryshimin e vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 20, datë 31.1.2022, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër” dhe kthimin e saj në detyrë.

BAZA LIGJORE: Neni 148/d, pika 3 e Kushtetutës, neni 50, pika 4 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe neni 101, pika 1, shkronja “a” dhe pika 2, shkronja “dh” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT,

pasi shqyrtoi pretendimet e ankueses Belina Zeneli (Kryemadhi), e cila ka kërkuar pranimin e ankimit, prapësimet e subjekteve të interesuara, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që kanë kërkuar mospranimin e ankimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

1. Ankuesja, znj. Belina Zeneli (Kryemadhi) ka ushtruar detyrën e prokurores në Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së parë Dibër.

2. Inspektori i Lartë i Drejtësisë (në vijim “ILD”), me vendimin nr. {***} prot., datë 27.10.2021, “Për përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistratëve Belina Zeneli (Kryemadhi), R. K. dhe Xh. M., me detyrë prokurorë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër”, ka vendosur: [...] *Përfundimin e hetimit disiplinor ndaj magjistrates Belina Kryemadhi (Zeneli), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 1,*



shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Propozimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 111, pika 2 e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe neni 148/d, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. [...]

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”) ka administruar shkresën e ILD-së me nr. {***} prot., datë 27.10.2021, me anë të së cilës është paraqitur kërkesa “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër”, shoqëruar me raportin për hetimin disiplinor nr. {***} prot., datë 22.10.2021, dhe dosjen hetimore për zhvillimin e procedurës disiplinore në ngarkim të kësaj magjistrateje.

3.1 KLP-ja, me vendimin nr. 20, datë 31.1.2022, me shumicë votash ka vendosur: *Pranimin e kërkesës nr. {***} prot., datë 29.1.2021, të paraqitur nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për procedim disiplinor ndaj prokurores Belina Zeneli (Kryemadhi), për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë pozitën dhe figurën e prokurorit gjatë ushtrimit të detyrës, parashikuar nga neni 148/d, pika 2, germa “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, gerrat “ç” dhe “d”, neni 105, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 111, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Dhënien e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” për magjistraten Belina Zeneli (Kryemadhi), me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër.* [...]

¹ Sipas shkresës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nr. {***} prot., datë 4.9.2023, protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 6.9.2023 dhe shkresës së Këshillit të Lartë

4. Kundër vendimit të KLP-së nr. 20, datë 31.1.2022, ka ushtruar ankim magjistratja Belina Zeneli (Kryemadhi), duke kërkuar: *Ndryshimin e vendimit nr. 20, datë 31.1.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Kthimin në detyrën e prokurores pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Dibër.*

5. Kolegji për Shqyrtimin Paraprak për çështjen (JD) nr. 2/2022 të Juridiksionit Disiplinor ka vlerësuar se kërkesa e magjistrates plotëson kushtet për t’u gjykuar në seancë plenare, bazuar në nenin 31/1, pika 2, lexuar në harmoni me parashikimet e nenit 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar, si dhe në referim të nenit 5, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

5.1 Me vendimin nr. 2/1, datë 15.9.2022, Kolegji i Shqyrtimit Paraprak, bazuar në nenin 21, pika 1 e ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vendosur: *Kalimin për shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve të çështjes (JD) nr. 2/2022, datë 20.6.2022, që i përket ankimit të magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi) ndaj vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 20, datë 31.1.2022. Të thirret në gjykim si person i interesuar, Inspektori i Lartë i Drejtësisë.* [...]

6. Kolegji, në kuadër të gjykimit në seancë plenare, mbi bazë të dokumenteve të çështjes (JD) nr. 02/2022, datë 20.6.2022, me ankuesë Belina Zeneli (Kryemadhi), kërkoj propësimet/parashtrimet nga subjektet e interesuara. Në datën 6.9.2023, ILD dhe KLP kanë depozituar në Kolegj propësimet e tyre¹, ndërsa në datën 7.9.2023 ka depozituar parashtrimet e saj, si dhe disa akte bashkëlidhur tyre, edhe ankuesja, znj. Belina Zeneli (Kryemadhi)².

I. Pretendimet e magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi) në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

7. Magjistratja Belina Zeneli (Kryemadhi), nëpërmjet ankimit të depozituar në Kolegj dhe parashtrimeve të datës 7.9.2023, ka paraqitur qëndrimin e saj ndaj vendimit të KLP-së nr. 20, datë 31.1.2022, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

7.1. Lidhur me shkakun e ankimit për paligjshmërinë e vendimit të KLP-së

të Prokurorisë nr. {***} prot., datë 4.9.2023, protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 6.9.2023.

² Protokolluar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 7.9.2023.



7.1.1 Magjistratja Belina Zeneli (Kryemadhi) ka pretenduar se vendimi i KLP-së nr. 20, datë 31.1.2022, është i paligjshëm, për shkak se:

a) është nënshkruar nga anëtar S. B., i cili nuk ka qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të KLP-së të datës 20.1.2022, si dhe as në mbledhjen plenare të KLP-së, të datës 31.1.2022, kur është marrë dhe shpallur vendimi objekt ankimi; dhe

b) nuk është nënshkruar nga anëtar T. B., i cili ka qenë i pranishëm gjatë seancës dëgjimore të datës 20.1.2022, si dhe në mbledhjen plenare të datës 31.1.2022, kur është marrë dhe shpallur vendimi objekt ankimi.

c) Nga ana e ILD-së dhe KLP-së nuk është parashtruar asnjë fakt për ekzistencën e shkeljeve sipas bazës ligjore të cituar në vendimin objekt ankimi, nenin 102, pika 1, geramat “ç” dhe “d” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të cilat përcaktojnë: *c) ndërhyrja ose çdo lloj tjetër ndikimi i papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës të një magjistrati tjetër; d) përdorimi i parregullt i punës së të tjerëve për përmbushjen e detyrimeve ligjore, që i përket ushtrimit të funksionit të magjistratit ose delegimi të të tretët i aktiviteteve të caktuara magjistratit.*

7.2 Lidhur me shkakun e ankimit për moskryerjen e një hetimi të thelluar dhe moscaktimin e ekspertit nga organi administrativ

7.2.1 Ankuesja kundërshtoi mospërfshirjen e ngarkesës së saj të plotë të punës nga ana e ILD-së për një periudhë kohore 2014 - 2019, si dhe mosmarrjen e provave kryesisht, të kërkuara ILD-së gjatë hetimit disiplinor. Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesja ka depozituar edhe disa akte provuese bashkëlidhur ankimit, si më poshtë:

7.2.1.1 Urdhrin nr. {***} prot. (E/C), datë 15.7.2013, të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër (në vijim referuar “PGjShPD”) drejtuar prokurores Belina Zeneli (Kryemadhi), për të marrë masa të menjëhershme për njohjen e vendimit penal të huaj të ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme, me qëllim transferimin e të dënuarit M. alias M. B.

7.2.1.2 Urdhrin nr. {***} prot. (E/C), datë 15.7.2013, të drejtuesit të PGjShPD-së, drejtuar prokurores Belina Zeneli (Kryemadhi), për t’u paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër në seancën e datës 23.7.2013, ora 11:00 e në vazhdim, në çështjen lidhur me njohjen e vendimit penal të

huaj në ngarkim të të dënuarit Shkëlqim Skënderi, duke mos u bërë pengesë për zvarritjen e shqyrtimit ose zhvillimin e gjykimit në mungesë të prokurorisë dhe për ecurinë e gjykimit.

7.2.1.3 Urdhrin nr. {***} prot. (E/C), datë 11.6.2013, të drejtuesit të PGjShPD-së, drejtuar prokurores Belina Zeneli (Kryemadhi), për t’u paraqitur në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Dibër në seancën e datës 18.6.2013, ora 12:00 e në vazhdim, në çështjen lidhur me shqyrtimin e padisë me të dëmtuar akuzues S. K., duke mos u bërë pengesë për zvarritjen e shqyrtimit ose zhvillimin e gjykimit në mungesë të prokurorisë dhe për ecurinë e gjykimit.

7.2.1.4 Urdhrin nr. {***}, datë 8.9.2014, të drejtuesit të PGJSHPD-së, “Për ndryshimin e urdhrin nr. {***}, datë 30.5.2013, “Për mënyrën e funksionimit të zyrës së ekzekutimit të vendimeve penale dhe kontrollin e zbatimit të tyre”, sipas të cilit: *ekzekutimi i vendimeve të formës së prerë dhe të vendimeve penale me ekzekutim të menjëhershëm do të bëhet nga prokurori Belina Zeneli (prokurori i ekzekutimeve), i cili do të kujdeset për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit brenda afateve ligjore, kontrollin e zbatimit të tyre, përfaqësimin në gjykatë për çështje që lidhen me ekzekutimin e vendimeve penale të formës së prerë dhe ekzekutimin e vendimeve penale në marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja.*

7.2.1.5 Urdhrin nr. {***}, datë 9.1.2018, të drejtuesit të PGJSHPD-së, “Për caktimin e prokurorit për ekzekutimin dhe mbikëqyrjen e vendimeve penale”, i cili ka urdhëruar *caktimin e prokurorit Belina Kryemadhi (Zeneli), si prokuror për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyrjen e ekzekutimit të tyre, urdhrat e kërimit ndërkombëtar me procedurat e ekstradimit, njohjes së vendimeve penale të huaja, si dhe funksionet e tjera që kanë të bëjnë me bashkëpunimin gjyqësor me autoritetet e huaja.*

7.2.2 Sipas ankueses, çështja që i përket asaj është shqyrtuar nga KLP-ja në kushtet e moskryerjes së një hetimi të thelluar, të paanshëm dhe objektiv dhe mosvlerësimit të volumit real të punës së përballuar prej saj.

7.2.2.1 Ankuesja pretendon se në statistikën dhe në materialet që janë vënë në dispozicion nga ILD-ja, nuk janë përfshirë rrethanat, si: ngarkesa e punës e cila është e shtrirë në një periudhë kohore nga viti 2014–2019, natyra komplekse dhe voluminoze e



veprave penale³ dhe numri i të pandehurve, trajtimi i materialeve hetimore që u përkisnin prokurorëve të larguar⁴, numri i kufizuar i prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, mungesa e Oficerëve të Policisë Gjyqësore, vetëm dy të tillë, mungesa e ekspertëve me njohuri të posaçme të të gjitha profileve⁵, distanca e largët, prej gati 2 (dy) orësh, me Institucionin e Ekzekutimit dhe të Vuajtjes së Dënimeve Penale Burrel, shtrirjen e gjerë gjeografike të Qarkut Dibër, mangësitë në infrastrukturën kompjuterike dhe mungesën e sekretarisë për çështje administrative.

7.2.2.2 Ankuesja pretendon se në vitin 2019, për një periudhë disamujore është ngarkuar me hetimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2016, i cili për nga rëndësia, volumi dhe afatet kohore mori angazhimin kryesor. Për sa i përket vitit 2020, ankuesja parashtrohet se ka qenë i vështirë për të gjithë, për shkak të pandemisë Covid-19, pasi gjatë kohës së pezullimit të veprimtarisë gjyqësore, u grumbulluan më shumë materiale kallëzuese dhe iu dha përparësi çështjeve me karakter urgjent.

7.2.2.3 Ankuesja në parashtrimet e saj përpara Kolegjit ka pretenduar se me shkresën nr. {***} prot., datë 10.2.2022, i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër për t'i vënë në dispozicion të dhënave statistikore nga regjistri i veprave penale, si dhe çdo të dhënë tjetër të dokumentuar lidhur me materialet hetimore të trajtuara për periudhën kohore shtator 2008 – dhjetor 2021, por nuk ka marrë ende përgjigje.

7.2.2.4 Ankuesja parashtrohet se e ka bërë me dije ILD-në për gjendjen shëndetësore të të atit, i cili vuante nga probleme shëndetësore duke nisur nga viti 2010, si dhe të nënës, e cila vuante nga probleme shëndetësore duke nisur nga viti 2015. Për sa i përket gjendjes shëndetësore të prindërve, ankuesja ka paraqitur bashkëlidhur ankimit të saj kopje të vërtetuar me origjinalin të kartelës klinike të z. R. Z., shtruar në Shërbimin e Patologjisë së Spitalit Rajonal Dibër me nr. {***} karte, datë 29.9.2010, si dhe të

kartelës klinike të znj. B. Z., shtruar në Pavijonin e Neurologjisë së Spitalit Rajonal Dibër me nr. {***} karte, datë 27.6.2015, të shoqëruara me të dhënat përkatëse.

7.2.2.5 Ankuesja kundërshton konstatimin lidhur me faktin se ajo nuk ka qenë bashkëpunuese me ILD-në gjatë fazës së hetimit. Ajo parashtrohet se në vitin 2021, ka përballuar një situatë serioze shëndetësore dhe që është në luftë për jetën. Për sa i përket gjendjes së saj shëndetësore, ankuesja ka paraqitur kopje të vërtetuar me origjinalin të shkresës, datë 18.9.2021, të Spitalit Rajonal Durrës⁶, shprehimisht: “Echo glangula mamme bilaterale [...]”, të shoqëruar me fletën e analizës laboratorike të Spitalit Rajonal Dibër⁷, me *hematology analyse*, datë 6.6.2013⁸, me *echo* të datave 6.9.2021, 29.7.2021, 30.7.2021 dhe 11.9.2021, si dhe *diagrame*⁹.

7.2.3 Sipas ankueses, Prokurori i Përgjithshëm ka cenuar një nga parimet themelore të procesit disiplinor të garantuar nga neni 100/1, pika “g”, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe konkretisht parimin e konfidencialitetit, të së drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, nëpërmjet publikimit në datën 21.5.2021, në faqen zyrtare në internet të Prokurorisë së Përgjithshme, të njoftimit në lidhje me kërkesën drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për nisjen e procedurës së inspektimit ndaj saj, për hetimin e shkeljeve individuale të kryera në ushtrimin e detyrës, pasi ishin konstatuar veprime të cilat mund të përbënin zvarritje të rëndë të veprimtarisë procedurale, si dhe shkelje të dispozitave urdhëruese të Kodit të Procedurës Penale.

7.2.4 Sipas ankueses, nga ILD-ja ka një devijim nga objekti i hetimit, duke përmendur fakte të cilat nga ana procedurale janë parashkruar ose për të cilat ka një vendim gjykate dhe se kjo është bërë qëllimisht për të ulur figurën dhe personalitetin e ankueses. Më konkretisht:

³ Duke referuar këtu: çështje juridiksionale me jashtë, verifikimi i masave mjekësore, heqja e zotësisë për të vepruar, kërkesa të drejtpërdrejta në gjykatë ku prokuroria është palë në proces, përfshirë këqyrje të vendit të ngjarjes, urdhër regjistrimi, kërkesa për masa sigurimi personal.

⁴ Referohen procedimet penale: nr. {***} i vitit 2015 (gjykim i përfunduar në vitin 2017), nr. {***} i vitit 2017, nr. {***} i vitit 2017 (përfunduar gjykimin në vitin 2018), nr. {***} i vitit 2017 (gjykim i përfunduar në vitin 2019) etj.

⁵ Mjekoligjor, autoteknik, vlerësues, ndërtimor, psikologë etj.

⁶ Të nënshkruar nga njëri prej doktorëve të komisionit të përbërë prej 4 mjekësh.

⁷ Pa datë të qartë: “[...] data 3/8/20 [...]”.

⁸ Pa autorësi të qartë.

⁹ Pa autorësi dhe të dhëna të qarta identifikuese.



7.2.4.1 Ankuesja kundërshton evidentimin nga ana e ILD-së në raportin e të dhënave lidhur me çështje të mëparshme disiplinore dhe konkretisht të masës së largimit nga detyra të ankueses në vitin 2001, pasi qëllimisht nuk është përmendur në kontekstin e kësaj mase disiplinore të dhënë në vitin 2001, vendimi i gjykatës që ka shqyrtuar këtë vendimmarrje të Prokurorit të Përgjithshëm. Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesja ka depozituar bashkëlidhur parashtrësive aktet: (i) kërkesë për përjashtim gjyqtari nr. {***} prot., datë 20.11.2000; (ii) shkresë e Gjykatës së Rrethit Dibër nr. {***} prot., datë 21.11.2000; (iii) urdhër i Prokurorit të Rrethit Dibër nr. {***} prot., datë 3.12.2000; (iv) vërtetim i Prokurorisë së Rrethit Dibër, datë 3.9.2002; (v) vërtetim i Gjykatës së Rrethit Bulqizë nr. {***} prot., datë 17.5.2001; (vi) shkresë e Prokurorisë së Përgjithshme nr. {***} prot., datë 15.2.2001.

7.2.4.2. Gjithashtu, sipas ankueses, masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, e dhënë nga Prokurori i Përgjithshëm në vitin 2014, ka rezultuar pas një hetimi të kryer nga Drejtoria e Hetim-Inspektimit në Prokurorinë e Përgjithshme, duke lënë edhe detyra pas studimit të procedimeve penale objekt hetimi. Ankuesja argumenton se për njërin prej këtyre procedimeve penale, konkretisht atë nr. 80 të vitit 2012, për të cilin grupi i inspektimit vendosi “Prishjen e vendimit të pushimit dhe dërgimin për gjykim”, pas gjykimit, ky procedim penal është pushuar nga Gjykata e Apelit Tiranë duke vendosur sipas vendimit të prokurores (vendim i prishur nga grupi i inspektimit). Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesja ka depozituar bashkëlidhur parashtrësive, aktet: (i) urdhër i prokurorit, datë 26.3.2012, për regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, të vitit 2012, për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit B. Gj.; (ii) vendim i prokurorit, datë 15.6.2012, për pushimin e çështjes penale nr. {***} të vitit 2012, për veprën penale [...]; (iii) vendim i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, datë (s’ka).11.2013, për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2012; (iv) kërkesë për gjykim nr. {***} prot., datë 24.4.2015, për procedimin penal nr. {***} të vitit 2012, “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal; (v) vendim nr. {***}, datë 22.7.2015, i Gjykatës së

Rrethit Gjyqësor Dibër; (vi) vendim nr. {***}, datë 8.7.2016, i Gjykatës së Apelit Tiranë; (vii) fletëthirrje nga Gjykata Administrative Tiranë, për gjykimin administrativ nr. {***} regjistri, datë 2.9.2019, me objekt “Kompensim burgimi të padrejtë”, të paditësit B. Gj.

7.2.4.3 Ankuesja pretendon gjithashtu se gjatë veprimtarisë së saj, qytetarë të ndryshëm kanë depozituar ankesa ndaj procedimeve penale të hetuara apo për të cilat ajo ka përfaqësuar akuzën në gjyq dhe se në asnjë rast, nga ana e ILD-së, nuk është nisur procedim disiplinor duke vendosur arkivimin e çështjes. Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesja ka përcjellë bashkëlidhur edhe: (i) njoftim vendimi i ILD-së nr. {***} prot., datë 21.9.2022; si dhe (ii) njoftim vendimi i ILD-së nr. {***} prot., datë 20.1.2022.

8. Prapësimet e KLP-së lidhur me pretendimet e magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi)

8.1. Mbi natyrën e pretendimeve të ngritura në ankim

8.1.1 Sipas KLP-së, ankimi i magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi) nuk përmbush kriteret e pranueshmërisë për t’u bërë objekt gjykimi në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit, duke qenë se ankuesja nuk ka ngritur pretendime në nivel të cenimit të të drejtave dhe lirive të saj kushtetuese.

8.2. Në lidhje me trajtimin e problematikave të faktit të ngritura në ankim

8.2.1 Lidhur me pretendimin e ankueses se vendimi i KLP-së nr. 20, datë 31.1.2022, është i paligjshëm pasi është nënshkruar nga anëtar i S. B., që nuk ka qenë prezent në seancë dëgjimore, KLP-ja sqaron gjykatën se referuar procesverbalit audio të seancës dëgjimore të datës 20.1.2022, z. S. B. nuk ka qenë prezent për arsye shëndetësore, ndërkohë që sipas procesverbalit të mbledhjes plenare të KLP-së të datës 31.1.2022, rezulton se në diskutimin dhe votimin e çështjes së rendit të ditës, pika 2, “Diskutimi/miratimi i projektakteve për caktimin e përkohshëm të [...]”, faqe 4, përcaktohet se në këtë moment të mbledhjes plenare, KLP-së i është bashkuar edhe zoti B.. Sipas KLP-së, z. S. B., si anëtar i pranishëm në mbledhjen plenare të datës 31.1.2022, ka ushtruar të drejtën e tij për të nënshkruar aktin e kontestuar, e drejtë që u atribuohet të gjithë anëtarëve prezentë në mbledhjen plenare dhe se mospjesëmarrja në seancën dëgjimore, nuk e pengon anëtarin të nënshkruajë vendimin e marrë në seancë plenare. Kjo bazuar në



faktin që procedimi disiplinor nuk kufizohet vetëm në seancën dëgjimore që zhvillon KLP-ja mes palëve, për sa kohë anëtarët e KLP-së njihen me relacionin e përgatitur nga ana e relatorit dhe të propozuar nga ana e Komisionit Disiplinor (7 ditë përpara mbledhjes plenare), ashtu sikurse kanë të drejtën të njihen me të gjithë dosjen e procedimit dhe hetimit disiplinor të ardhur nga ILD-ja.

8.2.2 Lidhur me pretendimin e ankueses për paligjshmëri të vendimit të KLP-së nr. 20, datë 31.1.2022, pasi nuk është nënshkruar nga anëtari, z. T. B., i cili ka qenë prezent në seancën dëgjimore, KLP-ja sqaron se nga aktet shkresore të administruara, duke iu referuar këtu procesverbalit të mbledhjes plenare të KLP-së, të datës 31.1.2022, dhe konkretisht momentit kur është marrë në diskutim dhe votim çështja e rendit të ditës, “Diskutimi/miratimi i projektakteve në lidhje me procedimin disiplinor të nisur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magistrates prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër”, rezulton se z. T. B. nuk ka qenë i pranishëm dhe, për rrjedhojë, nuk ka pasur asnjë të drejtë të nënshkruajë vendimin.

8.3. Lidhur me pretendimin e magistrates për moskryerje të hetimit të thelluar administrativ

8.3.1 Pretendimi i magistrates për moskryerje të hetimit të thelluar administrativ është i pabazuar në fakte dhe në ligj. KLP-ja ka zbatuar me përpikëri procedurën e parashikuar në ligj, duke kryer një hetim të gjithanshëm dhe duke iu referuar materialeve të sjella nga palët në procedimin disiplinor, duke reflektuar gjetjet e tyre në vendimin objekt ankimi. KLP-ja ka vijuar hetimin administrativ vetëm mbi objektin fillestar të kërimit për fillimin e procedimit disiplinor nga njëri prej subjekteve të përcaktuara në ligj dhe së bashku me ILD-në kanë respektuar rigorozisht parimin mbi ruajtjen e kufijve të gjykimit, duke mos tejkaluar objektin e kërkesës fillestare të Prokurorit të Përgjithshëm, drejtuar ILD-së, e cila kishte të bënte vetëm me dosjet penale të evidentuara në mënyrë të shprehur në këtë kërkesë/ankesë.

8.3.1.1 Pretendimi i magistrates për mosmarrijen nga ana e KLP-së shkresërisht të akteve për evidentimin e punës së saj është i pabazuar, duke qenë se ankuesja kishte barrën e provës për të sjellë përpara KLP-së aktet e prodhuara prej saj, që evidentonin veprimtarinë dhe ngarkesën e saj në punë. KLP-ja i ka komunikuar ankueses nëpërmjet

shkresës nr. {***} prot., datë 18.11.2021, të drejtën për të paraqitur prova në mbështetje të mbrojtjes së saj në kuadër të procedimit disiplinor të filluar ndaj kësaj të fundit. Edhe në seancën dëgjimore të zhvilluar në KLP, ankuesja, kur është pyetur nga anëtarët e KLP-së mbi pretendimet në lidhje me ngarkesën në punë, ka dhënë përgjigjen: “Nuk e di”.

8.3.1.2 Pretendimi i magistrates për paligjshmëri të aktit të KLP-së, për shkak se ky i fundit me iniciativën e tij nuk ka caktuar ekspert, është i pabazuar në fakte dhe në ligj. Ky pretendim është ngritur nga ankuesja për herë të parë në Kolegj, nuk është kërkuar përpara KLP-së, as në prapësimet e përgatitura dhe as në seancën dëgjimore. KLP-ja, si organ administrativ, nuk e ka çmuar të nevojshëm caktimin e një eksperti, pasi për zgjidhjen e çështjes nuk ka pasur nevojë për njohuri të posaçme, të cilat nuk mund të përmbusheshin nga KLP-ja, për sa kohë në përbërje të Komisionit Disiplinor dhe të KLP-së në tërësi, një pjesë e konsiderueshme e anëtarëve janë prokurorë, të cilët kanë aftësinë dhe kapacitetin të vlerësojnë nëse funksionet dhe detyrat e magistrates (prokurore) ishin ushtruar në përputhje me ligjin apo në shkelje të tij, çështje këto që përbënin dhe objektin e procedimit disiplinor.

9. Prapësimet e ILD-së, lidhur me pretendimet e magistrates Belina Zeneli (Kryemadhi)

9.1 Lidhur me pretendimet për mangësi në veprimtarinë e hetimit disiplinor të ILD-së

9.1.1 Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pretendimet e ngritura nga ankuesja për moskryerjen e një procedure hetimi disiplinor të paanshëm dhe objektiv, janë tërësisht të pambështetura. Bazuar në kërkesat e neneve 123, pika 3, shkronja “dh”, 124 dhe 129 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe të neneve 35, 42, 45 dhe 78 të Kodit të Procedurave Administrative, nëpërmjet shkresës nr. {***}, datë 29.7.2021, ankueses i është njoftuar vendimi nr. {***}, datë 28.7.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për fillimin e hetimit disiplinor me nismë të ankuesit” dhe i janë bërë me dije të drejtat dhe detyrimet, si: (i) *Të përfaqësohet vetë ose nëpërmjet një përfaqësuesi të zgjedhur sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative.* (ii) *Aksesit në dosjen e hetimit duke kërkuar edhe kopje të akteve të saj, në atë masë që është në përputhje me objektin e hetimit.* (iii) *Të dorëzojë parashitë dhe dokumente mbështetëse brenda tri javëve nga marrja e njoftimit për*



vendimin e fillimit të hetimit disiplinor. (iv) Të kërkojë dakordësi mbi marrëveshjen e përbashkët të pranimit lidhur me shkeljen disiplinore që i atribuohet. (v) Të drejtën të njoftohet për çdo vendim që do të merret gjatë hetimit disiplinor. (vi) Të ushtrojë të drejtën e ankimit ndaj atyre vendimeve të njoftuara, për të cilat parashikohet e drejta e ankimit.

9.1.2 Nga ana e magistrates është konfirmuar dijenia për fillimin e hetimit disiplinor ndaj saj, si dhe njohja me të drejtat përgjatë hetimit. Magjistratja ka paraqitur parashtrimet e saj rreth shkeljes disiplinore që i atribuohet, shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Këto argumente janë vlerësuar nga ILD-ja gjatë fazës së hetimit disiplinor dhe mosmarrja në konsideratë e tyre është argumentuar në mënyrë të plotë në raportin e hetimit disiplinor. Vlerësimi në mënyrë të pavarur nga ana e ILD-së i parashtrimeve dhe argumenteve të ngritura nga ankuesja nuk nënkupton mangësi në realizimin e një procedure të plotë dhe të gjithanshme hetimi disiplinor.

9.1.3 Referuar jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e drejta për t'u dëguar, si një element i rëndësishëm i procesit të rregullt ligjor, që lidhet me të drejtën për të mbrojtur në substancë të drejtën që pretendohet si e shkelur dhe që lidhet kryesisht me të drejtën për të bërë kërkime dhe parashtrime, si dhe për të marrë përgjigje lidhur me to, është respektuar plotësisht gjatë hetimit disiplinor dhe procedimit disiplinor të zhvilluar respektivisht nga ILD-ja dhe KLP-ja.

9.2 Në lidhje me shkeljet e rënda profesionale të kryera nga ankuesja, për të cilat është betuar dhe proceduar disiplinarisht nga ILD-ja dhe KLP-ja

9.2.1 Për sa i takon elementit të rrethanave të kryerjes së shkeljeve disiplinore, në analizë të elementeve të referuara në vendimin nr. 75/2002 të Gjykatës Kushtetuese¹⁰, në raport me sjelljen e magistrates Belina Zeneli (Kryemadhi), ILD-së i rezultoi e provuar gjatë hetimit disiplinor se, si pasojë e veprimeve të kryera nga ana e ankueses, nuk u janë dhënë zgjidhje ligjore 32 procedimeve penale, si dhe nuk është kryer asnjë veprim verifikimi në

lidhje me 300 (treqind) kallëzime të mbartura. Kryerja e veprimeve/mosveprimeve nga ana e magistrates Belina Zeneli (Kryemadhi) ka cenuar në mënyrë të drejtpërdrejtë qëllimin (*ratio*) e institutit të respektimit të afateve të hetimit, të parashikuar nga normat procedurale penale.

9.2.1 Në lidhje me pretendimin e ankueses për ekzistencën e një ngarkese të madhe në punë, e cila është shtrirë në një periudhë kohore nga viti 2014–2019, numrit të kufizuar të prokurorëve, si dhe mungesës së oficerëve të policisë gjyqësore pranë prokurorisë, ILD-ja parashtron se ky pretendim është i pabazuar, duke qenë se në analizë të të dhënave statistikore të referuara në raportin e Prokurorisë së Përgjithshme për vitin 2020, *ka rezultuar se për këtë periudhë kohore, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër ka regjistruar 1178 kallëzime penale. Numri i procedimeve penale të regjistruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër, është 539 procedime penale gjithsej. Në lidhje me volumnin në betim për pesë vitet, numri organik i prokurorëve dhe ngarkesa për prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër rezulton:*

- Volumi në betim për vitin 2016 është 768 çështje, për vitin 2017 është 1228 çështje, për vitin 2018 është 987 çështje, për vitin 2019 është 943 çështje, për vitin 2020 është 1178 çështje.

- Numri i prokurorëve nga viti 2016–2019; kanë qenë 6 prokurorë dhe në vitin 2020 kanë qenë 4 prokurorë. Mesatarja e ngarkesës për prokurorë e volumnit në betim për vitin 2016 është 133 çështje, për vitin 2017 është 205 çështje, për vitin 2018 është 165 çështje, për vitin 2019 është 159 çështje, për vitin 2020 është 295 çështje.

Për sa më sipër, prokurorja Belina Zeneli (Kryemadhi) gjatë vitit 2020 ka përfunduar 20 procedime penale nga 207 që ka pasur nën betim, numër ky disa herë më i vogël se totali i procedimeve penale të përfunduara nga kjo prokurori. Gjatë vitit 2020, nuk ka mosfilluar asnjë material kallëzues apo referues, duke mbartur një numër prej 399 kallëzimesh penale për vitin 2021. ILD-ja parashtron se këto të dhëna tregojnë dukshëm mospërmbyllje të pajustificuar dhe të përsëritur të funksioneve, si dhe vonesa të

¹⁰ Shprehja “akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën [...]”, parashikuar nga nenet 128, 140 dhe 149, pika 2 e Kushtetutës, përmbledh në vetvete një sërë elementesh, të cilat mund dhe duhet të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Ato janë të lidhura me aktet dhe sjelljet e parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë Faqe | 21466

kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj, por edhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momentit subjektiv, si dhe nga dëmet që ato i sjellin shoqërisë e shtetit, janë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte.



përsëritura që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuar të veprimeve dhe/ose akteve procedurale, që përbëjnë shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “d” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

II. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit

A. Për legjitimitimin e ankuesit

10. Juridiksioni Disiplinor i Kolegjit të Posaçëm të Apelit është një juridiksion kushtetues, i cili do të shoqërojë veprimtarinë e tij gjatë mandatit 9-vjeçar, sipas parashikimeve të nenit 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon: *Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar, gjyqtarët e Kolegjit të Apelit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë Drejtësisë. Kolegji i Apelit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

10.1 Në vijim të këtij parashikimi kushtetues, neni 5, pika 3, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i përcakton Kolegjit të Posaçëm të Apelit bazën ligjore, mbi të cilën do të procedojë gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues që lidhet me Juridiksionin Disiplinor, konkretisht: *Kolegji i Apelit gjatë mandatit të tij, në përputhje me Kushtetutën, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe legjislacionin që rregullon çështjet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, ka juridiksion të shqyrtojë: b) ankimet kundër vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë.*

10.2 Çështja e legjitimitimit është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me iniciimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2 e Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në

Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8577/2000”), çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

10.3 Ankimi kushtetues individual duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

10.4 Në çështjen objekt shqyrtimi, lidhur me legjitimitimin e ankuesit, Kolegji vlerëson se ankuesja Belina Zeneli (Kryemadhi) legjitimohet *ratione personae*, pasi vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të cilin e ka ankimuar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, është marrë në kuadrin e një procedimi disiplinor ndaj saj dhe, për pasojë, ankuesja ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10.5 Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f” e Kushtetutës, konstatohet se neni 192, pika 1 e ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, parashikon se vendimet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë për masat disiplinore ndaj prokurorëve ankimohen në Gjykatën Kushtetuese. Bazuar në nenin 179, pika 7 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, juridiksionin disiplinor kundër vendimeve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë mandatit 9-vjeçar, e ushtron Kolegji i Posaçëm të Apelit. Pra, ankuesja nuk ka mjet tjetër ligjor ankimi, përveç atij drejtuar Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

10.6 Ankuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i Këshillit të Lartë të Prokurorisë që ankimohet, është i datës 31.1.2022¹¹, ndërsa ankimi i magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi) është protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit më datë 10.6.2022 dhe është regjistruar pas plotësimit të dokumentacionit, në datën 20.6.2022, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 8577/2000.

10.7 Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*,

¹¹ Njoftuar magjistrates në vendin e punës, me shkresën e KLP-së nr. {***} prot., datë 7.2.2022, marrë dijeni më datë

10.2.2022, sipas vulës së protokollit të Prokurorisë Dibër me nr. {***} prot., datë 10.2.2022.



Kolegji çmon se pretendimet e ankueses ndaj vendimit nr. 20, datë 31.1.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, janë pretendime që *prima facie* hyjnë në juridiksionin disiplinor të Kolegjit të Posaçëm të Apelit dhe do të shqyrtohen në vijim.

11. Vlerësimi i Kolegjit mbi shkaktuesin e ankimit të magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi) mbi paligjshmërinë e vendimit objekt ankimi

11.1 Magjistratja pretendon se vendimi nr. 20, datë 31.1.2022, i KLP-së është i paligjshëm për shkak se është nënshkruar nga anëtari z. S. B., që nuk ka qenë i pranishëm në seancën dëgjimore të datës 20.1.2022, si dhe as në mbledhjen plenare të datës 31.1.2022, kur është shpallur vendimi objekt ankimi, dhe se nuk është nënshkruar nga anëtari T. B., i cili ka qenë i pranishëm gjatë seancës dëgjimore të datës 20.1.2022, si dhe në mbledhjen plenare të datës 31.1.2022, kur është shpallur vendimi objekt ankimi.

11.2.1 Lidhur me këtë pretendim të magjistrates, Kolegji, pasi vlerësoi aktet që dokumentojnë mbledhjet e KLP-së në lidhje me procedimin disiplinor objekt ankimi, konstatoi se referuar procesverbalit audio të seancës dëgjimore të datës 20.1.2022, z. S. B. nuk ka qenë prezent në këtë seancë për arsye shëndetësore, ndërsa verifikohet prezenca në këtë seancë dëgjimore e z. T. B.. Ndërkohë që, sipas procesverbalit të mbledhjes plenare të KLP-së të datës 31.1.2022, ditën kur është marrë dhe është shpallur vendimi objekt ankimi, rezulton se në çelje të mbledhjes plenare, z. S. B. nuk ka qenë prezent, por i është bashkuar asaj në momentin kur është marrë në diskutim dhe votim çështja e rendit të ditës, pika 2, “Diskutimi/miratimi i projektakteve për caktimin e përkohshëm të zonjës S. B. [...]”¹² dhe konstatohet të mos jetë larguar deri në përfundimin e mbledhjes plenare të kësaj date dhe, rrjedhimisht, ka marrë pjesë edhe në shqyrtimin e çështjes së rendit të ditës “Diskutimi/miratimi i projektakteve në lidhje me procedimin disiplinor të nisur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistrates Belina Zeneli, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër”. Në procesverbalin e kësaj mbledhjeje evidentohet gjithashtu se regjistrimi është ndërprerë në orën 11:00, për shkak se KLP-ja do të mbledhej në dhomë këshillimi për t’u rikthyer më pas për

dhënien e vendimit lidhur me procedimin disiplinor të magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi). Në këtë moment të mbledhjes, sipas procesverbalit, konstatohet se mungojnë anëtarët e KLP-së, z. S. S., znj. E. K. dhe z. T. B.. [...]

11.2.2 Në këto kushte, Kolegji, pas verifikimit të përmbajtjes së procesverbalit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me nr. {***} prot., datë 15.2.2022, në të cilin dokumentohet mbledhja plenare e datës 31.1.2022, e KLP-së, ku pjesë e rendit të ditës ka qenë edhe: 4. *Diskutimi/miratimi i projektakteve në lidhje me procedimin disiplinor të nisur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistrates prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër*, dorëzuar si provë bashkëlidhur parashitësive edhe nga vetë magjistratja, u konstatua se sa pretenduar prej saj në lidhje me mosprezencën në mbledhjen plenare të KLP-së të datës 31.1.2022, të anëtarit të KLP-së S. B., dhe prezencës së anëtarit të KLP-së T. B., në seancën plenare të kësaj date, në momentin e shqyrtimit të pikës 4 të rendit të ditës, nuk bazohet në fakte dhe në prova. Për rrjedhojë, bazuar në parashikimet e neneve 164, 166 dhe 167 të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, vlerësohet se pretendimi i ankueses për paligjshmëri të vendimit objekt ankimi, si pasojë e nënshkrimit të vendimit nga anëtari S. B. dhe mosnënshkrimit nga anëtari T. B. është i pabazuar në fakte dhe në ligj, duke qenë se rezultoi e bazuar se nënshkrimi dhe mosnënshkrimi i vendimit nga anëtarët e sipërcituar të Këshillit të Lartë të Prokurorisë është kryer në përputhje me parashikimet përkatëse ligjore dhe pasqyron situatën faktike që lidhet me prezencën dhe marrjen pjesë të tyre në vendimarrje, siç provohet nga aktet që dokumentojnë mbledhjen plenare të KLP-së të datës në të cilën është marrë vendimi objekt ankimi, akte këto të përpiluara sipas urdhërimit përkatës ligjor.

11.2.3 Kolegji e gjen të pabazuar në fakte dhe në ligj edhe pretendimin tjetër të ankueses se nga ana e ILD-së dhe KLP-së nuk është parashtruar asnjë fakt për ekzistencën e shkeljeve sipas bazës ligjore të cituar në vendimin objekt ankimi, nenin 102, pika 1, germet “ç” dhe “d” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të cilat, sipas ankueses, përcaktojnë

¹² Shih faqen 4 të procesverbalit të mbledhjes plenare të KLP-së të datës 31.1.2022.



shkeljet disiplinore “Ndërhyrja ose çdo lloj tjetër ndikimi i papërshtatshëm në ushtrimin e detyrës të një magjistrati tjetër” dhe “Përdorimi i parregullt i punës së tjerëve për përmbushjen e detyrimeve ligjore, që i përkasin ushtrimit të funksionit të magjistratit ose delegimi të të tretët i aktiviteteve të caktuara magjistratit”. Kolegji konstaton se ankuesja në parashtrimin e këtij pretendimi si shkak për paligjshmëri të vendimit të KLP-së objekt ankimi, nuk u është referuar: (i) as shkeljeve disiplinore të përcaktuara në mënyrë të shprehur nga KLP-ja në vendimin e ankimuar, të cilat kanë të bëjnë me *mospërmbushjen e pajustifikuar ose të përsëritur të funksioneve gjatë gjyqimit ose hetimit dhe vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustifikuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale*¹³, për të cilat rezulton të jenë parashtruar në mënyrë të plotë faktet dhe rrethanat e këtyre shkeljeve disiplinore të provuara gjatë procedimit disiplinor; dhe (ii) as përmbajtjes së dispozitës ligjore të cituar në bazën ligjore të vendimit të KLP-së objekt ankimi, e cila ka qenë në fuqi në kohën e nisjes së procedimit disiplinor, përcaktim ky që identifikon sjelljet e magjistrates që përbëjnë shkelje disiplinore. Magjistratja duket t'i jetë referuar përmbajtjes së germave “ç” dhe “d” të pikës 1 të nenit 102 të ligjit nr. 96/2016, para shfuqizimit të tij me vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 34, datë 10.4.2017, si dhe hyrjes në fuqi të ligjit nr. 48/2019, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me të cilin u bë plotësimi i këtij neni.

11.2.4 Në këto kushte, duke u bazuar edhe në parashikimet e nenit 120 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit ankesa ndaj sjelljes së magjistratit përmbush kriteret e pranueshmërisë për t’ju nënshtruar hetimit disiplinor, nëse bëhet ndaj sjelljes së magjistratit të parashikuar si shkelje disiplinore nga ligji në fuqi në kohën kur shkelja e pretenduar ka ndodhur, si dhe ndaj sjelljes së magjistratit që nëse provohet se është kryer, përbën shkelje disiplinore të parashikuar edhe nga ligji në momentin e pranimit të ankesës, Kolegji e gjen të bazuar kualifikimin ligjor të shkeljeve disiplinore nga ana e ILD-së dhe në vijim nga ana e KLP-së në vendimin objekt ankimi, referuar përcaktimit të tyre në dispozitën e nenit 102, pika 1,

germat “ç” dhe “d” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, sipas përmbajtjes së kësaj dispozite në kohën kur është nisur procedimi disiplinor.

11.2.5 Në përfundim të analizës së mësipërme, Kolegji çmon se shkak i ankimit të magjistratit për paligjshmëri të vendimit të KLP-së nr. 20, datë 31.1.2022, është i pabazuar.

12. Vlerësimi i Kolegjit mbi shkakun e ankimit të magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi) për moskryerjen e një hetimi të thelluar dhe moscaktimin e ekspertit nga organi administrativ

12.1 Në mbështetje të shkakut të ngritur në ankim për moskryerjen e një hetimi të thelluar administrativ në procedurën disiplinore të ndjekur ndaj saj, magjistratja ka pretenduar *mosmarrjen e provave kryesisht të kërkuara ILD-së gjatë hetimit disiplinor*, duke paraqitur së bashku me ankimin, urdhrat e drejtuesit të Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër me nr. {***} prot. (E/C), datë 15.7.2013; nr. {***} prot. (E/C), datë 15.7.2013; nr. {***} prot. (E/C), datë 11.6.2013; nr. {***} prot. (E/C), datë 11.6.2013; nr. {***}, datë 8.9.2014; nr. {***}, datë 9.1.2018.

12.1.1 Nga verifikimi i kryer nga Kolegji lidhur me bazueshmërinë e këtij pretendimi, u konstatua se në fashikullin e administruar gjatë procedurës së hetimit administrativ nga ILD-ja, ndodheshin edhe dy prej urdhrave të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, të cituar më sipër, konkretisht urdhrat nr. {***}, datë 8.9.2014 dhe nr. {***}, datë 09.01.2018, të cilët duket të jenë dorëzuar nga magjistratja në mbështetje të parashtrimeve të dorëzuara pranë ILD-së¹⁴, fakt ky i konfirmuar nga ankuesja edhe gjatë përgjigjeve të pyetjeve të anëtarëve të KLP-së, në seancën dëgjimore të zhvilluar në datën 20.1.2022, ku kjo e fundit është shprehur se: “[...] për periudhën që unë kam mbuluar çështje të tjera, ILD-së i kam vënë në dispozicion 2 urdhra të nxjerrë nga drejtuesi i prokurorisë [...]”¹⁵.

12.1.2 Në vlerësim të sa më sipër, Kolegji çmon se pretendimi i magjistrates për *mosmarrjen e provave kryesisht të kërkuara ILD-së gjatë hetimit disiplinor*, nuk

¹³ Shih paragrafin 181 të vendimit të KLP-së objekt ankimi.

¹⁴ Me shkresën e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër me nr. {***} prot. (B.Z), datë 29.9.2021.

¹⁵ Shih faqen 29 të vendimit të KLP-së, nr. 20, datë 31.1.2022.



bazohet në fakte, sa kohë rezultoi që dy prej pesë urdhrave për të cilët ngrihet ky pretendim, janë bërë pjesë e fashikullit të hetimit disiplinor dhe kanë qenë në dispozicion edhe të KLP-së, në funksion të vendimmarrjes së saj në kuadër të procedimit disiplinor të nisur ndaj magistrates. Ndërkohë që, sa u takon tre urdhrave të tjerë, të depozituar për herë të parë në Kolegj, së bashku me ankimin e ushtruar ndaj vendimit të KLP-së nr. 20, datë 31.1.2023, nuk rezultoi që ata të jenë kërkuar të merren në cilësinë e provës, apo lidhur me ta të jetë refuzuar marrja si provë nga ana e ILD-së apo KLP-së. Në këto kushte, Kolegji, duke mbajtur në konsideratë edhe faktin se akti i njoftimit nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë lidhur me vendimin e këtij të fundit nr. {***} prot., datë 28.8.2021, “Për fillimin e hetimit disiplinor ndaj magistrates Belina Zeneli, me detyrë prokurore pranë [...]” ka respektuar kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 123, pika 3, germa “dh” e ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, duke i bërë të ditur magistrates Belina Zeneli të drejtat e saj gjatë kësaj procedure, ndër to edhe të drejtën për të dorëzuar parashtrësia dhe dokumente mbështetëse, e çmoi pretendimin e saj për *mosmarrjen e provave kryesisht të kërkuara ILD-së gjatë hetimit disiplinor*, të pabazuar në fakte.

12.1.3 Përpos sa më sipër, Kolegji vëren se nga urdhrat e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, të paraqitur nga ankuesja, rezultojnë të dhëna në funksion të detyrave që i janë ngarkuar prokurores në tërësi, por jo të lidhura me veprimet/mosveprimet konkrete, mbi të cilat KLP-ja ka bazuar konstatimin se magistratja ka kryer shkelje disiplinore. Në vlerësimin e Kolegjit, magistratja nuk arriti të provojë në mënyrë konkrete ndikimin që kanë pasur urdhërimet e drejtuesit të Prokurorisë në ngarkimin e magistrates me funksione të caktuara qoftë në drejtim të pengimit të procedurave lidhur me procedimet penale objekt hetimi/procedimi disiplinor, qoftë në drejtim të volumit të ngarkesës që kanë prodhuar këta urdhra, për t’u vlerësuar objektivisht si një shkak justifikues në *ndërprenjen prej saj të funksioneve procedurale, duke mos ushtruar për një kohë të gjatë funksionet e prokurorit në pjesën më të madhe të materialeve të marra në administrim për hetim*, si konstatuar në vendim nga ana e KLP-së.

12.2 Kolegji mbajti të njëjtin qëndrim edhe në drejtim të pretendimeve të ankueses në lidhje me procedimin disiplinor të kryer nga KLP-ja, i cili, sipas saj, nuk bazohet në një hetim të thelluar, të paanshëm dhe objektiv dhe vlerësimin e volumit real të punës së përballuar prej saj, të cilat i gjeti të pabazuara. Kolegji konstatoi se pretendimet e ankueses mbetën në nivel deklarativ në drejtim të të provuarit të fakteve lidhur me ngarkesën e pretenduar të punës të shtrirë në periudhën kohore nga viti 2014–2019, sikundër dhe ato në drejtim të natyrës komplekse dhe voluminoze të veprave penale¹⁶, numrit të të pandehurve, trajtimit të materialeve hetimore që u përkisnin prokurorëve të larguar, numrit të kufizuar të prokurorëve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, mungesës së Oficerëve të Policisë Gjyqësore, mungesës së ekspertëve të nevojshëm për veprimet hetimore, distancës së largët me Institucionin e Ekzekutimit dhe të Vuajtjes së Dënimeve Penale Burrel, shtrirjes së gjerë gjeografike të Qarkut Dibër, mangësive në infrastrukturën kompjuterike dhe mungesës së sekretarisë për çështje administrative. Për më tepër, Kolegji vërejti se magistratja, pavarësisht kohës së konsiderueshme nga momenti i fillimit të procedimit disiplinor në datën 28.8.2021, deri në momentin e shqyrtimit të ankimit të saj në Kolegj, nuk bëri asnjë përpjekje të shtuar, efektive, në drejtim të nevojës për të provuar pretendimet e saj, përveçse t’i riprodhojë ato në çdo fazë të procesit disiplinor, në nivel administrativ dhe gjyqësor. Sa i takon pretendimit të fakteve lidhur me problemet e rënda shëndetësore të prindërve, duke filluar nga viti 2010 e në vijim, si pasojë e të cilave ankuesja është kujdesur për ta, Kolegji në vlerësim të akteve të paraqitura bashkëlidhur ankimit në mbështetje të këtyre pretendimeve, arriti në konkluzionin se nuk provohet se ekzistenca e tyre justifikon mosveprimet e ankueses në përmbushjen e detyrave të prokurores, në mënyrën dhe afatet e urdhëruara nga legjislacioni procedural penal.

Në këto kushte, Kolegji e gjen të bazuar dhe shterues konkluzionin e KLP-së në paragrafin 182 të vendimit që kundërshtohet, ku citohet: *Gjatë verifikimit paraprak, hetimit dhe procedimit disiplinor, pretendimet që magistratja ka parashtruar për të justifikuar*

¹⁶ Duke referuar këtu çështje juridiksionale me jashtë, verifikimi i masave mjekësore, heqja e zotësisë për të vepruar, kërkesa të drejtpërdrejta në gjykatë ku prokuroria Faqe | 21470

është palë në proces, përfshirë këqyrje të vendit të ngjarjes, urdhër regjistrimi, kërkesa për masa sigurimi personal.



vonesat e saj gjatë ushtrimit të detyrës, nuk arritën të ngrihen në nivelin e provës për të justifikuar neglizhimin, mosveprimet, vonesat dhe lënien e shumë procedimeve pa trajtim e zgjidhje përfundimtare, në kundërshtim me kërkesat e Kushtetutës, ligjeve dhe udhëzimeve përkatëse që normojnë detyrën e një prokurori.

12.3 Lidhur me pretendimin e ankueses për kundërshtimin si të pabazuar të konkluzionit të KLP-së, se ajo nuk ka qenë bashkëpunuese me ILD-në gjatë fazës së hetimit, si pasojë e problemeve të saj shëndetësore në vitin 2021, Kolegji konstaton se rrethanat e bashkëpunimit të ankueses me ILD-në janë vlerësuar nga KLP-ja në kuadër të kriterit “Sjellja e magistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit” apo “Sjellja e magistratit gjatë hetimit/procedimit disiplinor, në kuadër të parashikimeve të nenit 115 të ligjit nr. 96/2016, “Kriteret për caktimin e masës disiplinore”.

12.3.1 Në vlerësim të pretendimeve të ankueses lidhur me sa më sipër, Kolegji, pasi verifikoi dinamikën e ndërveprimit të magistrates me ILD-në në drejtim të verifikimit të veprimeve dhe mosveprimeve të magistrates, të cilat mund të përbënin shkelje disiplinore, vlerësuar këto në raport me diagnostikimet e kryera lidhur me gjendjen e saj shëndetësore, referuar dokumentacionit të depozituar në cilësinë e akteve provuese për këtë qëllim¹⁷, Kolegji konstatoi se urdhri i drejtuesit të PGShPD-së nr. {***}, datë 7.7.2021, drejtuar magistrates Belina Zeneli (Kryemadhi), për zbatimin e afateve të lëna për dorëzimin e dosjeve të kërkuara nga ILD-ja, ishte më i hershëm se aktet diagnostikuese, sipas të cilave rezultoi që magistratja të ketë konfirmuar problematikat shëndetësore të pretenduara. Në këtë kuptim, Kolegji çmoi se ankuesja nuk arriti të provojë se shkaku për mosmarrjen e masave për vënien në dispozicion të ILD-së të dosjeve të kërkuara në afat, duke çuar në nxjerrjen e urdhrit të sipërcituar nga drejtuesi i Prokurorisë pranë së cilës ushtronte detyrën magistratja, ka qenë pikërisht problematika e saj shëndetësore.

12.3.2 Në lidhje me pretendimin e magistrates, se procedimi disiplinor në KLP nuk i është nënshtruar një procesi hetimi të thelluar edhe për faktin se KLP-ja nuk ka caktuar me iniciativën e saj

një ekspert, Kolegji fillimisht konstaton se ky pretendim është ngritur nga ankuesja për herë të parë në Kolegj. Nuk rezultoi që ankuesja të ketë ngritur një pretendim të tillë për moscaktimin e një eksperti përpara KLP-së, as në prapësimet e përgatitura me shkrim dhe as në seancën dëgjimore të kryer më datë 20.01.2022. Gjithashtu, Kolegji vëren se edhe në ankim, ky pretendim i magistrates nuk është argumentuar prej saj në drejtim të nevojës për thërritjen nga KLP-ja të një eksperti dhe pasojës që ka prodhuar ky mosveprim në vendimmarrjen e KLP-së objekt ankimi.

12.3.3 Në shqyrtim të këtij pretendimi, Kolegji vlerëson se parashikimi ligjor i nenit 138, pika 4, germa “c” e ligjit nr. 96/2016, në të cilin përcaktohet shprehimisht: “Këshilli kur e konsideron të përshtatshme, thërret ekspertë ose i kërkon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të thërrasë ekspertë”, nuk vendos një detyrim mbi KLP-në për thirrjen e një eksperti, por lë në vlerësimin diskrecional të tij përcaktimin e një nevojë të tillë, në çmim të rrethanave specifike të rastit në shqyrtim. Në këto kushte, në mungesë të paraqitjes së argumenteve faktike dhe ligjore nga ankuesja në drejtim të pasojës që ka sjellë mosushtrimi i kësaj kompetence nga ana e KLP-së në interesat e ligjshëm të ankueses, sipas vendimmarrjes objekt ankimi, Kolegji arrin në përfundimin se ky pretendim është i pabazuar në fakte dhe në ligj dhe, rrjedhimisht, nuk e bën të cënueshme procedurën disiplinore në këndvështrimin e plotësisë së hetimit të kryer, për konstatimin e shkeljes disiplinore, për të cilën është dhënë masa e kundërshtuar.

12.4 Në lidhje me pretendimin e ankueses se Prokurori i Përgjithshëm ka cenuar një nga parimet themelore të procesit disiplinor të garantuar nga neni 100/1, pika “g”, e ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe konkretisht parimin e konfidencialitetit, të së drejtës për jetë private dhe mbrojtjen e të dhënave personale, nëpërmjet publikimit në datën 21.5.2021, në faqen zyrtare në internet të Prokurorisë së Përgjithshme, të njoftimit në lidhje me kërkesën drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për nisjen e procedurës së inspektimit ndaj saj, për hetimin e shkeljeve individuale të kryera

¹⁷ Rezultoi se diagnostikimi mban datën 18.9.2021, ndërsa *echo*-t janë të datave 29.7.2021, 30.7.2021, 6.9.2021 dhe 11.9.2021.



në ushtrimin e detyrës, pasi ishin konstatuar veprime të cilat mund të përbënin zvarritje të rëndë të veprimtarisë procedurale, si dhe shkelje të dispozitave urdhëruese të Kodit të Procedurës Penale, Kolegji vlerëson se një pretendim i tillë nuk cenon bazueshmërinë faktike dhe ligjore të vendimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë objekt ankimi dhe, si rrjedhojë, konsiderohet pa relevancë për vendimmarrjen e Kolegjit.

12.5 Në lidhje me pretendimin e ankueses se nga ILD-ja ka pasur një devijim nga objekti i hetimit, duke përmendur fakte të cilat nga ana procedurale janë parashkruar ose për të cilat ka një vendim gjykate dhe se kjo është bërë qëllimisht për të ulur figurën dhe personalitetin e ankueses, Kolegji, pasi vlerësoi aktet e procedimit disiplinor të administruar në fashikullin e përcjellë nga KLP-ja, vëren si vijon.

12.5.1 Ankuesja kundërshton evidentimin nga ana e ILD-së në raportin e saj të të dhënave lidhur me çështje të mëparshme disiplinore dhe konkretisht të masës së largimit nga detyra të ankueses në vitin 2001, pasi qëllimisht, sipas saj, nuk është përmendur në kontekstin e kësaj mase disiplinore të dhënë në vitin 2001, vendimi i gjykatës që ka shqyrtuar këtë vendimmarrje të Prokurorit të Përgjithshëm duke e konsideruar atë të padrejtë. Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesja ka depozituar bashkëlidhur parashtresave të saj në Kolegj, aktet: (i) kërkesë për përjashtim gjyqtari nr. {***} prot., datë 20.11.2000; (ii) shkresë e Gjykatës së Rrethit Dibër nr. {***} prot., datë 21.11.2000; (iii) urdhër i prokurorit të Rrethit Dibër nr. {***} prot., datë 3.12.2000; (iv) vërtetim i Prokurorisë së Rrethit Dibër, datë 3.9.2002; (v) vërtetim i Gjykatës së Rrethit Bulqizë nr. {***} prot., datë 17.5.2001; (vi) shkresë e Prokurorisë së Përgjithshme nr. {***} prot., datë 15.2.2001.

12.5.2 Gjithashtu, sipas ankueses, masa disiplinore e dhënë nga Prokurori i Përgjithshëm në vitin 2014, “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra”, ka rezultuar pas një hetimi të kryer nga Drejtoria e Hetim-Inspektimit në Prokurorinë e Përgjithshme, duke lënë edhe detyra pas studimit të procedimeve penale objekt hetimi. Ankuesja argumenton se për njërin prej këtyre procedimeve penale, konkretisht atë nr. {***} të vitit 2012, për të cilin grupi i inspektimit vendosi “Prishjen e vendimit të pushimit dhe dërgimin për gjykim”, pas gjykimit, ky procedim penal është pushuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, duke vendosur sipas vendimit të

ankueses (vendim i prishur nga grupi i inspektimit). Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesja ka depozituar bashkëlidhur parashtresave, aktet: (i) urdhër i prokurorit, datë 26.3.2012, për regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetasit B. Gj.; (ii) vendim i prokurorit, datë 15.6.2012, për pushimin e çështjes penale nr. {***}, për veprën penale [...]; (iii) vendim i Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, datë (s’ka).11.2013, për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***}, të vitit 2012; (iv) kërkesë për gjykim nr. {***} prot., datë 24.4.2015, për procedimin penal nr. {***} të vitit 2012, “Prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal; (v) vendim nr. {***}, datë 22.7.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër; (vi) vendim nr. {***}, datë 8.7.2016, i Gjykatës së Apelit Tiranë; (vii) fletëthirrje nga Gjykata Administrative Tiranë për gjykimin administrativ nr. {***} regjistri, datë 2.9.2019, me objekt “Kompensim burgimi të padrejtë”, të paditësit B. Gj.

12.5.3 Ankuesja pretendon gjithashtu se gjatë veprimtarisë së saj, qytetarë të ndryshëm kanë depozituar ankesa ndaj procedimeve penale të hetuara, apo për të cilat ajo ka përfaqësuar akuzën në gjyq dhe se në asnjë rast nga ana e ILD-së nuk është nisur procedim disiplinor, duke vendosur arkivimin e çështjes. Në mbështetje të këtij pretendimi, ankuesja ka përcjellë bashkëlidhur edhe: (i) njoftim vendimi ILD nr. {***} prot., datë 21.9.2022; si dhe (ii) njoftim vendimi ILD nr. {***} prot., datë 20.1.2022.

12.5.4 Në analizë të këtyre pretendimeve, referuar akteve të fashikullit të procedimit disiplinor të administruar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dhe parashikimeve të nenit 115, pika 1, paragrafi “ç”, sipas të cilit një ndër kriteret përcaktuese në caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore të kryer, janë edhe *të dhënat profesionale të çështjeve disiplinore dhe të dhënat kriminale të magistratit*, Kolegji vlerëson se evidentimi i masave të mëparshme disiplinore të shënuara në dosjen personale të magistratit, nuk përbën devijim nga objekti i hetimit disiplinor nga ana e ILD-së, pasi këto janë të dhëna të kërkuara nga ligji, të cilat i shërbejnë KLP-së në caktimin e masës disiplinore, në përputhje me rëndësinë e shkeljes së konstatuar prej tij gjatë procedimit disiplinor të kryer.



12.5.5 Kolegji vëren gjithashtu se, ndonëse ankuesja pretendon se ILD-ja nuk ka evidentuar vendimin e gjykatës që ka shqyrtuar vendimmarrien e Prokurorit të Përgjithshëm për dhënien e masës disiplinore në vitin 2001, vetë ankuesja nuk e ka depoziton këtë vendim bashkëlidhur akteve të tjera lidhur me këtë çështje. Pavarësisht kësaj, konstatohet se nga verifikimi i fashikullit të procedimit disiplinor, ky vendim rezulton të jetë administruar në kuadër të hetimit të kryer nga ILD-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 27.9.2021, dhe ka qenë në dispozicion për vlerësim nga ana e KLP-së, i cili e ka referuar atë në arsyetimin e vendimit të tij në paragrafin 158¹⁸.

12.5.6 Sa i takon masës disiplinore të dhënë në vitin 2014, pretendimi i ankueses se procedimi penal nr. {***} i vitit 2012 ka qenë pjesë e procedimeve të inspektuara dhe për të cilat asaj i është dhënë masa disiplinore, mbetet i paprovuar. Aktet e përcjella nga magjistratja në Kolegj, sipas të cilave qëndrimi i mbajtur fillimisht prej saj është konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, nuk provojnë që pikërisht për këtë procedim, asaj i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra” në vitin 2014. Gjithashtu, vërehet se edhe nëse ky procedim penal ka qenë pjesë e procedimeve të inspektuara, shkeljet e evidentuara gjatë inspektimit nuk kanë lidhje me faktin nëse ky procedim penal, që në momentin e inspektimit, duhej pushuar apo duhej çuar për gjykim. Nga përmbajtja e vendimit të sipërcituar të Drejtorisë së Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme, për shfuqizimin e vendimit të pushimit të procedimit penal nr. {***} të vitit 2012, rezulton se titullari i kësaj drejtorie e ka gjetur të pabazuar vendimin e magjistrates për pushimin e procedimit penal, si pasojë e hetimeve të paplota dhe, në këtë kontekst, e ka shfuqizuar atë, duke urdhëruar kryerjen e disa veprimeve të tjera hetimore të nevojshme (administrimin e aktit të ekspertimit toksikologjik etj.) dhe në vijim, në varësi të konkluzionit të këtij akti, do të mund të vlerësohej vazhdimi i mëtejshëm i hetimeve apo pushimi i tyre. Për rrjedhojë të sa më sipër, pretendimet e ankueses në lidhje me këtë procedim penal të vitit 2012 dhe

efekteve të tij në masën disiplinore të dhënë asaj në vitin 2014, mbetën të paprovuara.

12.5.7 Për më tepër, nga verifikimi i akteve të administruara në fashikullin e procedimit disiplinor, Kolegji vëren se në urdhrin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. {***}, datë 5.3.2014, “Për dhënien e masës disiplinore”, citohet: *Gjatë mbrojtjes së realizuar nga prokurorja e proceduar, u pranuan shkeljet e kryera nga ana e saj nëpërmjet observacioneve me shkrim të parashtruara përpara Këshillit të Prokurorisë dhe në mënyrë të përmbledhur u dhanë shkaqet e lejit të tyre. Në përfundim të mbrojtjes, prokurorja, duke kërkuar nga Këshilli që t’i sugjerojë Prokurorit të Përgjithshëm, marrjen e një mase sa më të lehtë disiplinore ndaj saj, u angazhuan se në të ardhmen nuk do të lejojnë shkelje të asnjë lloji [...].* Kolegji e çmon sa më sipër si konfirmim të faktit se shkeljet e konstatuara, për të cilat është dhënë masa disiplinore në vitin 2014, janë pranuar edhe nga vetë magjistratja.

12.5.8 Në përfundim të analizës së mësipërme, Kolegji çmon se pretendimet e mësipërme të ankueses nuk mund të shërbejnë si shkak për konstatimin e problematikave në vlerësimin e të dhënave lidhur me çështjet disiplinore të magjistratit, si një ndër kriteret përcaktuese në caktimin e masës disiplinore në proporcion me rëndësinë e shkeljes disiplinore të kryer, sipas parashikimeve të nenit 115, pika 1, paragrafi “ç” i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

13. Në përfundim të analizës së mësipërme lidhur me shkaqet e ankimit, Kolegji çmon të nevojshme të evidentojë se ankuesja nuk ka ngritur pretendime në drejtim të ekzistencës së shkeljeve disiplinore të konstatuara nga KLP-ja dhe kualifikimin e tyre si shkelje shumë të rënda, por është fokusuar kryesisht në pretendimin se kjo situatë është krijuar si pasojë e ngarkesës në punë dhe e problemeve shëndetësore të saj dhe të prindërve, pretendime këto të cilat nuk u provuan se justifikojnë shkeljet disiplinore të konstatuara.

14. Në këto kushte, Kolegji i Posaçëm i Apelit arrin në përfundimin se shkeljet disiplinore të magjistrates, të kryera gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, të konstatuara nga ILD-ja dhe të shqyrtuara dhe vlerësuara nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë në procedimin disiplinor ndaj saj, janë të tilla që e ngarkojnë atë me përgjegjësi disiplinore dhe se masa

¹⁸ Me vendimin nr. {***}, datë 31.1.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur: “Detyrimi i të paditurit, Prokurorisë së Përgjithshme, të paguajë në favor

të paditëses Belina Zeneli pagën e një viti pune, duke filluar nga data 8.2.2001”. Ky vendim ka marrë formë të prerë më datë 7.3.2002.



disiplinore e shkarkimit nga detyra, e dhënë ndaj magjistrates, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, është proporcionale me rëndësinë e shkeljeve të kryera prej saj.

15. Për sa më sipër, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në analizën në tërësi të pretendimeve të ankueses, çmon se vendimi nr. 20, datë 31.01.2022, i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i drejtë dhe i bazuar në ligj, dhe kërkesa e magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi) nuk duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Posaçëm i Apelit, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” e Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Mospranimin e ankimit të magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi) kundër vendimit nr. 20, datë

31.01.2022, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj magjistrates Belina Zeneli (Kryemadhi), prokurore në Prokurorinë e Shkallës së Parë Dibër”.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 24.10.2023

Shpallur më 24.11.2023

Kryetar: Sokol Çomo

Gjyqtare: Rezarta Schuetz, Ina Rama, Mimoza Tasi, Natasha Mulaj, Albana Shtylla

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 87 datë 16.2.2023, vendosi shpalljen të vdekur, më datë 1 janar 2012, të shtetasit Klodian Londo, i datëlindjes 8.7.1973, lindur në Berat.

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë